



ISSN 2309 3455

Social Studies

Studime Sociale

Vol. 19, No. 2 (71), 2025



- Marsela SAKO • Sokol LLESHI • Nysjola DHOGA
• Rovená SULSTAROVA • Ferit BAÇA
- Marsela ALLMUÇA • Ledian RUSTA • Adriana ANXHAKU
 - Klara SULA • Ruthi TAJA • Artemisi SHEHU DONO
 - Eljana BRAHJA • Blerina HAMZALLARI • Juna MUÇA
 - Entela KOSTRISTA • Edo SHERIFI • Edvaldo BEGOTARAJ
 - Fitimtar ZEKTHI • Arben HOTI • Xhafer RAKIPLLARI

www.sociology.al





20th Annual International & Interdisciplinary Conference:

“DEVELOPMENT IN TURBULENT TIMES”

**University “Luigj Gurakuqi” Shkoder, ALBANIA
14-15 November 2025**



SOCIAL STUDIES [STUDIME SOCIALE]

Vol. 19, No. 2 (71), 2025

Editorial Team

Editor:

Leke SOKOLI – Tirana, ALBANIA

Deputy Editors:

Sejdin CEKANI – Tirana, ALBANIA

Besim GOLLOPENI – Pristine, KOSOVO

Ali PAJAZITI – Skopje, North MACEDONIA

Romina GURASHI – Roma, ITALY

Deputy Editor for Management, Membership and Finance:

Elda SOKOLI KUTROLI

International Editorial Board

Servet PËLLUMBI – Chair, Albanian Institute of Sociology, ALBANIA

Aida GOGA – University of Tirana, ALBANIA

Agri SOKOLI – St. Louis International School Milan, ITALY

Apostolos G. PAPADOPOULOS – Harokopio University, GREECE

Bavjola SHATRO – University of Mississippi, UNITED STATES OF AMERICA

Blerina XHAKOLLI REÇI – University Aleksander Moisiu Durres, ALBANIA

Borut RONČEVIĆ – University of Ljubljana, SLOVENIA

Brunilda ZENELAGA – University of Tirana, ALBANIA

Doreta KUÇI – University Aleksander Moisiu Durres, ALBANIA

Enis SULSTAROVA – University of Tirana, ALBANIA

Erenestina GJERGJI HALILI – University of Tirana, ALBANIA

Ferdi KAMBERI – University Fehmi Agani of Gjakova, KOSOVO

Goran BASIC – Department of Sociology, Lund University, SWEDEN

Irena NIKAJ – Universiteti Fan Noli of Korca, ALBANIA

Jasminka LAŽNJAK – University of Zagreb, CROATIA

Jola KEPI – Center for School Leadership, CSL-AADE, ALBANIA

Jonida LAMAJ – Albanian-American Development Foundation, ALBANIA

Klea FANIKO – University of Geneva, SWITZERLAND

Klejda MULAJ – University of Exeter, ENGLAND
Konstantin MINOSKI – Ss. Cyril and Methodius University in Skopje, North MACEDONIA
Kseancla SOTIROFSKI – University Aleksander Moisiu Durrës, ALBANIA
Ledia KASHAHU – University Aleksander Moisiu of Durrës, ALBANIA
Monika HASANI – University Ismail QEMALI of Vlora, ALBANIA
Pjereta AGALLIU – University of Tirana, ALBANIA
Robert ÇITOZI – University of Sports Tirana, ALBANIA
Sergiu BALTATESCU – University of Oradea, ROMANIA
Shaban SINANI – Albanian Academy of Science, ALBANIA
Shkëlzen HASANAJ – University of Siena, ITALY
Svetla KOLEVEA – Institute for the Study of Societies and Knowledge, BULGARIA
Tonin GJURAJ – European University of Tirana, ALBANIA
Venera LLUNJI – AAB College, KOSOVO

© Albanian Institute of Sociology / Instituti Shqiptar i Sociologjisë

Design: **Orest Muça**

“Social Studies”, Scientific Journal, certified by the Highest Scientific Committee, Ministry of Education and Science of Albania

Decision no. 170, date 20th of December 2010

Contacts:

Mobile: ++355692044722; ++355694067682

E-Mail: albsa@sociology.al; studime.sociale@gmail.com

www.sociology.al

Contents:

Marsela SAKO Sokol LLESHI	<i>Politika e jashtme e Shqipërisë në periudhën post-komuniste dhe roli i elitës politike</i> 5
Nysjola DHOGA Rovena SULSTAROVA	<i>Sfidat dhe avantazhet e qasjes ndaj integritetit në Shqipëri: Vlerësimi i planeve të integritetit në katër ministri</i> 19
Ferit BAÇA	<i>Shteti dhe zbatimi i lirisë së individit në demokraci</i> 31
Marsela ALLMUÇA	<i>Shërbimet e mbështetjes për viktimat e dhunës me bazë gjinore në zonat rurale. Sfida dhe mundësi për përmirësimin e aksesit dhe cilësisë</i> 43
Ledian RUSTA	<i>Qytetari në ushtrimin publik të arsyes në përmasën kozmopolitike</i> 51
Adriana ANXHAKU Klara SULA	<i>Mënyrat e reja të njohjes nëpërmjet internetit dhe vlerat humane e demokratike si filtra pedagogjike</i> 59
Ruthi TAJA Artemisi SHEHU DONO	<i>Effects of Chronic Autoimmune Disease in the Quality of Marriage</i> 67
Eljana BRAHJA	<i>Intellectual Well-Being in a Digital Age: Challenges and Opportunities</i> 75
Blerina HAMZALLARI	<i>Martesa në moshë të hershme si formë e dhunës familjare ndaj vajzave dhe grave</i> 83
Juna MUÇA Entela KOSTRISTA Edo SHERIFI Edvaldo BEGOTARAJ	<i>Analizë e regresionit mbi ndikimin e mbështetjes sociale dhe karakteristikave individuale në kënaqësinë dhe stresin në punë</i> 97
Fitimtar ZEKTHI	<i>Identiteti politik, autenticiteti dhe morali: krahasim i së Majtës dhe së Djathtës në Shqipërinë post-komuniste</i> 109
Arben HOTI	<i>The Effects of Anxiety and Locus of Control Among Students of the Faculty of Economics at the University of Shkodra During the Post-COVID-19 Period</i> 125
Xhafer RAKIPLLARI	<i>The Evolution of Geopolitics: From Classical Theories to Cultural and Critical Approaches</i> 135

POLITIKA E JASHTME E SHQIPËRISË NË PERIUdhËN POST-KOMUNISTE DHE ROLI I ELITËS POLITIKE

Marsela SAKO
Universiteti i Tiranës
Departamenti i Shkencave Politike
E-mail: marsela.sako@unitir.edu.al

Sokol LLESHI
Universiteti i New York, Tiranë
Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare
E-mail: sokolleshi@unyt.edu.al

PËRMBLEDHJA

Ky punim analizon ndryshimet në orientimin e politikës së jashtme të Shqipërisë në periudhën e para dhe pas përmbykses së regjimit komunist, deri në fundin e dekadës së dytë të pas vitit 1990. Për këtë qëllim, fokusi i këtij punimi përqendrohet tek evidentimi i ndikimit dhe rolit që kanë luajtur elitat politike shqiptare në formësimin e këtyre orientimeve. Nën këndvështrimin e qasjes metodologjike cilësore interpretative, analizohet sesi idetë, karakteristikat ideologjike apo dhe e shkuara historike kanë ndikuar në vendimmarrjen e politikës së jashtme nga elita politike. Punimi mbështetet në të dhëna empirike të tilla si: fjalime të elitës drejtuese, manifeste politike dhe elektorale, sikundër dhe në programe qeveritare me qëllim analizimin e orientimit dhe konceptimin e politikës së jashtme të Shqipërisë nga elita politike. Nëpërmjet këtij punimi, evidentohet se në kushtet e mungesës së konsensusit për orientimin e politikës së jashtme që ka karakterizuar elitat politike të partive kryesore në vitet e para pas përmbykses së regjimit komunist dhe në kushtet e një ndikimi jo të rëndësishëm të Perëndimit, politika e jashtme e Shqipërisë është përcaktuar kryesisht nga ndarjet e brendshme ideologjike dhe jo aq nga forcat e jashtme strukturore. Në këtë kuptim, dinamikat e brendshme politike, kanë luajtur një rol kritik në formësimin e trajektores së politikës së jashtme në Shqipërinë postkomuniste.

Fjalë kyçe: *politikë e jashtme, Shqipëri, elita politike, tranzicioni post-komunist, politikë e brendshme, ndryshime ideologjike*

Marsela SAKO është lektore në Departamentin e Shkencave Politike, Universiteti i Tiranës. Fushat kryesore të interesit kërkimor janë: marrëdhëniet rajonale dhe ndërkombëtare, zgjidhja e konflikteve dhe politika e jashtme. Gjithashtu çështje të tjera të interesit kërkimor përfshijnë: të rinjtë dhe grupet e marginalizuara.

Sokol LLESHI është lektor në Departamentin e Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare në Universitetin e Nju Jorkut, Tiranë (Universiteti i New York Tirana). Fushat kryesore të interesit kërkimor përfshijnë: elitat politike e kulturore, politikat e kujtesës të regjimeve pas-autoritare dhe ndërveprimi midis përfaqësimit politik dhe organizimit partiak.

Me përmbysjen e regjimit komunist, dhe me ndryshimin e natyrës së sistemit ndërkombëtar nga një sistem dypolar në një sistem një polar me SHBA-të si superfuqinë botërore, Shqipëria, sikurse edhe pjesa më e madhe e vendeve të bllokut lindor u gjendën përballë një nevojë transformimi rrënjësor, si në nivel të brendshëm kombëtar, ashtu edhe në nivel të jashtëm ndërkombëtar. Mënyra e ndërtimit të raporteve të reja dhe orientimi i vendeve post-komuniste në fillimin e viteve 1990, u influencua nga faktorë të jashtëm, por edhe të brendshëm, sikurse do të shpjegohet në këtë punim.

Në këtë periudhë transformimesh të mëdha, si pasojë e shpërbërjes së bllokut lindor, u rrit numri i shteteve të vogla jo vetëm në terma territorialë, por mbi të gjitha në terma të fuqisë ushtarake apo dhe kapaciteteve ekonomike dhe institucionale. Në këto kushte, referuar edhe përcaktimit të Rothstein (1968) shtetet e vogla për shkak se e kanë të vështirë të mundësojnë sigurinë e vendit të tyre bazuar në kapacitetet ekzistuese, prirën të sigurojnë mbështetjen e shteteve e tjera për mbrojtjen nga kërcënimet e jashtme. Për këtë arsye, aleancat me shtetet e fuqishme konsiderohen të rëndësishme për të ruajtur pavarësinë dhe sigurinë. Kjo merr një rëndësi të veçantë kryesisht për shtetet e vogla të sistemit, të cilat janë më shumë të ekspozuara ndaj paparashikueshmërisë së kushteve të sigurisë ndërkombëtare dhe antagonizmit ekonomik (Snyder, 1991).

Pavarësisht se pajtohem me këtë perspektivë teorike, në këtë punim do të paraqesim kushtet e rrethanat në të cilat,

elitat përfaqësuese të shteteve të vogla e në transformim formulojnë orientimet e tyre të politikës së jashtme mbështetur në një trashëgimi ideologjike e ideore të mëparshme, traditën e politikës së jashtme, dhe të ndikuar prej shkaqeve të brendshme të konkurrencës politike.

Kësisoj, në fillimin e vitit 1990, Shqipëria u gjend në një fazë delikate përsa i përket sfidave të saj lidhur me shtetndërtimin dhe njëkohësisht me rikthimin e vendit në shoqërinë ndërkombëtare apo ripërcaktimin e marrëdhënieve të saj me shtetet e tjera.

Referuar qëndrimeve të elitës së fundit të periudhës komuniste, “Shqipëria nuk ishte as lindje, as perëndim” (Alia, 1990; cit., Krasniqi, 2014). Për këtë arsye, intensifikimi i bashkëpunimit me shtetet e zhvilluara dhe krijimi i aleancave konsiderohej si e vetmja rrugëdalje nga situatat sfiduese politike dhe ekonomike në të cilën ndodhej vendi. Studimet tregojnë se orientimi i politikës së jashtme drejt Evropës dhe Perëndimit në përgjithësi, ka qenë në fokusin kryesor të elitave politike në vendet e Evropës Lindore dhe Qendrore. Edhe në rastin e Shqipërisë, Bashkimi Evropian dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, janë identifikuan si dy partnerët kryesorë (Barbullushi, 2015). Elita politike u ndërgjegjësua se integrimi Euro-Atlantik konsiderohej thelbësor për të përmirësuar statusin e tyre në rajon dhe për të avancuar reformat në nivel të brendshëm kombëtar (Gjevari, 2018). Kështu, që prej vitit 1991 elita politike u orientua drejt perëndimit, duke vendosur marrëdhënie me Bashkimin Evropian me

synimin afatgjatë për t'u anëtarësuar në të ardhmen. Anëtarësimi në Bashkimin Evropian për vende si Shqipëria është konceptuar dhe propaganduar si projekti përfundimtar i modernizimit¹ (Frashëri, 2016). Gjithashtu, në të njëjtën periudhë u vendosën marrëdhënie edhe me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Vlen të nënvizohet se, Shqipëria nën drejtimin e Sali Berishës, drejtues i partisë së qendrës së djathtë (PD), ishte vendi i parë postkomunist në Evropën Lindore që synonte që në vitin 1992 anëtarësimin e vendit në aleancën ushtarake të NATO-s (Biberaj, 2014). Përafrimi me perëndimin (SHBA, BE) sidomos për vendet e Ballkanit Perëndimor është konsideruar nga elitat politike një garanci e shtuar për sigurinë dhe të ardhmen e këtyre vendeve (Anastasakis, 2005).

Megjithatë vlen të theksohet se, që prej periudhës së vonët të socializmit shtetëror dhe deri nga mesi i viteve 1990, elita politike shqiptare ka pasur pozicionime politike të ndryshme dhe është karakterizuar nga mungesa e konsensusit politik, për sa i përket formave të bashkëpunimit dhe aleancave që duhej të krijoheshin.

Në këtë punim, për të shpjeguar ndryshimet mbi orientimet e politikës së jashtme të Shqipërisë të përcaktuar nga përfaqësues kryesorë të elitës drejtuese, para dhe pas ndryshimit të regjimit, do të mbështetemi në qasjen metodologjike cilësore. Më konkretisht, duke përdorur një perspektivë metodologjike interpretative që shqyrton rolin e ideve, ngarkesës dhe trashëgimisë ideologjike në formulimin dhe konceptimin e politikës së jashtme prej elitave politike, do të mund të kuptojmë shkaqet e brendshme dhe ideore të dallimeve mbi politikën e jashtme në kuadrin kohor

prej periudhës së vonë të socializmit shtetëror në regjimin diktatorial deri në mbërritjen e një konsensusi në politikën e jashtme, i cili vërehet në fillim të viteve 2000. Të dhënat empirike të mbledhura përfshijnë fjalimet e përfaqësuesve të elitës drejtuese në konferenca rajonale, dokumente programore të hartuar nga partitë kryesore politike, si manifestet politike dhe elektorale, dhe programet konkrete të qeverive ndër vite që synojnë zbatimin e orientimeve dhe konceptimit të politikës së jashtme të Shqipërisë.

Konteksti teorik

Për një kohë të gjatë, studiues apo dhe politikëbërës në fokus të vëmendjes kanë patur analizimin e politikës së jashtme dhe faktorëve që ndikojnë në orientimin e një politike të jashtme të caktuar. Ky interes u rrit edhe më shumë në kushtet e zhvillimeve të reja që po dominonin sistemin ndërkombëtar pas vitit 1990. Shumë studiues janë munduar të shpjegojnë sjelljen e shteteve në politikën e jashtme nën optikën e teorive sistemike. Natyra anarkike e sistemit ndërkombëtar dhe aftësitë relative të fuqive të mëdha, janë konsideruar si faktorët kryesorë në përcaktimin e politikës së jashtme të shteteve, duke mos i kushtuar shumë rëndësi ndikimit të faktorëve të brendshëm (Ripsman, 2009).

Studiues të tjerë (Gvalia et al., 2019; Rose, 1998) argumentojnë se, pavarësisht rëndësisë së faktorëve sistematikë në orientimin e politikës së jashtme, këto faktorë nuk janë të mjaftueshëm për të kuptuar sjelljen e shteteve, nëse nuk merren në konsideratë edhe faktorët e brendshëm apo proceset e brendshme politike. Analizimi i këtyre

¹ Ernal Frashëri (2016: 2) argumenton se Shqipëria ka kaluar përmes tre projekteve modernizuese që nga periudha e shpalljes së pavarësisë në vitin 1912., projekti i parë modernizues midis viteve 1912-1945: projekti i dytë midis viteve 1945-1991; dhe projekti i tretë modernizues nga viti 1991 – në vazhdim. Sipas autorit termi “modernizim” i referohet një procesi që ka si qëllim të rishikojë vlerat sociale, politike dhe ekonomike, institucionet dhe normat e një vendi me qëllimin për ta ngritur në një nivel tjetër, të një qytetërimi më të avancuar.

faktorëve së bashku (presioni ndërkombëtar dhe konteksti i brendshëm), krijojnë një panoramë më të plotë pse shtetet sillen në mënyra të ndryshme, kundrejt të njëjtave kushte të jashtme të sistemit ndërkombëtar.

Kështu, për të kuptuar orientimin e politikës së jashtme dhe përcaktimin e vizionit për interesin kombëtar, një rol të rëndësishëm luajnë edhe idetë, perceptimet, dhe çështjet e sigurisë. Studiuesi John Owen (2001: 122-124) argumenton se, elitat e një vendi janë të prirura që në rastet e pasigurisë dhe kërcënimeve, të orientohen drejt aleatëve ndërkombëtarë me të cilët mund të jenë edhe ideologjikisht më afër, duke nënvizuar faktin se: "Preferencat strategjike të shteteve – pozicionimet e dëshiruara të qeverive të tyre – janë në funksion jo vetëm të fuqisë materiale, por edhe të ideologjisë dhe influencës relative të elitave të tyre". Sipas studiuesit Owen (2001-128) "shkalla me të cilën B bëhet armik apo mik i A-së, varion në varësi të nivelit të afërsisë ideologjike me A". Më tej mund të argumentohet se, dallimi ideologjik kryesisht midis qeverive të qendrës së majtë dhe qeverive të qendrës së djathtë vazhdimisht ka qënë përcaktues në orientimin e shteteve drejt bashkëpunimeve apo dhe politikës së jashtme etno-nacionaliste (Jenne, 2021).

Studiuesit Horowitz & Tyburski (2016), në analizën që kanë realizuar për 28 vende post-komuniste dhe orientimin e politikës së tyre të jashtme të sigurisë, konkludojnë se, qasja ideologjike e natyrës së regjimit luan një rol vendimtar në përzgjedhjen e aleancave. Nën optikën e teorive ideologjike studiuesit evidentojnë se regjimet demokratike liberale me prirje nacionaliste, kanë shfaqur një tendencë më të fortë për t'u anëtarësuar në Organizatën e Traktatit të Atlantikut të Veriut (NATO), ndërsa regjimet më autoritare apo neo-komuniste duke patur si prioritet mbijetesën e regjimit i kanë dhënë përparësi anëtarësimit në Bashkësinë e Vendeve të Pavarura (Commonwealth of Independent States,

CIS/), e themeluar nga Federata Ruse pas shpërbërjes së Bashkimit Sovjetik ose zgjedhjen të ishin neutrale.

Përveç faktorëve ideologjikë, faktorët të tjerë si eksperiencia historike apo dhe perceptimet e lidershit, që studiuesi Rose (1998) i trajton në kuadrin e teorive të politikës së brendshme, ndikojnë në mënyrën sesi elita politike e orienton politikën e jashtme. Sipas tij, ndikimi i faktorëve sistemik ndërmjetësohet nga faktorët e brendshëm, të cilët duhet të merren në konsideratë për të kuptuar politikën e jashtme të shteteve, në kushtet e anarkisë ndërkombëtare dhe pasigurisë së vazhdueshme me të cilën ndeshen shtetet në sistemin ndërkombëtar.

Faktori sistemik konsiderohet të ketë një epërsi ndaj faktorëve të brendshëm, por njëkohësisht duke mos neglizhuar rëndësinë e politikës dhe perceptimeve të liderve në orientimin e politikës e jashtme (Robison, 2011; Ripsman et al., 2009). Në kushtet kur sistemi ndërkombëtar i vendos shtetet përpara zgjedhjeve të caktuara, faktorët e brendshëm marrin rëndësi të konsiderueshme për të kuptuar mënyrën sesi merren këto vendime (Gvalia et al., 2013; Gvalia et al., 2019).

Periudha e vonët e socializmit shtetëror dhe politika e jashtme rajonale (1988-1990)

Përkundër politikës së vetë-izolimit në sferën ekonomike, periudha e vonët e socializmit shtetëror në Shqipëri pati si tipar prirjen për një politikë të jashtme në favor të bashkëpunimit rajonal me vendet e tjera të Ballkanit, pavarësisht nga natyra e regjimit politik të tyre. Ky orientim i politikës së jashtme në favor të përfshirjes në nisma rajonale ballkanike, mbështetej në një bazë ideologjike, sikurse dhe në interesin e elitave sunduese të regjimit për të ruajtur status-quo-në, që i jepte përparësi mbrojtjes së pavarësisë, sovranitetit shtetëror dhe

mos-ndërhyrjes së jashtme në Ballkan, duke nënkuptuar kryesisht fuqitë e mëdha.

Ramiz Alia në fjalimin e vitit 1988, gjatë kohës së përfshirjes rishtazi të Shqipërisë në Konferencën Ballkanike në Beograd po atë vit, shprehet se: “[Shqipëria] e konsideron politikën e fqinjësisë së mirë si një orientim konstant në marrëdhëniet e saj me të gjitha vendet ballkanike” (Alia, 1988). Në të njëjtin fjalim, Ramiz Alia shprehet se:

Popujt e Ballkanit munden dhe duhet të tregojnë se janë të aftë të jetojnë pa ndërhyrje të jashtme, dhe se ata dinë të njohin dhe mbrojnë interesat e epërme të lirisë, pavarësisë dhe sovranitetit të plotë të vendeve të tyre (Alia, 1988).

Më tepër se një thirrje ndaj vendeve të tjera të Ballkanit, ky qëndrim ishte një shprehje e mbrojtjes së status-quo-së, të politikës së brendshme të regjimit.

Reis Malile, ministri i jashtëm i pranishëm në Konferencën Ballkanike të vitit 1988, shprehet në fjalën e tij se:

Qeveria shqiptare ka mbështetur dhe do të mbështetë çdo hap të dobishëm që do të ndihmonte në përmirësimin e situatës në Ballkan dhe do t'i shërbente paqes, stabilitetit dhe sigurisë në rajon e më tej” (Malile, 1988).

Duke përmendur se, fuqitë e mëdha ndërhyjnë në një sërë vendesh dhe rajonesh, Reis Malile shprehet se Shqipëria nuk do të lejojë: “vendosjen e forcave të huaja apo bazave ushtarake në territorin e saj” (1988), duke theksuar më tej në qëndrimin e tij që: “Ballkani duhet t'i përkasë vetëm popujve të tij” (Malile, 1988: 46).

Një orientim i tillë i politikës së jashtme, me ndryshimin e regjimeve në 1990, do të përbëjë deri në mesin e viteve 1990-të, një trashëgimi ideologjike dhe ideore për Partinë Socialiste që reflektohet kryesisht në qëndrimet skeptike të kësaj partie ndaj NATO-s. Fjalimi, në një farë mase teknik, i

ministrit të jashtëm, pavarësisht ngarkesave ideologjike, paraqet konkretisht rëndësinë e zhvillimit të marrëdhënieve me vendet fqinje, si një nga përparësitë e politikës së jashtme të Shqipërisë (Malile 1988: 46).

Një tipar i dallueshëm i politikës së jashtme të Shqipërisë në periudhën e vonët të socializmit shtetëror, të paktën në fjalimin e ministrit të jashtëm Malile, është vetëdija e një pjese të përfaqësuesve të shtetit shqiptar, se tashmë rendi ndërkombëtar dhe raportet rajonale dominohen nga ndërvarësia ekonomike, duke mos përmendur specifiktisht, por duke nënkuptuar termin globalizëm. Jetojmë në një kohë, kur një numër marrëdhëniesh mes shteteve po zgjerohen më tej, kur ekonomitë kombëtare janë gjithnjë e më tepër të ndërvarura dhe se kulturat e ndryshme po pasurohen në mënyrë reciproke dhe të shpejtë” (Malile 1988: 47). Pa përmendur konkretisht Komunitetet Evropiane, ministri i jashtëm shprehet se “...ndërsa rajone të tjera në Evropë kanë rindërtuar, zgjeruar dhe thelluar marrëdhëniet e bashkëpunimit midis vendeve të tyre, në këtë aspekt vendet e Ballkanit kanë shkuar në drejtim të kundërt” (Malile 1988: 47). Ajo çfarë Shqipëria propozon në Konferencën Ballkanike të 1988-ës është rivendosja e marrëdhënieve ekonomike e shkëmbimeve tregtare me vendet e Ballkanit, kryesisht në “tregti, transport dhe komunikacion” (Malile 1998: 48). Pavarësisht këmbënguljes së regjimit për të cilësuar sovranitetin, integritetin territorial, pavarësinë dhe mosndërhyrjen e huaj si parakushte të bashkëpunimit dhe afrimit me rajonin e Ballkanit, mund të vërehet se orientimi i politikës së jashtme nuk karakterizohej nga mbisundimi i dogmës ideologjike. Kjo sepse, një pjesë e përfaqësuesve të regjimit të socializmit shtetëror, kryesisht ministri i jashtëm Malile, paraqesin apo huazojnë forma të bashkëpunimit me vendet e Ballkanit sikurse janë “riaktivizimi i Komiteteve të Mirëkuptimit Ballkanik” (1988: 48),

që do të përfshinin edhe “parlamentarë, gazetarë, shkrimtarë, përfaqësues të organizatave të masave” (1988: 48), që nuk i përkasin mirëfilli e nuk ngjasojnë me format autokratike të sundimit të regjimit në politikën e vet të brendshme.

Një numër çështjesh të cilat rimerren edhe pas periudhës së luftës etnike në ish-Jugosllavi, përmes mekanizmave të bashkëpunimit rajonal të mbështetur nga Komitetet Evropiane apo SHBA-të, përmenden rishtazi në diskutimet dhe rezolutat e Konferencave Ballkanike të vitit 1988 dhe të tetorit 1990 zhvilluar në Tiranë. Këto çështje përfshijnë bashkëpunimin midis vendeve të Ballkanit në fushën ekonomike, politike apo kulturore, sikurse edhe dialogun politik shumëpalësh (Konferenca Ballkanike, 1990: 4). Më konkretisht në Konferencën Ballkanike të mbajtur në Tiranë në vitin 1990-të theksohet se: “Një Ballkan i qëndrueshëm, që përparon në vijim të zhvillimeve të tanishme, është një faktor i paqes dhe sigurisë për tërë rajonin e Mesdheut dhe Evropën” (po aty, fq. 4).

Vlen të nënvizohet se, orientimi i politikës së jashtme të regjimit të socializmit shtetëror në fundin e viteve 80-të ka si tipar kryesor skepticizmin dhe mos-angazhimin në organizmat rajonale apo ushtarake si NATO, kundërshtitë ideologjike ndaj dy superfuqive, duke i dhënë përparësi intensifikimit të bashkëpunimit me vendet e Ballkanit, pa diferencuar mes regjimeve të ndryshme politike në Ballkan.

Një nga argumentet kryesorë të këtij punimi është se trashëgimia ideore dhe ideologjike në politikën e jashtme të regjimit komunist ndikon në formulimet e orientimeve të politikës së jashtme, fillimisht të Partisë së Punës së Shqipërisë (PPSH) në vitin 1991 dhe si rrjedhim edhe të Partisë Socialiste të Shqipërisë (PSSH) pas qershorit të vitit 1991. Ky ndikim vërehet të jetë i dukshëm deri në vitin 1996. Në të njëjtën kohë, sikurse do të vërehet dhe paraqitet në vijim, pas ndryshimit të regjimit

partitë kryesore politike, Partia Demokratike dhe Partia Socialiste, dominohen nga dallime të dukshme ideologjike dhe ideore kryesisht në formulimin e objektivave dhe orientimeve të politikës së jashtme.

Orientimet e politikës së jashtme të Partisë Socialiste të Shqipërisë: midis trashëgimisë ideologjike dhe risive programore

Ndryshimi i regjimit në vitin 1990, nuk solli ndonjë përafrim të qëndrimeve dhe orientimeve të politikës së jashtme midis ish-komunistëve dhe opozitës demokratike të përfaqësuar nga Partia Demokratike. Mungesa e një konsensusi dy-partiak mbi politikën e jashtme të Shqipërisë do të vijoje deri nga mesi i viteve 2000. Një nga arsyt e kësaj divergjence midis dy partive kryesore është prania e ulët ligjërimore dhe normative e Evropës Perëndimore (këtu Bashkimi Evropian), pavarësisht përfshirjes së Shqipërisë në programin PHARE apo dhënien menjëherë pas ndryshimit të regjimit, të statusit të vendit të favorizuar në tregtinë me BE-në.

Vlen të nënvizohet se, një tjetër arsye është edhe politizimi i dyanshëm i politikës së jashtme, për arsye të ndryshme, nga secila prej partive dominuese dhe elitave të tyre drejtuese. Ngurimi i përfaqësuesve të regjimit për të ndërmarrë ndryshime rrënjësore në vendosjen e një sistemi politik të demokracisë liberale dhe të një ekonomie të tregut, të mbështetur në njohjen dhe mbrojtjen e të drejtave të pronësisë, ishte i ndërlikuar me një orientim të caktuar ideor dhe ideologjik të politikës së jashtme, që pranonte kryesisht një hapje dhe bashkëpunim vetëm në rajonin e Ballkanit. Ndërkohë, përfaqësuesit e partisë kryesore opozitare do të karakterizoheshin nga një orientim më të drejtpërdrejtë të politikës së jashtme, që konsistonte në favor të bashkëpunimit me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, dhe një politike të jashtme

më skeptike ndaj fqinjëve në rajon, duke i dhënë veçanërisht prioritet çështjes shqiptare (Pettifer dhe Vickers, 2007).

Midis viteve 1991-1996, Partia Socialiste e Shqipërisë nuk do të ndërmerre një ndryshim rrënjësor dhe të plotë të orientimeve të politikës së jashtme, duke vijuar kësaj nën ndikimin e trashëgimisë ideore dhe deri diku ideologjike të mbartur nga regjimi i socializmit shtetëror. Përpjekjet e saj për t'u dalluar nga periudha e sundimit diktatorial në politikën e jashtme, do të jenë jo fort të qarta. Nga ana tjetër, vlen të nënvizohet se, Partia Socialiste dhe përfaqësuesit e saj kryesorë, sikurse ishte traditë edhe në periudhën e socializmit shtetëror, prirën të largohen nga anëtarësimi dhe përafrimi i politikës së jashtme të Shqipërisë me një superfuqi apo me një fuqi të madhe.

Në zgjedhjet e para pluraliste të 31 Marsit 1991, kur ende PPSH nuk kishte nisur një proces të brendshëm reformimi, duke qenë se Ramiz Alia vazhdonte funksionin e tij si Sekretar i Parë, kjo parti paraqiti në programin e vet elektoral një numër qëndrimesh mbi politikën e jashtme të Shqipërisë. Duke mos iu shmangur përdorimit të frazave të ngarkuara ideologjikisht, sikurse është përmendja e rolit të PPSH-së në: "ruajtjen dhe konsolidimin e pavarësisë, identitetit kombëtar dhe sovranitetit shtetëror në kushtet e Luftës së Ftohtë në Evropë" (PPSH, 1991: 1), programi politik i zgjedhjeve të vitit 1991 thekson si objektiv: "Eliminimin e ndasive dhe dallimeve, të krijuara nga politika e dy blloqeve dhe e mentaliteteve të rrezikshme të kohës së Luftës së Ftohtë" (1991: 7). Si rrjedhojë e këtij qëndrimi, të mos-angazhimit në traktate dhe organizata ushtarake, buron edhe skepticizmi dhe ngurimi ndaj mbështetjes së anëtarësimit të Shqipërisë në NATO. Për më tepër, në vijim të këtij orientimi të politikës së jashtme, e majta shqiptare shprehet në programin elektoral të zgjedhjeve parlamentare të vitit

1992, kategorikisht kundër anëtarësimit apo përafrimit të politikës së jashtme të Shqipërisë me vende të veçanta, duke mbajtur kështu një qëndrim kundërt strategjisë së orientimit pro-amerikan të politikës së jashtme nga Partia Demokratike. Më konkretisht, në pjesën programore të platformës elektorale të PSSH për zgjedhjet e Marsit 1992, në lidhje me politikën e jashtme, nënvizohet se "Shqipëria duhet të shmangë marrëdhëniet unilaterale (të njëanshme) me vende të veçanta, ose me grup vendesh" (PSSH, 1992: 16). Ndërsa për sa i përket bashkëpunimit me vendet e Ballkanit, PSSH e cilëson si një prioritet, që duhet të kishte politika e jashtme e Shqipërisë.

Për më tepër, ish-komunistët dhe më tej PSSH e konsiderojnë nismën e bashkëpunimit dhe koordinimit me vendet e Ballkanit, si një nismë të ndërmarrë fillimisht prej vetë kësaj partie: "Politika e fqinjësisë së mirë e shtetit tonë është dhe do të mbetet e pandryshuar. PPSH ka autorësinë e kësaj politike që prej fillimit" (Programi elektoral 1991: 8). Duke qenë më specifik në lidhje me këtë orientim ballkanik të politikës së jashtme, PPSH thekson se "Partia jonë do të ndjekë vullnetin e saj të bashkëpunimit paqësor që ky të jetë edhe tipari dallues afatgjatë i politikës sonë të jashtme në marrëdhënie me fqinjët" (1991: 8). Edhe pas themelimit të Partisë Socialiste, në programin politik dhe elektoral të 1992-it, ritheksohet se: "Politika e jashtme e Shqipërisë duhet të përmbushë në mënyrë aktive bashkëpunimin dhe marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë me vendet e rajonit të Ballkanit". Nga ana tjetër, duhet përmendur se PPSH në 1991, pa saktësuar e mbështetur një orientim nacionalist në politikën e jashtme, e pranon ekzistencën e problemeve të minoriteteve etnike në Ballkan dhe mes të tjerave nënvizon se "...do të mbështesë dhe inkurajojë plotësisht, dhe pa hezitim, të gjitha kërkesat për të drejtat kombëtare (etnike) dhe demokratike të shqiptarëve në Jugosllavi".

Hapja e Shqipërisë ndaj Evropës konsiderohet e rëndësishme nga PSSH, duke marrë parasysh anëtarësimin e Shqipërisë në KSBE (sot OSBE), po pa u cilësuar si prioritet kryesor të politikës së jashtme, të paktën deri në vitin 1996 apo dhe 1997. Më konkretisht theksohet se: “Hapja e Shqipërisë ndaj Evropës dhe botës duhet të bëhet në bazë të parimeve të përgjithshme – paqes, lirisë, demokracisë, humanizmit, dhe në përputhje me parimet e njohura që rregullojnë marrëdhëniet midis shteteve” (Programi elektorale 1992: 16). Në këtë formulim të preferencave dhe orientimit të politikës së jashtme të Shqipërisë ndaj Evropës, sipas PSSH, vërehet trashëgimia ideologjike dhe ideore e regjimit të socializmit shtetëror që theksonte si themelore – një formë vetë-izolimi apo neutraliteti në politikën e jashtme – mbrojtjen e sovranitetit, të identitetit të kombit dhe lirisë. Ajo çka merr rëndësi për PSSH në fillim të viteve 1990 është vetëdija se e “...ardhmja e Shqipërisë është në anëtarësimin në institucionet ndërkombëtare si Tregu i Përbashkët Evropian dhe Marrëveshja e Përgjithshme mbi Tarifatat dhe Tregtinë (GATT). Në vijim të këtij qëndrimi në politikën e jashtme, PSSH e cilëson si të pamundur “zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të Shqipërisë pa integrimin e saj në Evropë” (1992: 16). Pavarësisht këtij qëndrimi më të moderuar ndaj Evropës, qasja e PSSH dhe e forcave të majta në përgjithësi në fillim të viteve 90-të ndaj Bashkimit Evropian mbetet e vagullt dhe jo konkrete.

Orientimet dhe preferencat e politikës së jashtme të PSSH mbeten të njëjtat edhe pas mesit të viteve 1990-të, duke i dhënë përparësi marrëdhënieve më të ngushta me vendet fqinje në Ballkan apo duke ripërsëritur si vlera kryesore paqen, stabilitetin dhe evropianizimin e Ballkanit. Kështu, në programin elektorale të vitit 1996 nënvizohet se: “Politika jonë e jashtme do të jetë aktive për ruajtjen e paqes, stabilitetit

dhe forcimit të bashkëpunimit bilateral dhe shumëplanësh në Ballkan” (PSSH, 1996: 68).

Ndryshe nga Partia Demokratike e Shqipërisë, PSSH paraqet si një objektivi të mundshëm të politikës së jashtme rajonale të Shqipërisë, “rritjen e shkëmbimeve ekonomike me interes të përbashkët” (1996: 69) me Serbinë dhe Malin e Zi. Partia Socialiste mbështet idenë e “një Ballkani si Evropa” (1996: 69) duke u shprehur për “evropianizimin e marrëdhënieve ballkanike” (1996: 68). Vlen të theksohet se krahas këtyre prioritetëve specifike, PSSH e konsideron integrimin euro-atlantik si një objektivi të përgjithshëm, duke përmendur rishtazi vetëm në vitin 1996 synimin për anëtarësimin e Shqipërisë në NATO.

Orientimet e politikës së jashtme të Partisë Demokratike të Shqipërisë: çështja shqiptare, angazhimi në NATO dhe skepticizmi ndaj fqinjëve

Partia Demokratike, që prej fillimeve të saj kishte në përbërje disa fraksione të dallueshme ideologjike që nga liberalë deri tek konservatorë e nacionalistë. Në programin elektorale të vitit 1991, ku paraqiteshin shkurtimisht objektivat dhe idetë mbi politikën e jashtme të vendit, vërehej se për këto politika kishte një vijueshmëri me qëndrimet e PSSH, por pa i formuluar në zhargonin e ngarkesën ideologjike që karakterizonte komunikimin politik të përfaqësuesve të regjimit të socializmit shtetëror.

Kështu, në lidhje me marrëdhëniet me fqinjët në Ballkan, Partia Demokratike si opozitë, kishte një qëndrim të moderuar dhe të përafërt me ish-komunistët kur theksonte se: “Partia Demokratike do të zbatojë me përparësi një politikë të fqinjësisë së mirë mbi bazën e ruajtjes së interesit tonë kombëtar në Ballkanin Perëndimor dhe në një rajon më të gjerë” (PDSH, 1991: 1). Në vijim të këtij

qëndrimi të moderuar ndaj bashkëpunimit me vendet e Ballkanit artikullohet se: “Partia Demokratike do të përpiqet që Ballkani të bëhet shembull i paqes dhe mirëkuptimit mes popujve të tij” (1991: 1).

Vlen të theksohet se, ndryshe nga përfaqësues të regjimit, që ndërlidhnin politikën e jashtme me sovranitetin shtetëror, mos-përfshirjen në organizata apo dhe aleanca politiko-ushtarake si NATO, përfaqësuesit e Partisë Demokratike fillojnë të artikulojnë konceptin e interesit kombëtar.

Pavarësisht ngjashmërive të sipërpërmendura në qëndrimet midis dy partive kryesore politike dhe grupimeve përkatëse të elitës politike të pas vitit 1990, që mund të kishin ndikuar në formimin e një qëndrimi konsensual mbi politikën e jashtme, Partia Demokratike në dallim nga ish-komunistët paraqet si objektiv të politikës së jashtme “...një politikë të re kombëtare të shtetit shqiptar mbi çështjen shqiptare në përmbushje të aspiratave të popullit shqiptar për bashkimin kombëtar dhe prosperitetin në përputhje me dokumentet ndërkombëtare të OKB-së dhe KSBE-së - më tej OSBE (OSCE, 1991: 1).

Në programin elektorale të vitit 1992, paraqiten në mënyrë më të zgjeruar objektivat e politikës së jashtme, që më pas reflektohen edhe në programin qeverisës në vitet 1992-1996. Partia Demokratike i konsideron marrëdhëniet me SHBA-në si tepër të rëndësishme. “Ne mendojmë se marrëdhëniet prioritare me SHBA-në dhe vendet demokratike të Evropës Perëndimore janë një kusht i pazëvendësueshëm për përmbushjen e politikës sonë të jashtme” (PDSH, 1992: 3). Autorët Pettifer dhe Vickers (2007: 76) shprehin se e tërë elita drejtuese dhe politike në Shqipërinë e pas viteve 90 -të, për shkak të përvojës së regjimit diktatorial të rreshtuar përherë me një superfuqi, do të shfaqte të njëjtin qëndrim dhe përafrim të marrëdhënieve me SHBA-të pas ndryshimit të regjimit.

Megjithatë, vihet re se vendosja si objektiv të politikës së jashtme, që në krye të herës për të patur marrëdhënie më të ngushta me SHBA-në, i përket vetëm një pjese të elitës politike, konkretisht Partisë Demokratike. Ndërsa, në lidhje me anëtarësimin e mundshëm të Shqipërisë në aleancën politiko - ushtarake të NATOS-s, qëndrimi dhe objektivat e Partisë Demokratike janë artikuluar në mënyrë më të drejtpërdrejtë dhe në mbështetje të këtij anëtarësimi, krahasuar me skepticizmin që ka karakterizuar Partinë Socialiste të paktën deri në vitet 1996-1997.

Kështu, në programin elektorale të vitit 1992, Partia Demokratike e konsideron NATO-n: “..garante të paqes dhe stabilitetit në Evropën e tanishme...” (DSH, 1992: 3) duke theksuar se: “synojmë anëtarësimin e Shqipërisë në këtë organizatë” (1992: 3).

Një nga objektivat e politikës së jashtme që duhet të kishte Shqipëria sipas Partisë Demokratike, përfshinte edhe marrëdhëniet e mira me vendet e Ballkanit. Megjithatë, në këtë objektiv të politikës së jashtme, shfaq një preferencë më të dallueshme dhe një tjetër qëndrim krahasuar me Partinë Socialiste. Fillimisht, Partia Demokratike e konsideron ‘çështjen shqiptare’ si një nga prioritetet e politikës së jashtme: “Ne mendojmë se çështja e shqiptarëve që jetojnë në territoret e tyre autoktone në ish-Jugosllavi ka një rëndësi të veçantë dhe do të jetë për rrjedhojë një objektiv themelor i politikës sonë të jashtme” (1992: 4).

Nga njëra anë Partia Demokratike dhe elitat e saj drejtuese shprehin se: “Ne mbështesim proceset integruuese në Ballkan” (1992: 3), ndërsa në tekstin programatik mbi politikën e jashtme mbahen qëndrime që e distancojnë Shqipërinë nga krijimi i raporteve të ngushta me vendet e Ballkanit kur nënvizojnë se: “Për sa i përket marrëdhënieve tona me Serbinë dhe Malin e Zi, ne jemi të mendimit se është e vështirë të flitet për zhvillim normal të marrëdhënieve për sa kohë që represioni dhe dhuna sundojnë mbi popullsinë shqiptare që jeton

në trojet e veta autoktone” (1992: 3).

Vlen të theksojmë se, pothuajse të njëjtat objektiva dhe përparësi të politikës së jashtme të Partisë Demokratike ripërsëriten edhe në programin politik të saj të vitit 1996, ku shprehen në mbështetje të: “konsolidimit të vokacionit Evropian Perëndimor, si boshti i natyrshëm dhe udhëheqës i politikës së jashtme të Shqipërisë” (Programi elektoral 1996: 61). Megjithatë, duhet përmendur se në të njëjtën periudhë qeverisja e Partisë Demokratike e zhvendosi Shqipërinë nga një vend me regjim demokratik ende të pakonsoliduar, në një vend me regjim hibrid (McKinsey, 1996). Në raport me vendet e Ballkanit, Partia Demokratike dhe elita e saj drejtuese, mban qëndrim pro bashkëpunimit, por në një trajtë më të kushtëzuar. Ky kushtëzim lidhet me ngarkesën ideologjike dhe ideore të orientimit pro-perëndimor që reflektohet edhe në programin e saj politik, në të cilin nënvizohet disa herë: “...Bashkëpunimi rajonal me orientim të qartë perëndimor” (1996: 61). Partia Demokratike “bashkëpunimin ballkanik dhe mesdhetar e konsideron si një faktor të rëndësishëm për konsolidimin e orientimit perëndimor dhe integritetit të saj të plotë në Evropë” (1996: 61). Kështu, orientimi i politikës së jashtme të Partisë Demokratike ndaj vendeve të Ballkanit shihet i ndërthurur me togfjalëshin ‘orientim perëndimor’.

Në programin politik për periudhën 1992-1996, paraqiten të njëjtat objektiva si prioritete në politikën e jashtme të tilla si: “ndërkombëtarizimi i çështjes mbarëshqiptare” (Meksi, 1992), sikundër dhe: “marrëdhëniet me demokracitë e konsoliduara si SHBA-të dhe Evropën Perëndimore” (Po aty). Për sa i takon bashkëpunimit me vendet e Ballkanit, programi qeverisës i Partisë Demokratike nënvizon shkurtime të politikës së fqinjësisë së mirë, duke theksuar se marrëdhëniet me Greqinë do të merrnin përparësi krahasuar me fqinjët e tjerë (Po aty).

Deri në mesin e viteve 2000, midis

Partisë Demokratike dhe Partisë Socialiste vijonte të kishte një dallim ideor në hartimin e objektivave dhe orientimeve të politikës së jashtme të Shqipërisë. Partia Socialiste, si rrjedhojë edhe e trashëgimisë ideologjike dhe sundimit të një pjesë të elitës së saj drejtuese në periudhën e vonët të socializmit shtetëror, theksonte mos-angazhimin në organizata dhe aleanca politiko-ushtarake apo qëndrime jo shumë në favor të pozicionimit me një fuqi të madhe, duke i dhënë më tepër prioritet angazhimit dhe bashkëpunimit me vendet fqinje të Ballkanit. Nga ana tjetër, Partia Demokratike në politikën e jashtme përgjatë kësaj periudhe shfaq një orientim më pro perëndimor dhe për rrjedhojë i jep prioritet krijimit të marrëdhënieve me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Evropës Perëndimore, sikundër edhe anëtarësimit të vendit në aleancën politiko-ushtarake të NATO-s, por ndërkohë është karakterizuar nga qëndrime skeptike në raport me intensifikimin e marrëdhënieve me vendet e Ballkanit dhe fqinjët.

Midis konsensusit në politikën e jashtme dhe ndasive mbi politikën rajonale dhe çështjen shqiptare

Pas vitit 1997 e në vijim, kur filloi të kishte një prezencë edhe më të madhe të komunitetit ndërkombëtar në Shqipëri, Partia Socialiste ndërmerr një rishikim të politikës së jashtme, por duke vijuar më tej me një prej objektivave kryesorë sipas saj, sikurse ishin raportet me vendet e Ballkanit dhe fqinjët. Në programin e qeverisë Nano (1997-1998) cilësohet se: “Marrëdhëniet me SHBA-në ne i konsiderojmë si shumë të rëndësishme për Shqipërinë dhe jetike për prosperitetin demokratik të saj” (46). Për herë të parë në këtë program qeverisës të së majtës shqiptare vendoset si preferencë e objektiv i politikës së jashtme “anëtarësimi i plotë në NATO” (Nano, 1997: 45). Ky orientim dhe objektiv përsëritet edhe nga një tjetër përfaqësues i Partisë Socialiste gjatë

mandatit të tij si kryeministër: “Integrimi evropian dhe euro-atlantik i vendit është objektiv strategjik dhe drejtimi kryesor, tashmë i konsoliduar i politikës së jashtme të Shqipërisë” (Meta, 1999: 14).

Nga ana tjetër të ndikuar nga idetë e evropianizimit të Ballkanit, qeveria socialiste i paraqet marrëdhëniet midis vendeve të Ballkanit, jo më si një formë e bashkëpunimit ngushtazi rajonale, por si një proces: “bashkëpunimi dhe mirëkuptimi rajonal në një Ballkan të qëndrueshëm e të qetë, në kuadrin e një Evrope të bashkuar” (Programi i Qeverisë Nano 1997-1998: 45). Të njëjtat ide dhe konceptime mbi Ballkanin dhe bashkëpunimin rajonal ripërsëriten në programin qeverisës të Partisë Socialiste të periudhës 2002-2005. Koncepti i saj është se: “integrimi evropian për Shqipërinë fillon tek fqinjësia e mirë, tek integrimi dhe bashkëpunimi rajonal si komponent themelor i politikës sonë edhe në Ballkan” (14). Për sa i përket ‘çështjes shqiptare’, dhe më konkretisht statusit dhe konfliktit në Kosovë, qeverisja e majtë vazhdonte të kishte një qëndrim të ndryshëm nga Partia Demokratike. Partia Socialiste e zhvendos statusin dhe konfliktin në Kosovë nga pjesë të çështjes shqiptare në një çështje ndërkombëtare duke theksuar se: “Marrëdhëniet tona me Kosovën nuk do të ndërtohen nga një këndvështrim i ngushtë shqiptar, por në kuadrin e gjerë të bashkëpunimit rajonal dhe euroatlantik midis popullsisë, vendeve dhe njësive vetëqeverisëse të Ballkanit” (Nano, 2002: 15).

Një konceptim i tillë i objektivave të politikës së jashtme shqiptare, të ndjekur nga socialistët, në raport me fqinjët dhe evropianizimin e Ballkanit manifestohet edhe në pjesëmarrjen e kryeministrit Nano në Samitin e Kretës në vitin 1997, ku flitet për “strategjinë e ‘rrethimit demokratik’ të Serbisë” (Fuga 2008: 391; Moore, 1997). Një nga synimet e këtij takimi, mes të tjerave ishte edhe zhvillimi i marrëdhënieve ekonomike e tregtare me fqinjët, si objektiv

i qeverisë socialiste (Pettifer dhe Vickers 2007: 134). Një pozicionim i tillë në politikën e jashtme, mes një konteksti me mjaft paqartësi, u konsiderua i pavend dhe jo i matur nga opozita e kësaj periudhe, që përfaqësohej nga Partia Demokratike (Fuga 2008: 391).

Qëndrime të ndryshme midis dy partive kryesore mbi orientimin e politikës së jashtme kanë dominuar edhe periudhën në vazhdim, edhe pas një konsensusi në politikën e jashtme në lidhje me objektivat kryesore, në raport me marrëdhëniet me ish-Jugosllavinë e mbetur (federate e Serbisë dhe Malit të Zi) apo edhe më tej me Republikën e Serbisë, pas shkëputjes së Malit të Zi. Një prej momenteve të shkrirjes së akujve midis Beogradit dhe Tiranës konsiderohet vizita në Beograd në vitin 2002 e Kryeministrit Ilir Meta, si përfaqësues i qeverisë socialiste, e cila pati mjaft jehonë, përmes kundërshtimeve, moskuptimeve dhe vlerësimeve (Misha, 2002).

Përfundime

Ndryshimet sistemike të rendit ndërkombëtar nga një sistem dypolar të Luftës së Ftohtë, në një sistem njëpolar të dominuar nga SHBA-të, së bashku me ndryshimet e regjimeve në Evropën Lindore paskomuniste mund të konsiderohen prej studimeve ekzistuese si të mjaftueshme për të kushtëzuar politikën e jashtme të vendeve të vogla, të cilat sikurse pranohej prej shumë studiuesve e kanë të vështirë të mundësojnë sigurinë e tyre dhe prirjen të rreshtohen më një fuqi të madhe. Përkundër këtyre shpjegimeve dominuese të studimeve të marrëdhënieve ndërkombëtare, që theksojnë rolin e shkaqeve strukturore në konceptimin e politikës së jashtme, ky punim kishte si synim teorik të shpjegonte arsyet e mungesës së konsensusit të elitave drejtuese për politikën e jashtme të Shqipërisë, që prej viteve të fundit të diktaturës së socializmit shtetëror dhe periudhës së ndryshimit të

regjimit deri në fillim të dekadës së dytë të Shqipërisë paskomuniste.

Duke u mbështetur në perspektivën teorike që thekson rolin e ideve, konstruktive ideologjike dhe përfytyrimeve konceptuale të elitave drejtuese me ndikim në politikën e jashtme, punimi argumenton se përpjekjet e para dhe eksperiencia historike e marrëdhënieve me vendet e Ballkanit, pavarësisht natyrës së ndryshme të regjimeve, që u zhvillua gjatë periudhës së vonët të diktaturës, përcaktoi trashëgiminë ideore dhe ideologjike të Partisë Socialiste të Shqipërisë. Në këtë mënyrë, në kushtet e mungesës së një ndikimi ekonomik e normativ të Evropës Perëndimore (Bashkimi Evropian) dhe Perëndimit në tërësi, në gati një dekadë qëndrimet dhe orientimet e politikës së jashtme të elitës politike ishin të ndryshme dhe larg një konsensusi

të pritshëm. Politika e jashtme, në një kontekst më të gjerë, funksiononte gjatë periudhës së tranzicionit dhe formësimit të shoqërisë politike, edhe si një ndasi ideore në mos ideologjike, midis partive politike dominuese në Shqipëri. Partia Demokratike, si partia kryesore e opozitës dhe më pas parti qeverisëse, mbështeste që në krye të herës rreshtimin me SHBA-të dhe anëtarësimin në NATO, ndërkohë që shfaqej skeptike ndaj afirmimit të bashkëpunimit me fqinjët në Ballkan. Të kundërtat e këtyre qëndrimeve dhe orientimeve në politikën e jashtme vëreheshin tek përfaqësuesit e Partisë Socialiste, të cilët përveç afrimit me Evropën Perëndimore apo edhe më tej pranimit si synim të politikës së jashtme anëtarësimin në NATO, i jepnin prioritet krijimit të marrëdhënieve të ngushta me vendet e Ballkanit.

REFERENCAT

- Alia, R. (1988). "Fjalimi në Konferencën Ballkanike", *Albania Today: Political and Informative Review*, 1(71), 44-45.
- Anastasakis, O. (2005). 'The Europeanization of the Balkans', *Brown J. World Aff.*, 12, pp. 77-86
- Barbullushi, O. (2016). 'The Limits and Ambiguities of the Albanian "National Question" in Post-communism: Political Parties, Albanian Nationalism, and External Actors', *East European Politics and Societies*, 30(03), pp. 551-570.
- Biberaj, E. (2014). *Shqipëria dhe Shqiptarët në rrugën e rimëkëmbjes*. Tirana: AIIS Tirana Times.
- Fraseri, E. (2016). *Of Knights and Squires: European Union and the Modernization of Albania*. CID Research Fellow and Graduate Student, Working Paper No. 81. March. Harvard University.
- Fuga, A. (2008). *Media, Politika, Shoqëria (1990 – 2000)*, Tiranë: Duda.
- Gvalia, G., Lebanidze, B., & Siroky, D. S. (2019). 'Neoclassical realism and small states: Systemic constraints and domestic filters in Georgia's foreign policy', *East European Politics*.
- Gvalia, G., Siroky, D., Lebanidze, B., & Iashvili, Z. (2013). 'Thinking outside the bloc: Explaining the foreign policies of small states', *Security Studies*, 22(1), 98-131.
- Gjevari, E. (2018). 'Kin state non-interventionism: Albania and regional stability in the Western Balkans', *Nations and Nationalism*, 24(1), pp.171-193.
- Horowitz, S., & Tyburski, M. (2016). 'When are similar regimes more likely to form alliances? Institutions and ideologies in the post-communist world', *Post-Soviet Affairs*, 32(2), 176-200.
- Jenne, E.K. (2021). 'Populism, nationalism and revisionist foreign policy', *International Affairs* 97: 2 (2021) 323-343.
- Owen, John M. (2021). 'Transnational Liberalism and U.S. Primacy', *International Security* 26, no. 3 (Winter 2001-2): 122-23.

- Konferenca Ballkanike. (1990). 24-25 Tetor, *Komunikata e Përbashkët* [Njoftim për shtyp]. United Nations General Assembly 45th Session.
- Krasniqi, A. (2014). 'Albanian transition - the contrast between eastern mentality and european identity', *Interdisciplinary Journal of Research and Development*, Vol (I), No.1.
- Malile, R. (1988). Fjalimi në Konferencën Ballkanike. *Albania Today: Political and Informative Review*, 1(71), 45-48.
- McKinsey, K. (1996). Albania: President plans elections despite widespread criticism. *Radio Free Europe/Radio Liberty*, 22 Gusht; <https://www.rferl.org/a/1081264.html>
- Meksi, Aleksander. (1992). "Programi i Qeverisë", <https://shtetiweb.org/2015/09/13/programi-qeverise-aleksander-meksi-1992-1996/> (18 Shkurt 2025).
- Meta, Ilir. (1999). "Programi i Qeverisë"; <https://shtetiweb.org/2015/09/14/programi-qeverise-ilir-meta-2-6-shtator-2001-29-janar-2002/> (18 Shkurt 2025).
- Misha, T. (2002). Albania: Relations with Serbia improve. *Institute for War & Peace Reporting*, 15 Maj; <https://iwpr.net/global-voices/albania-relations-serbia-improve>
- Moore, P. (1997). Balkan states: Crete summit points to more instability. *Radio Free Europe/Radio Liberty*, 9 Nëntor; <https://www.rferl.org/a/1087151.html>
- Nano, Fatos. (1997). "Programi i Qeverisë"; <https://shtetiweb.org/2015/09/14/programi-qeverise-fatos-nano-2-25-korrik-1997-28-shtator-1998/> (18 Shkurt 2025).
- Nano, Fatos. (2002). "Programi i Qeverisë"; <https://shtetiweb.org/2015/09/13/programi-qeverise-fatos-nano-4-2002-2005/> (18 Shkurt 2025).
- Partia Demokratike e Shqipërisë, PDSH. (1991). "Programi Elektoral", *Manifesto Project Dataset*. https://visuals.manifesto-project.wzb.eu/mpdb-shiny/cmp_dashboard_dataset/
- Partia Demokratike e Shqipërisë, PDSH. (1992). "Programi Elektoral", *Manifesto Project Datasets*, https://visuals.manifesto-project.wzb.eu/mpdb-shiny/cmp_dashboard_dataset/
- Partia e Punës e Shqipërisë, PPSH. (1991). "Programi Elektoral", *Manifesto Project Dataset*, https://visuals.manifesto-project.wzb.eu/mpdb-shiny/cmp_dashboard_dataset/
- Partia Socialiste e Shqipërisë, PSSH. (1992). "Programi elektoral", *Manifesto Project Dataset*; https://visuals.manifesto-project.wzb.eu/mpdb-shiny/cmp_dashboard_dataset/
- Partia Socialiste e Shqipërisë, PSSH. (1996). "Programi Elektoral", *Manifesto Project Dataset*; https://visuals.manifesto-project.wzb.eu/mpdb-shiny/cmp_dashboard_dataset/
- Pettifer, J., & Vickers, M. (2007). *The Albanian Question: Reshaping the Balkans*. I. B. Tauris
- Ratti, L. (2006). 'Post-Cold War Nato and international relations theory: The case for neo-classical realism', *Journal of Transatlantic Studies*, 4(1), 81-110.
- Ripsman, N. M. (2009) 'Neoclassical realism and domestic interest groups', In S. E. Lobell, N. M. Ripsman, & J. W. Taliaferro (Eds.), *Neoclassical realism, the state, and foreign policy* (170-194). Cambridge University Press.
- Ripsman, N. M.; Taliaferro, J. W. & Lobell, S. E. (2016). *Neoclassical realist theory of international politics*. Oxford University Press.
- Ripsman, N. M.; Taliaferro, J. W. & Lobell, S. E. (Eds.). (2009). 'Conclusion: The state of neoclassical realism', In S. E. Lobell, N. M. Ripsman, & J. W. Taliaferro (Eds.), *Neoclassical realism, the state, and foreign policy* (pp. 280-300). Cambridge University Press.
- Robison, S. B. (2011). 'Experiential learning by U.S. presidents: Domestic and international influences in the post-Cold War world', In S. G. Walker, A. Malici, & M. Schafer (Eds.), *Rethinking foreign policy analysis*:

- States, leaders, and the microfoundations of behavioral international relations* (pp. 189–205). Routledge.
- Rose, G. (1998). 'Neoclassical realism and theories of foreign policy', *World politics*, 51(1), 144–172.
- Rothstein, Robert L. (1968). *Alliances and Small Powers*. New York: Columbia University Press.
- Snyder, J. (1991). *Myths of Empire: Domestic politics and international ambition*. Cornell University Press.

ABSTRACT

Albania's foreign policy in the post-communist period and the role of the political elite

This study analyzes the changes in the orientation of Albania's foreign policy in the period before and after the overthrow of the communist regime until the end of the second decade after 1990. For this purpose, the focus of this paper is on identifying the influence and role that Albanian political elites have played in shaping these foreign policy orientations. Relying on a qualitative interpretive methodological approach, this article analyses how ideas, ideological characteristics, and historical experience have influenced foreign policy decision-making by the political elite. The study is based on the analysis of empirical data such as: speeches of the ruling elite, political and electoral manifestos, as well as government programs with the aim of formulating and conceptualizing Albania's foreign policy by the political elite. This paper highlights that in the absence of consensus on the orientation of foreign policy that characterized the political elites of the main parties in the first years after the fall of the communist system and in the conditions of a non-significant Western influence, Albania's foreign policy has been determined mainly by internal ideological divisions and not by external structural forces. In this sense, internal political dynamics have played a critical role in shaping the trajectory of foreign policy in post-communist Albania.

Keywords: *foreign policy, Albania, political elite, post-communist transition, domestic politics, ideological changes*

SFIDAT DHE AVANTAZHET E QASJES NDAJ INTEGRITETIT NË SHQIPËRI: VLERËSIMI I PLANEVE TË INTEGRITETIT NË KATËR MINISTRI

Nysjola DHOGA
Universiteti i Tiranës
Fakulteti i Shkencave Sociale
Departamentit të Shkencave Politike
E-mail: nysjola.dhoga@gmail.com

Rovena SULSTAROVA
Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) Tiranë
E-mail: rsulstarova@idmalbania.org

PËRMBLEDHJE

Literatura dallon dy qasje në strategjitë e menaxhimit të etikës në organizata: një që i referohet përputhshmërisë dhe një të bazuar mbi vlerat apo integritetin, të cilat duhet të integrohen me njëra – tjetrën. Edhe Shqipëria vitet e fundit, përkrah miratimit të një kuadri të gjerë ligjor kundër korrupsionit dhe ngritjen e strukturave të posaçme për hetimin dhe ndëshkimin e tij, ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm për të nxitur kulturën e integritetit nëpërmjet miratimit të planeve të integritetit në nivel të qeverisjes qendrore dhe vendore. Planet e Integritetit në thelb janë një dokument strategjik dhe operacional tre vjeçar që vjen si rrjedhojë e identifikimit të risqeve të integritetit në fushat e përgjithshme dhe të veçanta të veprimtarisë së institucionit dhe përcaktimit të masave për të minimizuar këto risqe nga vetë punonjësit. Edhe pse plani i integritetit është i personalizuar për çdo institucion, ky studim, duke analizuar risqet në katër ministri tregon se disa nga sfidat me të cilat ato përballen janë të ngjashme apo të njëjta. Nga ana tjetër, studimi analizon se cilat janë avantazhet e qasjes ndaj integritetit për të nxitur kulturën etike në qeverisjen shqiptare.

Fjalë Kyçe: *Kultura Organizative, Përputhshmëri, Integritet, Plan Integriteti*

Dr. **Nysjola DHOGA** është pedagoge pranë Departamentit të Shkencave Politike, Fakulteti i Shkencave Sociale, Universiteti i Tiranës. Fushat e saj të kërkimit janë Administrata Shqiptare, Sistemet Politike në Shqipëri dhe në rajon dhe qeverisja në shumë-nivele.

Dr. **Rovena SULSTAROVA** është eksperte në fushën e antikorrupsionit dhe zhvillimit të politikave për parandalimin e korrupsionit në administratën publike. Ajo ka kontribuar në forcimin e integritetit institucional dhe rritjen e transparencës në proceset qeverisëse.

Qasja kundrejt përputhshmërisë dhe qasja kundrejt integritetit

Një ndër përkufizimet që përdoret gjerësisht kur flitet për korrupsionin është ai i Transparency International që e përkufizon atë si abuzim me pushtetin e besuar për përfitime private (transparency.org). Pavarësisht se përkufizimet në literaturë mund të jenë të ndryshme, ajo që i përbashkon të gjitha është pranimi se padyshim korrupsioni është i dëmshëm për një shtet dhe shoqëri. Ekonomikisht, ai i largon burimet nga përdorimet e tyre më produktive dhe vepron si një taksë regresive që mbështet stilin e jetesës së elitave në kurriz të të gjithëve, ndërsa politikisht minon legjitimitetin e sistemeve politike duke u dhënë elitave mënyra alternative për të mbajtur pushtetin përtej zgjedhjeve demokratike (Fukuyama, 2016: 11-12). Kështu korrupsioni, ryshfeti, vjedhja, evazioni fiskal dhe marrëdhëniet e tjera të jashtëligjshme financiare u kushtojnë vendeve në zhvillim 1.26 trilion dollarë në vit (World Economic Forum, 2019). Kur korrupsioni është i përhapur demokracitë e reja e kanë të vështirë të konsolidohen (Drapalova et al., 2019: 11). Por edhe në demokracitë e stabilizuara korrupsioni minon besimin e qytetarëve dhe sjell reagime të ndryshme si mospjesëmarrja në votim apo votim për parti populiste dhe anti-sistem që do të sillnin një përkeqësim të mëtejshëm të demokracisë. Aty ku korrupsioni është i përhapur, njerëzit ndjejnë që nuk janë zotër të fatit të tyre dhe humbin besim për të ardhmen (Uslaner, 2015: 121).

Shumë nga masat kundër korrupsionit janë të fokusuara në trajtimin e simptomave më tepër se problematikën në vetvete:

fokusi i tyre ka konsistuar në ndryshimin e rregullave dhe ligjeve për ta bërë më të vështirë korrupsionin se sa në nxitjen e zyrtarëve publikë të sillen me integritet për t'i bërë të panevojshme këto ndryshime ligjore (Heywood & Rose, 2015: 107). Ndërkohë, sipas Zúñiga (2018) zgjedhja për t'u përfshirë në korrupsion nuk është e bazuar vetëm në logjikën, por shpesh ndikohet nga faktorë të pandërgjegjshëm, intuita e gabuar, mënyra se si individit proceson dhe organizon informacionin apo nga emocionet dhe rregullat sociale. Në të njëjtën linjë Camargo (2017) thekson se ndryshe nga supozimi në bazë të strategjive konvencionale antikorrupsion, ajo që dallon një perspektive të bazuar mbi sjelljen është njohja se njerëzit shpesh marrin vendime pa mbajtur në konsideratë incentivat formale si ato ligjore apo administrativë, por mbështeten në faktorë të tjerë mes të cilëve pritshmëritë e pranueshmërisë sociale dhe kulturore. Ndaj literatura dallon dy qasje në strategjitë e menaxhimit të etikës në organizata: një që i referohet përputhshmërisë dhe një të bazuar mbi vlerat apo integritetin (Paine, 1994; Dubbink, 2015). Qasja e drejtuar kundrejt përputhshmërisë thekson nevojën për procedura, ndjekjen e rregullave dhe monitorimi i sistemeve për të identifikuar shkeljet dhe ndëshikimin e tyre, ndërkohë që një qasje e përqendruar mbi vlerat apo integritetin thekson etikën, trajnime mbi ndërgjegjësimin moral, kodet e etikës dhe rëndësinë e vendosjes së shembujve të mirë nga lidërsi për të parandaluar shkeljet (Heywood et al., 2017: 24).

Nuk ka një përkufizim të vetëm mbi integritetin. Integriteti përbën një ndër pesë parimet thelbësore që qëndrojnë në bazë të

ISSAI 130 – Kodi i Etikës, duke nënkuptuar me të “..veprim me ndershmëri, besueshmëri, sinqeritet dhe në dobi të interesit publik” (INTOSAI, 2019). Përtej sjelljes individuale, sipas OECD (2017), termi “Integritet publik” i referohet harmonizimit të vazhdueshëm dhe respektimit të vlerave, parimeve dhe normave të përbashkëta etike për ruajtjen dhe prioritizimin e interesit publik ndaj interesave private në sektorin publik. “Integriteti publik” ka nisur të konsiderohet si përgjigja strategjike dhe e qëndrueshme kundër korrupsionit, në kushtet kur qasja tradicionale e bazuar mbi miratimin e më shumë ligjeve apo përforsimin e masave ndëshkuese ka rezultuar jo efikase (OECD, 2020). Kjo qasje pranon se kultura e një organizate formëson vlerat dhe si rrjedhojë veprimet e anëtarëve të saj ndaj ndryshimi në kulturë do të sillte ndryshim në sjelljen e punonjësve (Denhard et al., 2020: 537). Gjithsesi pranohet se kultura është një fenomen kompleks në një organizatë që përcakton sjelljen e punonjësve nëpërmjet sistemit formal dhe shfaqet nëpërmjet mendësisë dhe sjelljes që mësohet duke imituar të tjerët (Filabi & Bulgarella, 2018: 5). Edhe Trevino dhe Nelson (2018; cit. Filabi & Bulgarella, 2018: 5) dallojnë elementët formalë dhe informalë të sistemit kulturor që duhet të jenë në përputhje për të inkurajuar një sjellje etike. Ndër elementët formalë ata përfshijnë komunikimet zyrtare të drejtuesve, politikat e brendshme dhe kodet e sjelljes, programet e trajnimit, sistemet e përzgjedhjes së punonjësve (rekrutimi, shkarkimi), si dhe sistemet për menaxhimin e performancës dhe përcaktimin e qëllimeve. Ndërkohë sistemet informale përfshijnë norma të sjelljes së përditshme, rituale që ndihmojnë anëtarët të kuptojnë identitetin e organizatës dhe vlerat e saj, mitet dhe historitë që njerëzit tregojnë për organizatën dhe gjuhën që njerëzit përdorin në sjelljen e përditshme (po aty). Por përpara se të bëjë ndërhyrje për forcimin e kulturë etike sipas Filabi dhe Bulgarella (2018: 7-8) së pari organizatat duhet të kujdesen të mbajnë nën

kontroll elementet negativë si padrejtësia organizative, sjellja abuzive e menaxhimit, orientimi egoist, mungesa e vetëdijësisë dhe frika nga hakmarrja. Ndërsa puna për një orientim të fortë etik kërkon forcimin e elementeve pozitivë si besimi organizativ, lidhshipi etik, orientimi dashamirës, empatia, efikasiteti dhe të folurit lirshëm (po aty). Ky ndryshim kërkon një angazhim që shkon përtej atij të lidhshipit. Duke përfshirë njerëzit në diagnostikimin e situatës ekzistuese, në planifikimin e strategjive dhe qasjeve të reja, si dhe në implementimin e ndryshimit lehtësohet komunikimi dhe ndërtohet zotërim në procesin e ndryshimit (Denhard et al., 2020: 520). Qasja për integritetin kërkon një angazhim të vazhdueshëm për ndihmën e zhvillimit të ndjeshmërisë etike dhe një kuptimi më të thellë të vlerave dhe përgjegjësisë që ka secili individ brenda organizatës publike.

Megjithatë, strategjia e integritetit sikundër ajo e përputhshmërisë pranon nevojën e pasjes së rregullave dhe zbatimin e tyre, por nga ana tjetër thekson se zbatimi i thjeshtë i tyre nuk do të sillte rritjen e sjelljes morale në organizatë (Dubbink, 2015: 8). Sipas Paine (1994) një strategji integriteti është më e gjerë, më e thellë dhe më kërkuese sesa një strategji e përputhshmërisë ligjore: më e gjerë në atë që kërkon të mundësojë sjellje të përgjegjshme; më e thellë në atë që prek moralin dhe sistemet operative të organizatës dhe anëtarëve të saj, vlerat e tyre udhëzuese dhe modelet e mendimit dhe veprimit; dhe më kërkuese në atë që kërkon një përpjekje aktive për të përcaktuar përgjegjësitë dhe aspiratat që përbëjnë busullën etike të një organizate. Lewis dhe Gilman (2005) theksojnë nevojën për një integrim të qasjes të drejtuar kundrejt përputhshmërisë me atë të integritetit. Sipas tyre, rruga e ulët e përputhshmërisë nuk interesohet që shumica e njerëzve duan të marrin vendime të mira, por vetëm që shumica e njerëzve të arrijë minimumin e standardeve të sjelljes ndërkohë që rruga e lartë e integritetit refuzon realitete

administrative që burojnë nga llogaridhënia. Asnjëra prej qasjeve e vetme nuk përmbush qëllimin e nxitjes së praktikave etike në shërbimin publik ndaj kërkohej një shkrirje e të dyjave (po aty: 14). Që që të dyja qasjet nuk përjashtojnë njëra-tjetrën, por janë komplementare dhe të domosdoshme në një sistem të integritetit publik pranohet edhe nga Heyood et al. (2017) që konsideron si çështjen më të rëndësishme harmonizimin apo identifikimin e një ekuilibri të përshtatshëm mes tyre në çdo juridiksion të dhënë.

Qasja ndaj integritetit në Shqipëri

Korrupsioni është i përhapur në Shqipëri në të gjitha nivelet e qeverisjes, pavarësisht se autoritetet kanë bërë progres në luftën ndaj tij (U.S. Departament of State, 2023). Sipas Progres Raportit të Bashkimit Evropian për vitin 2024, Shqipëria ndodhet mes një niveli të përgatitjes të mesëm dhe një niveli të moderuar përgatitjeje, duke shfaqur njëfarë progresi në luftën e saj kundër korrupsionit (EC, 2024: 6). Megjithatë, në perceptimin e publikut korrupsioni në Shqipëri vazhdon të konsiderohet një fenomen shqetësues. Sipas Transparency International vendi për vitin 2023 renditet i 98-ti nga 180 shtetet e hulumtuara (Transparency International, 2024).

Shqipëria ka ratifikuar një sërë konventash kundër korrupsionit dhe ka një kuadër të gjerë ligjor për etikën, integritetin dhe për qeverisjen e mirë si janë ligji “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” (KSH, 2005), ligji “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publike” (KSH, 2003a), ligji “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve” (KSH, 2016), ligji “Për të drejtën e informimit” (KSH, 2014a), ligji “Për njoftimin dhe konsultimin publik” (KSH, 2014b), etj.

Korrupsioni aktiv dhe pasiv përbëjnë një vepër penale dhe janë ngritur struktura

të posaçme në sistemin e drejtësisë për ta luftuar atë. Megjithatë, përtej qasjes ndëshkuese, në përputhje me zhvillimet ndërkombëtarisht, vitet e fundit edhe në Shqipëri mes instrumenteve parandalues për korrupsionin shumë nga masat e ndërmarra në nivel qeverisjeje qendrore dhe vendore kanë patur në fokus integritetin publik nëpërmjet miratimit të planeve të integritetit apo kodeve të etikës në institucione.

Nga një këndvështrim juridik, koncepti i integritetit u përfshi në legjislacionin shqiptar në vitin 2006 nëpërmjet ratifikimit të Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër korrupsionit (UNCAC) e cila parashikon detyrimin e shteteve palë për të nxitur integritetin e nëpunësve publikë (neni 8), si dhe zhvillimin, zbatimin ose ruajtjen e politikave të efektshme dhe të koordinuara kundër korrupsionit që nxisin pjesëmarrjen e shoqërisë dhe reflektojnë principet e shtetit ligjor, administrimin e rregullt të punëve publike, pasurisë publike, integritetit, transparencës dhe përgjegjësisë (neni 5). Në nivelin e politikave, vizioni i i strategjisë së parë ndërsektoriale kundër korrupsionit 2008-2013 konsistonte në reduktimin progresiv e të qëndrueshëm të korrupsionit, forcimin e integritetit të institucioneve dhe promovimin e vlerave në qeverisje (SKR, 2008-2013). Në të njëjtën linjë edhe Strategjia e re 2015-2020 përcaktonte si vizion të saj “Institucione shqiptare transparente dhe me integritet të lartë, që gëzojnë besimin e qytetarëve dhe garantojnë shërbim cilësor dhe të pakorruptueshëm” (SKR, 2015-2020). Integriteti dhe vlerat etike konsiderohen sipas manualit për menaxhimin financiar dhe kontrollit si elementë thelbësorë që kontribuojnë në krijimin e një mjedisi të mirë kontrolli dhe titullari i njësisë publike dhe të gjithë anëtarët e stafit duhet të udhëhiqen nga integriteti personal dhe profesional në marrjen e vendimeve dhe në kryerjen e detyrave të tyre (MF, 2017). Megjithatë, në përputhje me rekomandimin e OECD, Raporti i progresit të BE-së i vitit

2018 vlerësonte se pavarësisht ekzistencës së legjislacionit dytësor të lidhur me integritetin, vendit i mungonte një sistem i përgjithshëm i menaxhimit të rrezikut të integritetit, si dhe asnjë prej ministrive nuk kishte plane integriteti (EC, 2018). Po ashtu, Strategjia e re Antikorrupsion 2025-2030 vijon në këtë qasje strategjike për integritetin, duke synuar të forcojë luftën kundër korrupsionit dhe të promovojë një administratë publike më të pastër dhe më të përgjegjshme (SKR, 2025-2030).

Hartimi i metodologjisë për vlerësimin e rrezikut të integritetit dhe miratimi i planeve të integritetit nga ministrinë u parashikua në planin e veprimit të strategjisë ndërsektoriale kundër korrupsionit 2018-2020 (SKR, 2018-2020). Në këtë kuadër, ishte parashikuar se planet e integritetit do të miratoheshin dhe publikoheshin brenda vitit 2020 dhe do të ofronin kornizën konceptuale për politikën dhe masat për të parandaluar shkeljet e integritetit të zyrtarëve publikë dhe për monitorimin e efekteve të masave të zbatuara në një institucion publik. Planet do të shërbenin si një mjet për vlerësimin e riskut të integritetit dhe do të përmbanin, përtej një vizioni mbi luftën kundër korrupsionit, informacion mbi fushat specifike të korrupsionit në institucionin publik, etikën dhe fushat e integritetit personal, p.sh. kodi i mirësjelljes, pranimi i dhuratave, raportimi i korrupsionit, duke përfshirë sinjalizimin, veprimet disiplinore të regjistruara, reagimi ndaj sjelljeve morale dhe profesionale të papranueshme (po aty). Në vitin 2020 u hartua dhe miratua një metodologji kombëtare për zhvillimin e planeve të integritetit në institucionet e qeverisjes qendrore (MD, 2020).

Një plan integriteti hartohet mbi një proces të vlerësimit të riskut, duke nënkuptuar me këtë të fundit mundësinë “...e ndodhjes së një ngjarjeje të caktuar, e cila do të ndikonte negativisht në arritjen e objektivave të njësisë” (KSH, 2010). Metodologjia parashikon përdorimin e metodave cilësore

dhe sasore dhe angazhimin e vetë stafit të institucionit nëpërmjet ngritjes së një grupi pune nga titullari të udhëhequr nga një koordinator, për identifikimin e risqeve të integritetit (MD, 2020). Metodologjia cilësore përdor burime dytësore si vlerësimi i përputhshmërisë së kuadrit rregullator të institucionit me detyrimet që derivojnë nga kuadri ligjor apo rishikim dokumentacioni si raporte të kontrollit të brendshëm apo të jashtëm, si dhe burime parësore nëpërmjet grupeve të fokusuara me nëpunësit, të ndarë sipas fushave të përgjithshme dhe të veçanta të funksioneve të ministrisë. Në këtë mënyrë, procesi vlerëson risqet në të gjitha funksionet/pozicionet e punës dhe proceset e punës sipas fushave të përbashkëta të veprimtarisë të parashikuara në urdhrin e Ministrit të Drejtësisë, përkatësisht: i) fusha e menaxhimit financiar; ii) fusha e menaxhimit të burimeve njerëzore; iii) fusha e kontrollit, auditimit dhe e mekanizmave kundër korrupsionit, iv) fusha e transparencës; v) Fusha e arkivimit, ruajtjes dhe administrimit të dokumenteve si dhe të informacionit, dhe të dokumenteve elektronik; si edhe fushave të veçanta të veprimtarisë sipas funksioneve të ministrive (MD, 2020: 15-22). Gjithashtu, përdoret metoda sasore nëpërmjet administrimit të një pyetësori anonim me nëpunësit e ministrisë mbi zbatimin konkret të etikës dhe integritetit (po aty, f. 16). Risqet e identifikuar vlerësohen sipas intensitetit të tyre dhe renditen sipas përparësisë në një plan i cili përmban masa për të përmirësuar integritetin e institucionit për një periudhë tre vjeçare (po aty, f. 23-24). Plani i Integritetit i miratuar nga titullari i nënshtrohet monitorimit periodik nga vetë institucioni për të kuptuar nëse risqet e identifikuar janë menaxhuar në mënyrë të efektshme, nëse kanë pësuar ndryshime të profilit të tyre, nëse janë zvogëluar apo zmadhuar (po aty, f. 24).

Miratimi i Metodologjisë së Vlerësimit të Riskut për institucionet e qeverisjes qendrore dhe plani i integritetit të Ministrisë

së Drejtësisë u vlerësua nga Grupi i Shteteve të Këshillit të Evropës kundër Korrupsionit (GRECO, 2020) në kuadër të vlerësimit të vitit 2020 për Shqipërinë, i cili, ndër të tjera konstatonte vonesën dhe rëndësinë e hartimit të planeve të integritetit edhe për ministrinë e tjera. Në këtë frymë, miratimi i Planit të Veprimit për vitet 2020-2023 të Strategjisë ndërsektoriale kundër korrupsionit parashikoi miratimin e planeve të integritetit për institucionet e qeverisjes qendrore brenda vitit 2023. Aktualisht, 11 ministri të vendit dhe 13 institucione varësie të Ministrisë së Drejtësisë kanë të miratuar një plan integriteti në nivel të institucioneve të qeverisjes qendrore (Dhoga & Sulstarova, 2022). Planet e Integritetit zënë një peshë të rëndësishme edhe në strategjinë e re ndërsektoriale kundër korrupsionit 2024-2030 dhe planit të saj të veprimit (SKR 2024-2030) si instrumenta thelbësorë për parandalimin e korrupsionit nën Objektivin Specifik “Forcimi i transparencës, llogaridhënies dhe integritetit të institucioneve publike në të gjitha nivelet e qeverisjes” (1.2) dhe objektivin specifik “Zhvillimi i një qasjeje të qëndrueshme për parandalimin e korrupsionit në sektorët me risk” (1.3). Në këtë kuadër pritet miratimi i planeve të integritetit për ministrat e shtetit dhe institucionet e tjera qendrore me fokus veçanërisht ato institucione që kane risk të lartë brenda vitit 2026, si dhe vijimi i zbatimit të planeve të integritetit të miratuara (raporte monitorimi). Model ky që sipas një metodologjie të dedikuar u huazua edhe në 24 Njësi të Vetëqeverisjes Vendore që kanë miratuar tashmë planet e tyre të integritetit dhe që pritet të finalizohet brenda vitit 2026 edhe në pjesën tjetër të NJVQ (po aty, objektivi 1.4 & 1.5).

Risqet e përbashkëta të integritetit në katër ministrinë e linjës

Pavarësisht se planet e integritetit janë të personalizuar për çdo institucion si rezultat i procesit të vlerësimit të brendshëm të riskut të

tyre, rezulton se shumë nga risqet me të cilat ato përballen janë të njëjta apo të ngjashme. Kjo bën që planet e integritetit mund të shfrytëzohen në një prizëm më të gjerë, pra në nivelin e politikave për t'u dhënë zgjidhje sfidave të përbashkëta. Në këtë kuadër janë analizuar planet e integritetit për periudhën 2022-2025 në katër ministri, përkatësisht Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS, 2022), Ministria e Kulturës (MK, 2022), Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS, 2022), si dhe Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme (MEPJ, 2022). Sfidat e përbashkëta të konstatuara mes katër ministrive konsistojnë kryesisht në fushën e përmirësimit të kuadrit të tyre të brendshëm rregullator në përputhje me legjislacionin në fuqi për etikën, konsolidimin e burimeve njerëzore dhe rritjen e transparencës publike. Më konkretisht:

Përmirësimi i kuadrit rregullator dhe institucional në aspekte të veçanta të etikës dhe integritetit

Ky komponent vlerëson kryesisht vetëdijësimin e stafit me kuadrin ligjor mbi etikën dhe integritetin, miratimin e akteve të brendshme rregullatore në institucion dhe ngritja e strukturave përkatëse sipas kërkesave ligjore, si dhe funksionimi i këtyre mekanizmave në praktikë.

Një nga sfidat kryesore të katër ministrive është hartimi dhe zbatimi i një kuadri të plotë rregullator në përputhje me ligjet dhe rregullat e etikës dhe integritetit. Edhe pse një pjesë e mirë e ministrive ka miratuar akte të brendshme rregullatore, një problem i dukshëm është mungesa e njohurive të thella dhe të plota të këtyre akteve nga stafi. Për shembull, tre nga katër ministrinë e shqyrtuara nuk kanë një kod etik, dhe aty ku ekziston i mungojnë disa dispozita të rëndësishme, si ato që lidhen me veprimtarinë e jashtme dhe dhuratat. Kjo çon në një zbatim të mangët të politikave për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit, dhe

bën që ato të mbeten më shumë në nivelin formal, pa u përbrendësuar plotësisht nga ana e punonjësve. Kjo mangësi informimi dhe trajnimi është e ngjashme me vështirësitë që ndodhin në lidhje me njësitë për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve, ku puna mbetet shpesh e paqartë për ata që janë të angazhuar në këto procese. Kjo situatë tregon që edhe kur institucionet zbërthejnë kuadrin ligjor në aktet e tyre të brendshme rregullatore procesi mbetet kryesisht formal dhe shumë pak i njohur apo i brendësuar nga punonjësit.

Konsolidimi i sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore

Një sfidë tjetër e përbashkët për këto ministri është menaxhimi i burimeve njerëzore. Të katërta ministritë kishin risk pamjaftueshmërinë e burimeve të tyre njerëzore gjë që mund të sillte inefiçence në realizimin e detyrave në kohë apo cilësi. Inefiçence që ndikohej edhe nga ngarkesa e stafit ekzistues me detyra shtesë përtej përshkrimeve të tyre të punës, kualifikimit apo ekspertizës. Nga ana tjetër konstatohet se pavarësisht se miratoheshin plane trajnimi për stafin ato nuk ishin të plota apo nuk mbanin në konsideratë identifikimin e nevojave konkrete. Problematike mbetej dhe ruajtja e një shërbimi civil meritokratik në lëvizjet paralele apo ngritjen në detyrë pasi procesi i vlerësimit të performancës në punë edhe pse realizohej konsiderohej nga punonjësit formal. Konsiderimi i stafit si aktor pasiv në funksionimin e ministrive vërehet edhe në procesin e ristrukturimit në dy prej katër ministrive të shqyrtuara ku punonjësit deklaroronin se nuk u ishte marrë mendim dhe që mungonte një analizë gjithëpërfshirëse.

Rritja e transparencës dhe ndarja e të dhënave me publikun

Qeverisja e hapur dhe transparente është një parakusht i qeverisjes së mirë. Një aspekt tjetër kritik që ndajnë këto ministri

është mungesa e transparencës në disa procese administrative dhe menaxhimin e informacionit. Pavarësisht detyrimit ligjor që institucionet të publikojnë në programet e tyre të transparencës sa më tepër informacion publik pa kërkesë, planet e integritetit konstatojnë se ky detyrim zbatohet vetëm pjesërisht nga katër ministritë e shqyrtuara. Nga analiza e planeve të integritetit rezultojnë mangësi në bërjen transparente prej tyre kryesisht të raporteve të monitorimit të zbatimit të buxhetit, raporteve të auditit të brendshëm apo të dhëna të tjera që lidhen me lejet, licencat apo kontratat koncesionare. Kjo çon në mungesë besimi dhe një perceptim negativ nga ana e qytetarëve dhe aktorëve të tjerë të interesuar, duke bërë të vështirë krijimin e një administrate të hapur dhe të përgjegjshme.

Avantazhet e planeve të integritetit si instrument për rritjen e kulturës etike

Planet e integritetit kanë një rol të rëndësishëm jo vetëm në përmirësimin e strukturave dhe proceseve të administratës publike, por edhe në forcimin e kulturës etike brenda institucioneve. Duke shërbyer si një instrument edukues dhe parandalues, ato ndihmojnë në krijimin e një kulture të qeverisjes transparente, përgjegjëse dhe të bazuar në parime etike. Për më tepër, ato janë një mekanizëm që mund të sjellë ndryshime afatgjata në mënyrën se si punojnë institucionet dhe si ndërveprojnë ato me publikun dhe aktorët e tjerë të interesuar.

Planet e integritetit ndikojnë në forcimin e kulturës etike nëpërmjet rolit të tyre edukues dhe parandalues. Në lidhje me rolin edukues hartimi i planeve kërkon një angazhim gjithëpërfshirës të stafit të institucionit për të identifikuar risqet e integritetit në proceset e punës nëpërmjet shqyrtimit të kuadrit ligjor, përputhshmërisë së kuadrit të brendshëm rregullator me legjislationin, diskutimit të hapur mbi proceset e punës sipas fushave të veprimtarisë konkrete dhe plotësimit të një

pyetësoni të anonimizuar. Në këtë mënyrë stafi së pari kalon në një proces njohjeje apo ritrajnimit dhe përditësimi mbi kuadrin ligjor për etikën dhe integritetin. Së dyti, vlerëson nëse ky kuadër ligjor është zbërthyer në kuadrin e brendshëm të institucionit dhe nëse është brendësuar nga punonjësit. Së treti, jepet mundësia e diskutimit me kolegët mbi risqet konkrete në punën e përditshme në grupe të fokusuara duke formuluar bashkarisht masa se si mund të zgjidhen ato në mënyrë optimale. Së katërti, plotësimi i pyetësorit të anonimizuar ndihmon njohjen dhe ndërgjegjësimin nga drejtuesit politikë dhe stafi menaxherial mbi problematikën e hasura nga punonjësit në lidhje me kulturën etike në institucion pa patur frikë për ndëshkim. Ndërgjegjësimi i lidershipit është i rëndësishëm pasi duke komunikuar në mënyrë të hapur ashtu edhe të nënkuptuar nëpërmjet çfarë i kushtojnë vëmendje dhe çfarë shpërblejnë, mënyrës si shpërndajnë burimet, modelit të sjelljes së tyre, mënyrës si i trajtojnë çështjet kritike dhe kriterëve që përdorin për rekrutimin, përzgjedhjen, promovimin dhe largimin nga puna bëjnë që këto sjellje të bëhen pjesë të kulturës apo nënkulturave të institucionit (Schein, 2004: 271). Megjithatë, planet e integritetit edhe pse janë një proces që kërkon vullnet politik për t'u hartuar apo edhe për t'u zbatuar nëpërmjet vënies në dispozicion të burimeve të nevojshme financiare dhe njerëzore, në thelb mbeten një proces që realizohet nga poshtë lart dhe që kërkon brendësim të normave etike nëpërmjet socializimit (Dhoga & Sulstarova, 2022). Nga ana tjetër, edukimi që përftohet nga planet e integritetit mund të jetë edhe në një nivel më të gjërë. Fakti që institucione të ndryshme hasin risqe të njëjta tregon një trend apo mangësi të cilat mund të kërkojnë një rregullim të unifikuar në nivelin e politikave apo edhe vetë ndryshime ligjore. Madje në nivel të politikave mund të identifikohen praktikatat e mira në institucione të ndryshme dhe të krijohen ura lidhëse për ndarjen e tyre apo përdorimit si modele.

Përveç rolit edukues, planet e integritetit janë gjithashtu një mjet parandalues për korrupsionin dhe abuzimet e mundshme brenda administratës publike. Ato i shërbejnë misionit të rëndësishëm të ndërtimit, drejtimit dhe qeverisjes së një administrate që funksionon në bazë të parimeve të ligjshmërisë dhe profesionalizmit dhe që meriton besimin e publikut. Angazhimi i punonjësve në identifikimin e risqeve të integritetit krijon njëkohësisht edukimin e tyre për nevojën e masave konkrete për minimizimin e tyre si një dokument strategjik për një periudhë trevjeçare. Dhe nëse një ushtrim jo i thjeshtë është hartimi i planit të integritetit, një ushtrim edhe më i vështirë është zbatimi i masave të parashikuara. Zbatimi i këtyre masave do të sillte uljen e risqeve për korrupsion, pra parandalim të tij në institucion.

Një aspekt i rëndësishëm i këtyre planeve është aftësia e tyre për t'u adaptuar dhe rishikuar me kalimin e kohës. Ato janë dokumente dinamike që mund të përmirësohen dhe rifreskohen gjatë periudhave të monitorimit, duke reflektuar ndryshimet në risqet dhe duke u përshtatur me nevojat e institucioneve dhe ligjeve të reja. Ky aspekt i fleksibilitetit siguron që planet të mbeten të dobishme dhe efektive, duke sjellë një menaxhim më të mirë të rreziqeve dhe duke mundësuar një mjedis më të sigurt dhe të besueshëm.

Një tjetër avantazh i planeve të integritetit është mundësia për të përfshirë publikun dhe grupet e tjera të interesit në procesin e monitorimit dhe vlerësimit të zbatimit të tyre. Kur informacionet e lidhura me planet e integritetit dhe raportet e monitorimit bëhen publike, ato mund të shërbejnë si një nxitës për qytetarët, shoqërinë civile dhe aktorët e tjerë për të marrë një rol proaktiv për rritjen e qeverisjes së mirë (Dhoga & Sulstarova, 2022). Ky angazhim mund të ndihmojë në rritjen e transparencës dhe përgjegjshmërisë, duke ushtruar presion mbi zyrtarët publikë për të zbatuar politikat e integritetit dhe për

të parandaluar abuzimet.

Në këtë mënyrë, vullneti politik për të adresuar korrupsionin dhe për të promovuar etikën mund të manifestojë edhe një herë një qasje nga poshtë-lart. Pjesëmarrja aktive e punonjësve të vijës së parë dhe e qytetarëve mund të krijojë një dinamikë të re që fuqizon proceset e integritetit dhe krijon një mjedis të mëtejshëm për qeverisjen e mirë (U4Brief, 2010).

Sfidat e zbatimit dhe monitorimit të planeve të integritetit

Pavarësisht një kornize të gjerë ligjore dhe politikave të hartua, mungesa e një mekanizmi të fortë monitorimi dhe mbikëqyrjeje të zbatimit të politikave është një shqetësim i vazhdueshëm në shumë sisteme qeverisjeje, përfshirë atë në Shqipëri.

Arsyesja kryesore për këtë është se shumë herë kontrollet e brendshme të institucioneve nuk janë të pavarura ose të mjaftueshme për të garantuar që politikat të zbatohen në mënyrë efektive. Kjo mund të çojë në një situatë ku, megjithëse ligjet janë të forta dhe të detajuara dhe hartohen politika, zbatimi i tyre mbetet i paqartë dhe i paefekshëm. Për shembull, nëse nuk ka një sistem të fortë të monitorimit për të siguruar që çdo ministri ose institucion zbaton planet e integritetit dhe masat e parandalimit të korrupsionit, mund të ndodhin dështime në implementimin e këtyre politikave. Një tjetër aspekt është se shumë herë janë të vështira për të identifikuar shkeljet e mundshme të integritetit në nivelin operativ, veçanërisht kur mbikëqyrësit janë të lidhur ngushtë me ata që po kontrollojnë. Kjo e bën të vështirë përmirësimin e procesit të menaxhimit të rrezikut të integritetit, duke ndikuar negativisht në përmirësimin e situatës.

Monitorimi i planeve të integritetit bëhet përmes një vetëvlerësimi, raport institucional i brendshëm për zbatimin e planeve të integritetit. Për ta bërë monitorimin dhe mbikëqyrjen më efektive, është e rëndësishme

që të krijohen mekanizma të pavarura, të cilat mund të realizojnë një kontroll të rregullt dhe të drejtpërdrejtë të zbatimit të politikave. Këto mekanizma mund të përfshijnë ekspertë të pavarur nga academia apo shoqëria civile, auditim të jashtëm dhe platforma të qarta për raportimin e shkeljeve. Për më tepër, duhet të ketë transparencë të plotë në lidhje me rezultatet e monitorimit, për t'u siguruar që qytetarët dhe aktorët e tjerë të interesuar të jenë në dijeni të masave që janë marrë dhe efektivitetit të tyre. Nëse mekanizmat e monitorimit janë të dobëta, edhe legjislacioni apo politikat më të mira mund të mbeten instrumenta të pafuqishme, dhe korrupsioni mund të vazhdojë të mbetet një problem sistematik. Kjo është një arsye tjetër përse shumë vende, pavarësisht përpjekjeve të shumta, nuk kanë arritur të çlirohen plotësisht nga praktikatat e korrupsionit.

Përfundim

Plani i Integritetit është një instrument i cili është duke u përdorur gjërësisht vitet e fundit nga qeveria shqiptare në nivel qendror dhe vendor si një instrument edukues dhe parandalues për të shmangur korrupsionin. Nëpërmjet tij synohet të nxitet kultura etike në institucion duke përdorur metodologji të ndryshme cilësore dhe sasiorë për të identifikuar risqet në fusha të përgjithshme apo të veçanta të veprimtarisë të institucionit e që kulmon në një dokument strategjik tre vjeçar të hartuar nga vetë punonjësit me masa konkrete për t'i minimizuar ato. Pra nëpërmjet procesit lidhësi dhe stafi i institucionit krijon vetëdijësim për mangësitë dhe risqet etike dhe bëhet promotor i ndryshimit. Pavarësisht se planet janë të personalizuar për çdo institucion, shpesh risqet me të cilat ato përballen janë të ngjashme apo të njëjta. Ky studim në katër ministri konstatoi se sfidat e përbashkëta janë hasur kryesisht në fushën e përmirësimit të kuadrit të brendshëm rregullator në përputhje me legjislacionin në fuqi për etikën, konsolidimin e burimeve

njerëzore dhe rritjen e transparencës publike. Ndaj planet e integritetit shërbejnë edhe për t'u dhënë zgjidhje të përbashkëta këtyre sfidave në nivelin e politikave apo legjislacionit. Nga ana tjetër, bërja e planeve të integritetit publike rrit llogaridhënien e institucioneve ndaj qytetarëve dhe shoqërisë civile si një parakusht i qeverisjes së mirë. Megjithatë, pavarësisht miratimit të planeve të integritetit sfidë mbetet zbatimi dhe monitorimi i tyre. Nëse mekanizmat e monitorimit janë

të dobëta, edhe legjislacioni apo politikat më të mira mund të mbeten instrumenta të pafuqishme, dhe korrupsioni mund të vazhdojë të mbetet një problem sistematik. Për ta bërë monitorimin dhe mbikëqyrjen më efektive, është e rëndësishme që të krijohen mekanizma të pavarur, të cilët mund të realizojnë një kontroll të rregullt dhe të drejtpërdrejtë të zbatimit të politikave dhe të ketë transparencë të plotë mbi rezultatet e monitorimit.

REFERENCAT

- Camargo, B., C. (2017). *Can a Behavioural Approach Help Fight Corruption?*, https://baselgovernance.org/sites/default/files/2019-06/170628_policy_brief_final_issn.pdf
- Denhardt, B. R.; Denhardt V. J. & Aristigueta P. M. (2020), *Managing Human Behavior in Public and Nonprofit Organizations*, Fifth Edition, Sage
- Drapalova, E., Mungiu-Pippidi, A, Palifka, B, J., Vrush, J., (2019), *Corruption and the crisis of democracy: The link between corruption and the weakening of democratic institution*, Transparency International Anti-Corruption Helpdesk Answer, <https://www.jstor.org/stable/resrep20482>
- Dubbink, W., (2015). Organizational Integrity and Human Maliciousness, fq. 7-38, në Hardi, P., et al (Eds). *Debates of Corruption and Integrity. Perspective from Europe and the US*, Palgrave Macmillan.
- Dhoga. N., Sulstarova, R., (2022). *Integriteti në Institucionet e Qeverisjes Qendrore: Mundësitë, Sfidat dhe e Ardhmja*, <https://idmalbania.org/three-policy-papers-in-the-development-of-integrity-instruments-in-the-public-administration-sector-december-2022/>
- European Commission, EC. (2019). "Albania 2018 Report", <https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2020-10/20180417-albania-report.pdf>
- European Commission, EC. 2024. "Albania 2024 Report", https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/document/download/a8ecc3f9-b2ec-4cb1-8748-9058854dbc68_en?filename=Albania%20Report%202024.pdf
- Filabi, A., Bulgarella, C., (2018) Organizational Culture Drives Ethical Behaviour: Evidence From Pilot Studies, <https://docslib.org/doc/3486195/organizational-culture-drives-ethical-behaviour-evidence-from-pilot-studies>
- Fukuyama, F., (2016). "What is Corruption?", *Against Corruption: a collection of essays*, fq 11-21, <https://www.gov.uk/government/publications/against-corruption-a-collection-of-essays>
- Group of States Against Corruption, GRECO, (2020). *Fifth Evaluation Round. Preventing corruption and promoting integrity in central governments (top executive functions) and law enforcement agencies. Evaluation Report Albania*, <https://rm.coe.int/fifth-evaluation-round-preventing-corruption-and-promoting-integrity-i/1680a0923d>
- Heywood, P. M. & Rose, J., (2015), Curbing Corruption or Promoting Integrity? Probing the Hidden Conceptual Challenge, fq 102-120, në Hardi, P., et al (Eds). *Debates of Corruption and Integrity. Perspective from Europe and the US*, Palgrave Macmillan
- Heywood, P. M., Marquette, H., Peiffer, C., and Zúñiga, N. (2017). *Integrity and Integrity Management in Public Life*, konsultuar në <https://pure.oai.bham>

- ac.uk/ës/portalfiles/portal/42921002/D11_4_FINAL_combined.pdf
- INTOSAI. (2019). "ISSAI 130 Code of Ethics", https://www.intosai.org/fileadmin/downloads/documents/open_access/ISSAI_100_to_400/issai_130/ISSAI_130_EN.pdf
- Këshilli i Ministrave, KM. (2008). VKM Nr. 241, datë 20.4.2018 "Për miratimin e planit të veprimit 2018–2020, në zbatim të strategjisë ndërsektoriale kundër korrupsionit, 2015–2020, e të pasaportës së indikatorëve, krijimit, funksionimit dhe detyrat e komitetit koordinator për zbatimin e strategjisë ndërsektoriale kundër korrupsionit, 2015–2020, dhe task-forcës ndërinstitucionale antikorrupsion", https://amshc.gov.al/wp-content/uploads/2022/01/20180420_VKM_241_StrategjiaKunderKorrupsionit2015%E2%80%932020.pdf
- Kuvendi i Shqipërisë, KSH. 2003a. Ligji nr. 9049, datë 10.4.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publike", <https://qbz.gov.al/eli/ligj/2003/04/10/9049>
- Kuvendi i Shqipërisë, KSH. 2003b. Ligji nr. 9131, datë 8.9.2003 "Për rregullat e etikës në administratën publike", <https://qbz.gov.al/preview/f2b91a5c-52e9-4e29-b367-4b9c6e294dc8/cons/20220422>
- Kuvendi i Shqipërisë, KSH. 2005. Ligj "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike"; <https://qbz.gov.al/eli/ligj/2005/04/07/9367>
- Kuvendi i Shqipërisë, KSH. 2006. Ligji Nr. 9492, datë 13.3.2006 Për Ratifikimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara Kundër Korrupsionit, https://www.pp.gov.al/rc/doc/ligj_nr_9492_date_13_3_817.pdf
- Kuvendi i Shqipërisë, KSH. 2010. Ligj Nr.10 296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", <https://qbz.gov.al/share/wvEvnW3rSluuLWrbBTPuUw>
- Kuvendi i Shqipërisë, KSH. 2014a. Ligji nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar; <https://qbz.gov.al/eli/ligj/2014/09/18/119>
- Kuvendi i Shqipërisë, KSH. 2014b. Ligji nr. 146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik", <https://qbz.gov.al/eli/ligj/2014/10/30/146>
- Kuvendi i Shqipërisë, KSH. 2016. Ligji nr. 60/2016 "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve", <https://qbz.gov.al/share/lpIOXD0kTcSS1PaoXdwZ1g>
- Lewis, W. C., Gilman C. S., (2005), *The ethics challenge in public service. A problem-solving guide*, second edition, Jossey-Bass: San Francisco
- Ministri i Shtetit për Administratën Publike e Antikorrupsionin. (2024). Draft-Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit 2024-2030, konsultuar në https://konsultimipublik.gov.al/documents/RENJK_765_Draft-Strategjia-Nd-rsektoriale-Kund-r-Korrupsionit-2024-2030.pdf
- Ministria e Arsimit dhe Sportit, MAS. 2022. Urdhër Nr. 225, datë 27.04.2022 i Ministrit të Arsimit dhe Sportit "Plani i Integritetit 2022-2025", <https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2022/04/PI-e-Risqeve-MAS-26-04-22.pdf>
- Ministria e Drejtësisë, MD. 2020. Urdhër Nr. 334, datë 07.10.2020 i Ministrit të Drejtësisë "Për miratimin e Metodologjisë së Vlerësimit të Riskut të Integritetit për Institucionet e Qeverisjes Qendrore" (MVRI), https://www.drejtesia.gov.al/ep-content/uploads/2021/04/3.-Metodologjia-e-Vler%C3%ABsimit-t%C3%AB-Riskut-t%C3%AB-Integritetit-p%C3%ABr-Institucionet-e-Qeverisjes-Qendrore_AL.pdf
- Ministria e Financave, MF. 2017. Urdhër i Ministrit të Financave Nr. 108, datë 17.11.2017 "Për miratimin e manualit për menaxhimin financiar dhe kontrollin", mund të shihet: <https://panel.klsh.org.al/storage/phpJtxCgh.pdf>
- Ministria e Kulturës, MK. 2022. Urdhër Nr. 214, datë 27.04.2022 i Ministrit të Kulturës "Për miratimin e Planit të Integritetit për Ministrinë e Kulturës", <https://kultura.gov.al/plani-i-integritetit-per-ministrine-e-kultures/>
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale,

- MSHMS. 2022. Urdhër Nr. 267, datë 22.04.2022 “Për miratimin e Planit të Integritetit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale 2022-2025”, <https://shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2022/04/urdher-nr.-267-per-miratimin-e-planit-te-integritetit-te-MSHMS-2022-2025.pdf>
- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, MEPJ. 2022. Urdhër Nr. 150, datë 28.04.2022 i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme “Për miratimin e Planit të Integritetit për Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme 2022-2025”, <https://www.punetegashtme.gov.al/programi-i-transparences-2/>
- OECD (2020). *OECD Public Integrity Handbook*, OECD Publishing, Paris, <https://doi.org/10.1787/ac8ed8e8-en>.
- OECD. (2017). *Recommendation of the Council on Public Integrity*, <https://legalinstruments.oecd.org/en/instruments/OECD-LEGAL-0435>
- Paine, L, S. (1994). *Managing for Organizational Integrity*, Harvard Business Review
- Schein, E., H., (2004). *Organizational Culture and Leadership*. Third Edition, Jossey-Bass
- Transparency International (2024), *Corruption Perceptions Index, 2023*, [HTTPS://WWW.TRANSPARENCY.ORG/EN/CPI/2023](https://www.transparency.org/en/cpi/2023)
- U.S. Department of State, Albania 2023 Human Rights Report, https://www.state.gov/wp-content/uploads/2024/01/528267_ALBANIA-2023-HUMAN-RIGHTS-REPORT.pdf
- U4Brief, (2010)., *Unpacking the concept of political will to confront corruption*, Nr. 1, <https://www.u4.no/publications/unpacking-the-concept-of-political-will-to-confront-corruption>
- Uslaner, E. M., (2015) Inequality and Corruption f. 120- 134 në Peter Hardi, Paul M. Heywood, Davide Torsello, *Debates of Corruption and Integrity. Perspective from Europe and the US*, Palgrave Macmillan
- World Economic Forum (2019), Corruption costs developing countries \$1.26 trillion every year – yet half of EMEA think it's acceptable, <https://www.weforum.org/stories/2019/12/corruption-global-problem-statistics-cost/>
- Zúñiga, N. (2018), *Behavioural changes against Corruption*, U4 Helpdesk Answer 2018

ABSTRACT

The literature distinguishes two approaches to ethics management strategies in organizations: one that refers to compliance and one based on values or integrity, which must be integrated with each other. Albania in recent years, alongside the adoption of a broad legal framework against corruption and the establishment of special structures for its investigation and punishment, has taken important steps to promote the culture of integrity through the adoption of integrity plans at the central and local level of governance. Integrity Plans are essentially a three-year strategic and operational document that comes as a result of the identification of integrity risks in the general and specific areas of the institution's activity and the determination of measures to minimize these risks by the employees themselves. Although the integrity plan is personalized for each institution, this study, analyzing the risks in four ministries, shows that some of the challenges they face are similar or the same. On the other hand, the study analyzes what are the advantages of the approach to integrity to promote the ethical culture in the Albanian government.

Keywords: *Organizational Culture, Compliance, Integrity, Integrity Plan*

SHTETI DHE ZBATIMI

I LIRISË SË INDIVIDIT NË DEMOKRACI

Ferit BAÇA

Departamenti i Filozofisë

Fakulteti i Shkencave Sociale,

Universiteti i Tiranës

E-mail: feritbaca@gmail.com; ferit.baca@unitir.edu.al

PËRMBLEDHJE

Në të gjitha trajtesat me karakter teorik e filozofik, nocioni i shtetit përfshin në vetvete edhe anatomicinë e qytet-shteteve të hershme. Themelin e çdo shteti e përbëjnë qytetarët e tij. Shteti është një pjesë e trupit politik që merret me zbatimin e ligjeve, me rritjen e mirëqenies, me ruajtjen e rendit publik dhe qeverisjen. Duke qenë se shteti zotëron të drejtën e pushtetit dhe përdorimin e forcës kur e kërkojnë interesat e tij, metaforikisht, mjaft filozofë e kanë përshkruar atë si një qenie mitologjike apo që zotëron forcën e një përbindëshi. Kujtojmë Leviatanin e Tomas Hobsit. Populli është burimi i çdo pushtetit. Ndonëse shteti është përfaqësues i popullit, ai nuk i zotëron të gjitha të drejtat e popullit. Shteti i mandatuar nga populli është një strukturë e organizuar për nevojat e zhvillimit dhe jetës shoqërore dhe organet e zgjedhura prej tij. Funksionet e shtetit lidhen me sigurimin e të mirës materiale e shpirtërore për njeriun në shkallën më të lartë. Në ngjashmërinë e funksioneve të shtetit me ato të familjes, si qeliza bazë e shoqërisë, shohim vetë simbiozën e tyre të pandarë historike. Studimi në vijim synon thellimin e kuptimit të marrëdhënieve të shtetit dhe individit, si dhe përmirësimin dhe përsosjen e qeverisjes në dobi të qytetarëve. Studimi kontribuon edhe për një kuptim më përmbytësorë e të thelluar të rolit të shtetit si garantues i lirisë, i rendit dhe mirëqenies shoqërore. Në mënyrë të veçantë studimi ndalet në anët më thelbësore të koncepteve filozofike mbi shtetin në një qeverisje demokratike dhe lirinë e individit, si dhe mbi nevojat e përmirësimit të tyre në përputhje me kërkesat e kohës.

Fjalët kyçe: *Sistemi qeverisës, shteti, demokracia, filozofia politike, pushteti, qytetari, liria.*

Ferit BAÇA është pedagog me kohë të plotë pranë Departamentit të Filozofisë në Fakultetin e Shkencave Sociale, Universiteti i Tiranës që nga viti 2007. Aktualisht ligjëron në programet Bachelor dhe Master të organizuara nga departamenti i Filozofisë. Prioritetet dhe interesat e tij profesionale janë

Filozofi Politike dhe Zgjidhje Konfliktesh. Gjithashtu, ai është autor librash si dhe një pjesëmarrës aktiv i shumë konferencave shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare, autor i studimeve dhe artikujve shkencor të botuar në revista të njohura brenda dhe jashtë vendit.

Formimi i bashkësive dhe komuniteteve njerëzore i është nënshtruar kushteve dhe nevojave historiko - shoqërore. Këto rrethana përcaktuan edhe rregullat, nëpërmjet të cilave rregullohej jeta e përbashkët pa të cilat nuk mund të kuptohet bashkëjetesa as në shoqëritë e sotme moderne. Shtetit të epokave të hershme të shoqërive primitive i përgjigjen marrëdhënie të pazhvilluara midis njerëzve. Me zhvillimin e këtyre shoqërive, ndryshojnë edhe marrëdhëniet e njerëzve të shoqërisë në të cilën ata jetojnë. Me zhvillimin dhe përsosjen e makinës shtetërore, rriten dhe përsosen edhe e drejta, duke përfshirë fusha gjithnjë e më të gjera të veprimtarisë shoqërore. Dialektika e përsosjes së shtetit dhe shoqërisë kanë qenë dhe mbeten objekt i koncepteve dhe analizave të filozofëve të epokave të ndryshme historike. Disa prej këtyre filozofëve e paraqesin shtetin si një produkt të caqeve të arritura nga shoqëria.

Një grupim tjetër filozofësh të antikitetit, pohojnë idenë e shtetit si një autoritet i pajisur me forcë shtrënguese. Platoni e konsideronte shtetin perfekt, si një autoritet që ka paprekshmëri absolute dhe imunitet të patjetërsueshëm. Ai argumentonte rolin e veçantë të ligjeve në një shoqëri të organizuar, duke nënvizuar natyrën e dyfishtë të këtyre ligjeve, jo vetëm detyruese e ndëshkuese, por edhe rolin shërues e kurues ndaj të gjitha të këqijave morale të një shoqërie të organizuar. Një filozof tjetër bashkëkohës, Aristoteli, vinte në dukje se shteti lindi në radhë të parë për të ruajtur jetën e familjeve, kundrejt kushteve dhe rrethanave të pasigurta.

Funksioni i shtetit mbetet përfitimi i të mirës nga njeriu në shkallën më të lartë duke përfshirë edhe fushën morale dhe atë intelektuale. Funksionet e shtetit ndjekin besnikërisht funksionet e familjes,

qelizës bazë të shoqërisë. Shteti shërben për realizimin e interesave të bashkësisë shoqërore. Funksionet e tij ai i realizon nëpërmjet pushtetit. Në jetën e përditshme pushteti shfaqet si një grumbullim i të gjitha funksioneve zbatuese dhe ekzekutive në duart e shtetit. Pushteti është aftësia për t'i imponuar një urdhërim ose një rregull sjelljeje një individit ose grupeve shoqërore që jetojnë në komunitet. Në shoqëri funksionojnë pushtete të ndryshme; në komunitetet primitive ekzistonte pushteti i pleqësisë, në familje ushtrohet pushteti prindëror mbi fëmijët, etj. Funksionet e shtetit përfshijnë drejtimitet e veprimtarisë së tij të përgjithshme që synojnë realizimin dhe përmbushjen e detyrave në të mirë të shoqërisë.

Roli i individit dhe i shoqërisë në formimin dhe zhvillimin e shtetit kanë gjetur alternime të spikatura. Në zhvillimet e sotme historike, politike, sociale dhe kulturore, vihet re nevoja e përmirësimit të vazhdueshëm të demokracisë. Dinamika e kërkesave për të drejta edhe më të mëdha në jetën e përditshme, si dhe për një pjesëmarrje aktive e vendim-marrëse në organet e sistemit ligjvënës, qeverisëse, si dhe atë të drejtësisë, kërkojnë “Kurdisjen” e maratonës së shoqërisë njerëzore me hapin e kohës. Tema hedh dritë mbi raportet shtet-shoqëri. Shteti, si një strukturë qeverisëse, është mjaftueshmërisht sovran dhe i pushtetshëm për të forcuar pozitën e tij. Një numër studiuesish mendojnë se kombet janë zhvilluar përpara shteteve dhe se ato më tepër janë krijime artificiale dhe si të tilla, vijnë, ikin dhe ndryshojnë në shekuj.

Metodologjia e studimit

Metodologjia e përzgjedhur na mundëson të përshkruajmë, analizojmë dhe

interpretojmë konceptet kryesore filozofike dhe teorike që kanë ndikuar në formësimin e shtetit, lirinë dhe demokracinë në shoqëri. Studimi shpërfaq një qasje teoriko-analitike. Ai mbështetet në analizën e literaturës filozofiko-politike, mbi shtetin, funksionet e tij dhe marrëdhëniet me shoqërinë dhe individin në një sistem demokratik. Një vëmendje të veçantë studimi i kushton koncepteve filozofike mbi natyrën dhe funksionin e lirisë së individ në shtet. Për një trajtim më të thelluar kemi analizuar teoritë e filozofëve antikë, si Platoni dhe Aristoteli, etj. të cilët përfaqësojnë këndvështrime nga më të hershmet mbi shtetin si organizëm politik dhe etik në fushën e filozofisë, ligjshmërisë dhe të drejtës. Një interes të veçantë paraqesin këndvështrimet e evoluimit të formave të shteti nga ato primitive deri tek ato moderne e demokratike. Nëpërmjet krahasimeve të sistemeve qeverisëse, në kohë dhe hapësirë, synohet identifikimi i vijimësisë dhe i ndryshimeve të konceptimit dhe ushtrimit të pushtetit shtetëror.

Nëpërmjet një qasjeje analitike, studimi synon të interpretojë konceptet filozofike dhe teoritë politike në funksion të nevojave aktuale të shoqërisë moderne, duke u mbështetur në vlerësimin kritik të ideve klasike mbi autoritetin, ligjin, drejtësinë dhe lirinë, si dhe reflektimin mbi funksionet që duhet të përmbushë shteti në një demokraci të zhvilluar, si garantim i të drejtave, rritja e mirëqenies dhe nxitja e pjesëmarrjes qytetare. Metodologjia e këtij studimi përfshin punën kërkimore, bazuar në grumbullimin e materialeve shkencore, shfrytëzimin e literaturës, bibliografisë përkatëse dhe konsultimin e literaturës përkatëse. Studimi realizon njëherësh edhe një interpretim objektiv e analitik të marrëdhënieve dhe funksioneve të shtetit, individit dhe shoqërisë. Për përgatitjen e punimit u përzgjedhën ide e koncepte origjinale në dobi të thellimit të përmbajtjes së tij.

Refleksione filozofike mbi shtetin

Në kronologjinë historike shteti dhe shoqëria ndoqën besnikërisht njëri-tjetrin. Që në fillimet e ekzistencës së tyre, të nxitur nga thelbi i natyrës njerëzore, vetitë biologjike e sociale, me një fjalë, nga rrethanat historike dhe sociale, njerëzit u imponuan të jetonin në bashkësi. Ndaj dhe në çdo shoqëri, sado primitive, gjenden shenjat e vetorganizimit dhe të vendosjes të disa rregullave nëpërmjet të cilave zhvillohej jeta e përbashkët. Shteti në epokat e lashtësisë, në varësi të zhvillimit të marrëdhënieve shoqërore, dallohet cilësisht si në formë, ashtu dhe në përmbajtje nga shteti modern. Në dinamikën e zhvillimit dhe përsosjes së këtyre marrëdhënieve, mori jetë dhe u zhvillua shteti që iu përgjigj nevojave të kohës dhe veprimtarisë së shoqërisë.

Epokat historike që përshkoi njeriu në shoqërinë njerëzore i mbart edhe historia e lindjes dhe zhvillimit të shtetit, si një qelizë e tij substanciale. Platoni vinte në dukje: “një shtet lind nga fakti që askush nga ne nuk i mjafton vetvetes, mbasi ka nevojë për shumë gjëra” (Platoni 1999: 68). Për Platonin origjina e shtetit është një reflektim i nevojave ekonomike të njeriut. Një shtet fillon të ekzistojë sepse një individ nuk është i vetëmjaftueshëm, ne të gjithë kemi shumë nevoja.

Ndërsa, Aristoteli në veprën “Politika”, si element të parë të shtetit, përmend njerëzit pastaj vendin. Edhe në terminologjinë e sotme si elementë të parë përbërës të shtetit janë popullsia dhe territori. Më tej filozofi grek, vijon me citimin e elementëve të tjerë të shtetit, si: ushqimi, zanatet, armët, paratë, kujdesi për kultet, vlerësimi i interesave shtetërorë dhe vendosja e drejtësisë ndërmjet qytetarëve. Çdo shtet është një bashkim i individëve të ndryshëm dhe si çdo bashkim i tillë ruan në vetvete synime dhe qëllime të ndryshme. Të gjithë elementët që përbëjnë këtë bashkim përpiqen të arrijnë të mirën e përgjithshme. Në konceptin e Aristotelit,

Shteti është një lloj komuniteti dhe çdo komunitet krijohet duke u bazuar tek një e mirë; sepse njerëzit veprojnë gjithmonë për të arritur atë që mendojnë se është më e mira (Aristoteli, 2003: 9).

Pikëpamjet e Aristotelit për shtetin fillojnë nga analiza e rolit të familjes, duke nënvizuar se vetëm njerëzit hyjnë në mënyrë të natyrshme në raporte politike dhe merren me politikë si qenie politike. Nëse njerëzit hyjnë në marrëdhënie politike për t'i harmonizuar interesat e tyre që nga familja dhe se kjo është një e mirë për të gjithë, atëherë edhe organizimi i shtetit duhet të bëhet mbi këtë bazë si e mirë e të gjithë qytetarëve, koncepte këto që ai i lidhi edhe me vlerësimin e lumturisë. Sipas Aristotelit, vlerësimi i lumturisë në fushën politike, si për njeriun drejtues ashtu edhe për njeriun e zakonshëm është njësoj i domosdoshëm.

Në këtë lëmi tërheqin vëmendjen pikëpamjet e Hegelit mbi perspektivën idealiste të shtetit. Hegeli identifikoi tri momente të ekzistencës shoqërore: familjen, shoqërinë civile dhe shtetin. Sipas tij, "shteti është një sintezë e familjes dhe shoqërisë civile" (Hasani, 2006: 69). Hegeli argumentoi se brenda familjes mbizotëron një altruizëm i veçantë, që i inkurajon njerëzit të lënë mënjanë interesat e tyre për të mirën e fëmijëve. Në kontrast me këtë shoqëria civile shihet si një sferë ku mbizotëron një egoizëm universal, ku individët vendosin interesat e tyre mbi ato të të tjerëve. Shteti për Hegelin ishte një komunitet etik, që bazohet te simpatia reciproke, pra tek altruizmi universal. Thënë me fjalë të tjera dialektika e Hegelit përmban tri momente: tezën (familja), antitezën (shoqëria civile) dhe sintezën (shteti).

Në veprën e tij "Politika", Aristoteli shpreh:

"Shteti sipas natyrës së vet është mbi familjen dhe secilin veç e veç, sepse tërësia është medoemos më e rëndësishme se pjesët.

Nëse rrënohet tërësia, atëherë nuk ekziston as këmba, as dora... (Aristoteli, 2003: 12).

Koncepti tij mbi shtetin mbështetet në idenë se, kur të gjitha bashkimet kanë si qëllim diçka të mirë, përpigën të arrijnë akoma më lart, duke synuar më të mirën e të gjitha të mirave. Shteti, thekson Aristoteli, bëhet me ndihmën dhe vullnetin e njerëzve, prandaj ai shpreh admirimin e tij për krijuesin e parë të shtetit:

Njeriu që krijoi për herë të parë një bashkësi të tillë ishte bamirësi më i madh. Njerëzit janë më të mirë e qenieve të gjalla, kur shkojnë pas natyrës së tyre, por kur veçohen nga ligji dhe drejtësia janë më të këqijtë e të gjithëve (Aristoteli, 2003: 23).

Përveç funksionit dhe mbrojtjes së jetës së familjeve, shteti luan edhe funksionin e mjetit që i aftëson njerëzit për të arritur qëllimet e tyre. Kështu duke u nisur nga filozofia e tij e qëllimit, Aristoteli formuloi teorinë e një shteti të lidhur ngushtë me funksionin në kushtet konkrete të qeverisjes e cila duhet të aplikojë llojin e qeverisjes që përshtatet për shtete të veçanta. Në formulimet e mendimeve të tij për shtetin, spikat qëndrimi praktik dhe pragmatist ndaj funksioneve dhe modelit qeverisës të shtetit. Këto ide ruajnë një forcë dhe shkëlqim filozofiko-juridik edhe në ditët e sotme: "...qeverisja duhet të përshtatet që të ketë jetëgjatësi" (Hersch, 1995: 43). Aristoteli vlerëson çdo formë qeverisjeje, por kryesore për atë mbeten konceptet e drejtësisë dhe të barazisë mbi të cilat duhet të mbështeten ato. Ai veçoi kërkesën:

Në lidhje me faktin se qeveritë që e respektojnë interesin e përbashkët, themelohen në përputhje me parimet e rrepta të drejtësisë dhe, si rrjedhim, janë forma të vërteta; por ato që shohin vetëm interesin e drejtuesve, janë të gjitha forma të gabuara dhe të shtrembëta, pasi janë despotike, ndërsa

shteti është një komunitet njerëzish të lirë (Aristoteli, 2003: 72).

Shteti është një shprehje e nevojës që ndjen shoqëria për ekzistencën e një pushteti të organizuar, të pajisur edhe me mjetet e duhura të shtrëngimit dhe i aftë për të drejtuar vetë shoqërinë. Pushteti politik që sigurohet përmes shtetit, nuk është qëllim në vetvete, por mjeti për të vënë në zbatim një politikë të caktuar. Në kuptimin e tij real, si organizatë politike që ushtron detyrimin shtetëror, shteti ka si element të tij thelbësor pushtetin, i cili ushtrohet me anën e së drejtës, që është e pandarë prej tij. Për Aristotelin, qeverisja demokratike nuk ishte e aftë të siguronte këtë drejtpeshim; demokracia i prishte ekuilibrat dhe ia dorëzonte pushtetin vetëm masave. Ai e shihte me skepticizëm dhe me pasoja të rënda për fatin e demokracisë, për faktin se demokracia ua ushqen njerëzve ndjenjën e barazisë dhe të qenurit të lirë madje edhe në qeverisjen e shtetit. Ai mendonte: “meqenëse njerëzit janë në mënyrë të barabartë të lirë, ata pretendojnë të jenë absolutisht të barabartë” (Stuph, 1998: 405), por kur ata e kuptojnë dhe përfetojnë se janë të privuar nga liria dhe e drejta për të vetqeverisur, kjo gjendje i shtyn të hidhen domosdoshmërisht në revolucion për t’i fituar këto të drejta.

Hobsi, argumenton se:

Shteti është vepra më e madhe që mund të realizojë njeriu: ai është e mira absolute, rregulli dhe ideali absolut. Personaliteti i shtetit përbëhet nga vullneti që është unik, sepse vullneti i të gjithëve është thjeshtësuar tek një i vetëm. Njerëzit duhet të reshtin së jetuari si individë të pavarur dhe të ndarë për të formuar një vullnet të vetëm (Hobsi, 2000: 15).

Shteti është pjesë e trupit politik, si një tërësi i varur prej këtij trupi politik dhe në shërbim të së mirës së përbashkët.

Një interes të veçantë mbi shtetin, paraqesin pikëpamjet e Zhan Zhak Rusoit, pasi ai e lidh drejtimin e qeverisjes në shtet me individë që dinë të hartojnë ligje. Sipas tij, “vetëm vullneti i përgjithshëm mund t’i drejtojë forcat e shtetit sipas qëllimit të institucionit të tij, që është e mira e përbashkët (Ruso, 2007: 50). Shteti nuk është e vetmja organizatë politike, por të tilla janë edhe partitë e ndryshme. Partia në vetvete nuk është shtet, por vetëm forca e tij udhëheqëse. Partia është një pjesë e grupit shoqëror që ajo përfaqëson, pjesa më militante, kurse shteti teorikisht përfaqëson gjithë shoqërinë. Aristoteli nënvizon:

Shteti është një shoqatë politike, e cila vendos juridiksionin sovran brenda kufijve territorialë të përcaktuar dhe ushtron autoritet me anë të një tërësie institucionesh të përhershme. Këto institucione janë ato që njihen “publikisht”, në kuptimin që janë përgjegjëse për organizimin kolektiv të jetës shoqërore dhe financohen me shpenzime publike (Aristoteli, 2003: 109).

Shteti përfshin institucione të ndryshme të qeverisë por ai gjithashtu shtrihet edhe te gjykatat, te industritë e shtetëzuara, te sistemi i sigurimeve shoqërore, e kështu me radhë. Shkurt, ai mund të identifikohet me të gjithë tërësinë politike.

Shteti, individë dhe shoqëria

Shteti i realizon funksionet e tij me anë të pushtetit. Koncepti i pushtetit mishëron një koncept shoqëror, që mund të kuptohet vetëm si një marrëdhënie ndërmjet dy subjekteve, ndërmjet dy vullnetëve. Sipas Roskin (2008: 5) “pushteti është aftësia për të imponuar një urdhërim, një rregull sjelljeje një tjetri, pavarësisht nëse ky i fundit e zbaton këtë me dashje apo i detyruar”. Niveli i raportit shtet – individ, është një nga treguesit më bindës dhe më objektiv që dëshmon edhe nivelin e demokracisë

së një vendi. Për rrjedhojë, njerëzit më të lumtur, më të vetrealizuar dhe me mirëqenie më të lartë, janë ata që jetojnë në vendet më të zhvilluara dhe demokratike. Edhe Aristoteli vinte në dukje nevojën dhe lidhjen e individit me shtetin kur thekson se “ai që nuk është në gjendje të jetojë në një shtet, ose ai që nuk ka nevojë sepse është i vetëmjaftueshëm, duhet të jete ose bishë, ose perëndi” (Aristoteli, 2003: 12). Kjo veçori përforcon domosdoshmërinë e funksionimit të shtetit për krijimin e të mirave materiale dhe të lumturisë së njeriut në shkallën më të lartë. Një këndvështrim të veçantë paraqet botëkuptimi i Aristotelit mbi faktin dhe rrethanat e kushtëzimit dhe marrëdhënieve të universale me individualen. Një pikëpamje e tillë nënkupton raportin e pandashëm të shtetit me individin. Dhe, ashtu sikurse një ndërtesë ngrihet mbi themele të forta, edhe demokracia e një shoqërie është e konsoliduar atëherë kur garanton të drejtat dhe liritë e individit mbi të cilat ngrihet. Në lidhje me sigurimin e lirisë së individit është speculuar shumë nëpërmjet propagandës së garantimit të lirisë së shoqërisë në tërësi në regjimin e diktaturës së proletariatit.

Në konceptimin e organizimit të shtetit Aristoteli parashtrori tri teza. Në të parën, ai pohon se, sipas parimit natyror, qytetarët janë të barabartë, çka nënkupton se të gjithë mund të marrin pjesë në jetën politike. “Shteti, - nënvizon ai, - është një krijim nga natyra dhe se njeriu është nga natyra kafshë politike” (Aristoteli, 2003: 11). Në tezën e dytë, Aristoteli thekson se qëllimi i veprimtarisë së shtetit është arritja e lumturisë për të gjithë shtetasit, që e kanë për detyrë ta sigurojnë të gjitha institucionet e shtetit. Duke u nisur nga dy tezat e para, sipas të cilave rendi dhe shteti juridik bazohen tek morali, Aristoteli formuloi tezën e tretë, në të cilën parashtrohet, për herë të parë, teoria e ndarjes së pushteteve. Ai saktëson se çdo shtet ka tri pjesë, të cilat duhet të organizohen sa më mirë, duke patur parasysh interesat e secilës pjesë.

Vetëm përmes këtyre pjesëve të organizuara mirë, shteti mund të ushtrojë unitetin e vet funksional. Aristoteli përmend tri llojet e pushteteve në shtet: Asamblenë e Përgjithshme, e cila duhet të vendosë për çështje publike; trupin e funksionarëve dhe trupin gjyqësor. Idetë e Aristotelit mbi shtetin e së drejtës rrezatojnë edhe sot, duke e veçuar atë si njërin prej filozofëve më me ndikim edhe në ditët tona, rreth çështjeve filozofiko-politike të shoqërisë, shtetit dhe politikës.

Në këtë kuptim, kërkesat për mbrojtjen dhe zhvillimin e vlerave morale të një shoqërie që synon të ecë përpara në rrugën e përsosjes dhe zhvillimit, kërkojnë domosdoshmërisht nevojën e ekzistencës së një sistemi ligjor dhe mbrojtjen e tyre. Pikërisht kjo është edhe arsyeja pse Platoni nënvizoi rrezikun që shoqëron zhvillimin dhe zgjerimin e marrëdhënieve njerëzore nga individë të “pavirtytshëm” në rrethanat kur sistemi ligjor do të shndërrohej në një mjet frenues e pengues ndaj shkeljeve me natyrë administrative ose penale. Ligjet do të ushtronin forcën e tyre ndëshkuese ndaj shkelësve në përputhje me rrezikshmërinë dhe dëmin që ato mund t’u shkaktonin interesave të shtetit dhe shoqërisë. Në përgjithësi është e vështirë që shteti të jetë përfaqësues i gjithë shoqërisë. Vendosja e sistemit të zgjedhjeve, të bazuar në votime të përgjithshme, të barabarta, të drejtpërdrejta dhe të fshehta, si dhe ekzistenca e parlamentit, i cili në parim duhet të përfaqësojë interesat e zgjedhësve, kanë krijuar premisa që shteti të bëhet përfaqësues i gjithë shoqërisë, ose, së paku, i pjesës më të madhe të saj. Xhon Rollsi, një filozof bashkëkohorë shprehet se “institucionet e shtetit, nëse kuptohen siç duhet nga pikëpamja filozofike, në vetvete janë racionale” (Rawls, 2000: 29).

Bashkësia e individëve përbën edhe vetë shoqërinë nga ku buron uniteti i pazgjidhshëm dhe vartësia reciproke midis individit dhe shoqërisë. Deformimi i këtyre raporteve në fusha të ndryshme të jetës së një

populli, veçanërisht ato në fushën ekonomike dhe të ndarjes së të mirave materiale, shkaktojnë marrëdhënie të pariparueshme midis shoqërisë dhe individit. Hartuesit e ligjeve edhe pse janë njerëz të mandatuar nga populli, në mjaft raste joshen nga ideja e pasurimit në mënyrë të shpejtë dhe në saj të privilegjeve që duan të sigurojnë për veten e tyre. Vihet re se, sado kontradikta të pathemelta që shfaqin midis tyre partitë më të mëdha politike në Shqipëri në lidhje me reformat në fushën juridike apo legjislativë, kur vjen puna për përcaktimin e privilegjeve për shtresën e tyre, e kanë gjetur kurdoherë gjuhën e përbashkët duke rrethuar veten dhe familjet me kushte të cilat do t'ua kishin zili edhe vetë të zgjedhurit e vendeve më të zhvilluara të botës. Demokracia shqiptare vuan nga këto deformacione të raporteve midis njerëzve të thjeshtë dhe të zgjedhurve të tyre në të gjitha llojet e pushteteve. Edhe filozofët e lashtësisë kishin nënvizuar dukurinë kur individ mund të shkelë dhe prishë rregullat dhe shtetin, sikurse edhe shteti mund të dëmtojë individin.

Forma demokratike e qeverisjes së shtetit

Filozofë të ndryshëm kanë analizuar faktin se jo vetëm sistemet diktatoriale, por edhe ato demokratike dhunojnë lirinë e individit. Njëri prej tyre, *Isaiah Berlin* nënvizon se “demokracia mund të çarmatosë një oligarki të caktuar, një individ të privilegjuar apo një klasë, gjithashtu, ajo mund të shtypë lirinë individuale po aq mizorisht sa edhe sunduesit e mëparshëm” (*Berlin, 1996: 248*). Ndërsa, studiuesja dhe teoricienja e spikatur Hannah Arendt, paralajmëron:

Qeveritë totalitare si të gjitha tiranitë, nuk mund të ekzistojnë, sigurisht pa shkatërruar sferën publike të jetës, pa shkatërruar, me anë të izolimit të njerëzve aftësitë e tyre politike (*Hannah, 2002: 604*).

Në sisteme të veçanta, si bie fjala, në atë të diktaturës së proletariatit, partia identifikohet me vetë shtetin. Aristoteli ishte shprehur se Partia nuk është shteti. Në një vend mund të ketë parti legale ose ilegale që mund të jenë kundër interesave të shtetit, ose kundër partisë në fuqi. As partitë që janë në pushtet nuk mund të identifikohen me shtetin, pasi ato janë vetëm forca dhe alternativa udhëheqëse.

Demokracia është bashkëjetesa e shoqërisë njerëzore për të jetuar të lirë. Sikurse dielli për universin, në shoqërinë njerëzore demokracia u jep jetë të gjitha pushteteve; ekzekutivit, legjislativit, gjyqësorit, etj. Pikësepari, një sistem politik quhet demokratik atëherë kur shumica ose një numër i madh njerëzish gëzojnë liritë njerëzore dhe të drejtën e votës. Nga ky këndvështrim mund të thuhet se, niveli i të drejtave dhe lirive të njeriut, përbëjnë thelbin e demokracisë së një shoqërie të zhvilluar. Një shtet demokratik mbështetet në parimin se qeveria është për t'i shërbyer popullit dhe jo populli për t'i shërbyer qeverisë. Në një vend demokratik kur shtetasit votojnë, ata ushtrojnë të drejtën dhe përgjegjësinë e tyre për të zgjedhur dhe vendosur se kush do t'i drejtojë.

Sa më e gjerë të jetë demokracia në një vend, sa më tepër kushte të favorshme ekonomike të krijojë shtresave të gjera të popullsisë, aq më shumë shteti përfaqëson masën më të madhe të popullsisë. Por edhe zbatimi i parimit të marrjes së vendimeve me shumicë në demokraci ka kufijtë e vet. “Në demokraci nuk duhet kuptuar si e drejta absolute e shumicës dhe sundimi i saj mbi pakicën” (*Zaganjori, 2002: 41*). Kjo do të shënonte vendosjen e tiranisë së shumicës ndaj pakicës. Në shtetin demokratik është e domosdoshme që shumica të qeverisë dhe të marrë vendime gjithnjë në përputhje me kushtetutën, ligjet dhe rregullat demokratike. Nuk duhet harruar për asnjë çast se, megjithëse është në drejtim të shtetit, shumica vazhdon të

jetë në konkurrencë me pakicën, e cila ka alternativat e saj nëpërmjet programit politik, dhe që normalisht, në zgjedhjet e radhës, paraqitet si një alternativë e cila synon të marrë në dorë pushtetin politik me një program konkurrues në krahasim me programin e drejtuesve humbës në zgjedhje. Prandaj duhet të respektohen rregullat e lojës së ndershme demokratike dhe pakicës, të cilës në çdo rast duhet të garantohen të drejtat dhe shanse të barabarta, që në të ardhmen, përmes votës së lirë, parimisht, të mund të bëhet shumicë. Nuk mund të ketë sistem qeverisës pluralist dhe demokratik pa respektimin e të drejtave të pakicës dhe opozitës. Mosnjohja dhe mosrespektimi i këtyre të drejtave, veçanërisht nga shumica, që për një kohë të caktuar ka në dorë drejtimin e shtetit, cenon rëndë ekzistencën e vetë demokracisë. Në të vërtetë, në praktikë është vështirë të gjendet një shtet ideal të cilin synon shoqëria bashkëkohore.

Shtetasit e një vendi demokratik gëzojnë të drejtën që, sipas dëshirës, të marrin pjesë lirisht në jetën politike të shoqërisë në të cilën bëjnë pjesë. Por njëkohësisht, shtetasit duhet të marrin parasysh edhe detyrat që dalin nga kjo pjesëmarrje. Ata duhet të mësohen me mënyrën e trajtimit të problemeve, të tregojnë tolerancë ndaj pjesëtarëve të shoqërisë që kanë ide të kundërta dhe kur bëhet fjalë për interesa të përbashkëta të bien në kompromis midis tyre. Qytetaria në rastet e mësipërme, nënkupton një përkufizim më të gjerë të të drejtave dhe detyrave, si dy anë të kundërta të së njëjtës medalje. Ushtrimi i të drejtave nga një individ nënkupton edhe përgjegjësinë që ka ai për mbrojtjen dhe fuqizimin e këtyre të drejtave, për veten e tij dhe për të tjerët. Shpeshherë edhe shtetasit e vendeve me tradita të njohura në fushën e demokracisë i cenojnë këto marrëdhënie, duke përfutur nga të drejtat dhe duke lënë pas dore kryerjen e detyrimeve dhe mbajtjen e

përgjegjësi. Demokracia kuptohet si sundimi i shumicës, ndërsa të drejtat kuptohen përherë edhe më tepër si pronë personale e individëve të elitave drejtuese.

Uniteti dialektik i të drejtave dhe i detyrave në një shoqëri demokratike shprehet në faktin se, nga njëra anë, individët gëzojnë të drejtën e lirisë së fjalës, të grumbullimit dhe të lirisë së besimit fetar, të cilat dëshmojnë për nivelin e një shoqërie demokratike. Nga ana tjetër, të drejtat, nuk janë pronë personale e individëve, mjete apo “Shprehje e lirisë” për t’ju kundërvënë shumicës. Demokracia, kërkon bashkëpunim, kompromis dhe tolerancë midis gjithë qytetarëve. Në fund të fundit, kuptimi më i lartë i lirisë është i lidhur ngushtë me marrjen e përgjegjësisë për fatin e individit dhe të bashkësisë ku jeton dhe jo çlirim nga përgjegjësia ndaj tyre. Demokracia nuk mund t’i shndërrojë të gjithë qytetarët e saj në qytetarë shembullorë, si me preken e një shkopi magjik, por kërkon që shtetasit të jenë të gjithë të përgjegjshëm për të drejtat dhe detyrat e tyre.

Thelbi i shtetit demokratik varet nga vendosja e një raporti të ndërsjellët midis shtetasve dhe vetë shtetit. Tabloja e këtyre marrëdhënieve karakterizohet nga njëra anë, nga: “Fryma dhe klima” demokratike e cila udhëheq nevojën e shoqërisë për vendosjen e normave dhe ligjeve demokratike të cilat i përmbush më së miri një shtet ligjor që përfaqëson dhe përmbush interesat e popullit. Dhe nga ana tjetër, nga marrëdhëniet e shtetasve me shtetin që mund të identifikohen me të drejtën e shtetit për të vendosur norma dhe ligje dhe detyrimin e vetë shtetasve për t’i respektuar këto norma. Në një shtet sundon demokracia e vërtetë vetëm atëherë kur ligjet që udhëheqin atë hartohen nga shtetasit e tij. Përcaktimi i figurës së një burri shteti dhe i një qytetari varen nga lloji dhe forma e qeverisjes. Karakteristika kryesore e qytetarit është se ai merr pjesë në

administrimin e drejtësisë dhe në detyra të tjera shoqërore. Kjo karakteristikë, në fakt i shkon për shtat qytetarit të demokracisë, të cilën e nënvizon Aristoteli:

Ai që ka pushtet për të marrë pjesë në administratën shqyrtuese apo gjyqësore të çdo shteti, është qytetar i atij shteti; dhe në përgjithësi, shteti është trupi i qytetarëve të mjaftueshëm për qëllimet e jetës (Aristoteli, 2003: 65).

Qytetari është i përcaktuar nga detyra që mban, ai që ka detyrë legjislativë ose juridike përmbush edhe përcaktimin e figurës së qytetarit. Por a është i njëjtë virtyti i një njeriu të mirë dhe i një qytetari të mirë? Virtyti i qytetarit varet nga bashkësia ku ai bën pjesë. Për rrjedhojë, njeri i mirë është ai që ka një virtyt të përkryer. Dy llojet e virtytit nuk mund të jenë absolutisht dhe gjithmonë të njëjtët. Rendin kushtetues, një drejtues, një burrë shteti duhet ta mësojë nëpërmjet edukimit dhe bindjes ndaj tij. Ai që nuk ka mësuar kurrë të bindet nuk mund të jetë i aftë për të dyja: si të drejtojë dhe si të bindet, këto janë virtytet e qytetarit. Meqenëse urtësia dhe drejtësia e drejtuesit ndryshojnë nga ato të subjektit, virtyti i njeriut të mirë i përfshin të dyja, edhe gjendjen e të qenurit i lirë edhe si një subjekt i politikës. Virtyti i drejtuesit është urtësia; virtyti i subjektit është mendimi i drejtë. Ka tipa të ndryshëm qytetarësh, qytetari i shkallës së lartë është ai që merr pjesë në kryerjen e detyrave të shtetit. Në disa shtete njeriu i mirë dhe qytetari i mirë janë e njëjta gjë, ndërsa në raste të tjera ndryshojnë. Shumica e njerëzve e njësojnë të mirën ose lumturinë me kënaqësinë. Synimi i kënaqësisë përfshin një lloj jetese të zakonshme, por ka edhe lloje të tjera jetese, nga ku disa njerëz nuk kërkojnë kënaqësinë, por moralin dhe nderin. Ata drejtojnë jetën politike, të tjerët nuk kërkojnë vetëm nderin por edhe virtytin, ata besojnë se nderi nuk është sipëror kundrejt kënaqësisë, e megjithatë

nderi nuk është qëllim në vetvete. Shumica e njerëzve e kërkojnë nderin që të sigurohen për mirësinë e tyre, kështu ata nuk do ta veçonin vlerësimin e njerëzve me urtësi praktike, kundrejt vlerësimit të njerëzve të paditur dhe të largët. Për ata, virtyti duket se është më i lartë se nderi dhe qëllimi për të cilin vlerësohet nderi.

Përfundime

Nëpërmjet studimit “Shteti dhe zbatimi i lirisë së individit në demokraci”, kemi synuar trajtimin e praktikave dhe teorive mbi shtetin gjatë rrjedhëve të historisë njerëzore, nga qytet-shtetet antike, deri tek triumfi i sistemit qeverisës demokratik bashkëkohor. Demokracia përfaqëson sot jo vetëm një sistem politik, por edhe një mënyrë jetese, një kulturë pjesëmarrjeje dhe një ideal që siguron barazi, liri dhe përgjegjësi kolektive. Filozofët kanë vënë në dukje rolin e shtetit si një organizëm politik dhe etik, në funksion të së mirës së përbashkët dhe mbrojtjes së lirisë njerëzore.

Studimi nënvizon idenë se kuptimi dhe funksionet e shtetit nuk janë të pandryshueshme, por të ndryshueshëm dhe në përgjigje të kërkesave të shoqërisë. Vetëm një shtet që mbështetet mbi vlera të tilla mund të garantojë një shoqëri demokratike. Si forma më e përparuar e qeverisjes, demokracia kërkon një raport të harmonizuar midis ushtrimit të autoritetit dhe lirisë, midis pushtetit dhe pjesëmarrjes qytetare. Pushteti i shtetit nuk është absolut, por një marrëdhënie midis dy vullneteve: palës që e ushtron pushtetin dhe asaj nënshtruese. Në thelb individi është një qenie politike që nuk mund të realizohet plotësisht jashtë shtetit. Aristoteli vinte në dukje se lumturia e qytetarëve është qëllimi kryesor i funksionimit të shtetit, i cili duhet të bazohet në moral, drejtësi dhe ndarje të pushteteve. Demokracia është një mënyrë bashkëjetese ku shteti nuk sundon qytetarin, por është në shërbim të tij. Por

kjo marrëdhënie është e shëndetshme kur qytetarët janë të vetëdijshëm për të drejtat e tyre, si edhe për detyrimet që kanë ndaj shoqërisë dhe shtetit.

Studimi nënvizon faktin se demokracia nuk është një sistem qeverisës ku çdo gjë shkon si në vaj. Platoni paralajmëroi rrezikun që vjen nga individët e pavirtytshëm, duke theksuar rëndësinë e një sistemi ligjor ndëshkues ndaj shkeljeve dhe cenimit të rendit shoqëror. Dinamika bashkëkohore përballet me sfida të reja të cilat kërkojnë përshtatje dhe rigjallërim të institucioneve të saj. Digjitalizimi, globalizimi, dezinformimi, radikalizimi politik, si dhe rritja e populizmit mbeten fenomene të cilat vënë në provë qëndrueshmërinë dhe përfaqësimin real të vullnetit qytetar. Rinovimi i demokracisë nuk duhet parë si një përmbysje e vlerave të trashëguara, por si një domosdoshmëri

për të përmirësuar format e saj drejt një modeli më gjithëpërfshirës, transparent dhe reagues ndaj sfidave të kohës. Demokracia bashkëkohore duhet të ndërtohet mbi parimin e bashkëpunimit të pushtetit me qytetarin, duke tejkaluar modelin klasik përfaqësues dhe duke përshtatur format të reja të demokracisë pjesëmarrëse.

Sipas filozofëve modernë "eliksiri" i përpjetësisë së demokracisë mbetet thellimi dhe zbatimi i proceseve transformuese duke iu përgjigjur kërkesave të kohës. Trashëgimia e sistemit demokratik është një vlerë që kërkon përkujdesje të vazhdueshme dhe guxim rinovues. Ajo nuk është një gjendje e fiksuar dhe e ngrirë, sado e suksesshme që të parqitet, por një proces zhvillimi i pandërprerë – një ideal dhe praktikë përkushtuese për ta jetuar dhe përmirësuar atë.

REFERENCAT

- Aristoteli. (2003). *Politika*, Stiran`: Shtëpia Botuese Plejad.
- Berlin, I. (1990). *Idetë filozofike të shekullit 20*, Tiranë: Onufri.
- Hannah, A. (2002). *Origjina e totalitarizmit*, Prishtinë: Botime Dija.
- Hasani, L., (2006). *Filozofia e së drejtës*, Tiranë: Shtëpia botuese Mamluka.
- Hersch, J. (2009). *Habia filozofike*, Tiranë: Dituria.
- Hobbes, Th. (2000). *Leviatani*, Tiranë: ISP and Dita.
- McDonald, L. C. (2006). *Teoria politike përëndimore*, Tiranë: Ideart.
- Rawls, J. (2000). *"Drejtësia si Paanshmëri: Riformulim"*, Tiranë: ISP dhe DITA.
- Roskin, Michale et al. (2008). *Political Science*, vol. 10, USA: Pearson Prentice Hall.
- Ruso, Zh. Zh. (2007). *Kontrata Sociale*, botimi i IV, Tiranë: Luarasi University Press.
- Platoni. (1999). *Republika*, Tiranë: CEU dhe Shtëpia e Librit Phonix.
- Stuph, S. E. (1998). *Filozofia: Historia dhe problem*, Tiranë: Toena.
- Zaganjori, Xh. (2002). *Demokracia dhe shteti i së drejtës*, Tiranë: Luarasi

ABSTRACT

In all theoretical and philosophical writings, the notion of the state also includes the anatomy of early city-states. The foundation of every state is its citizens. The state is a part of the political body that deals with the implementation of laws, the insurance of well-being, the maintenance of public order, and governance. Since the state possesses the right to power and the use of force when its interests require it, metaphorically, many philosophers have

described it as a mythological being or possessing the strength of a monster. We recall Thomas Hobbes's Leviathan. The people are the source of all power. Although the state is representative of the people, it does not possess all the rights of the people. The state mandated by the people is a structure organized for the needs of development and social life and the organs elected by it. The functions of the state are related to ensuring the highest level of material and spiritual well-being for man. In the similarity of the functions of the state with those of the family, as the basic cell of society, we see their inseparable historical symbiosis. The paper aims to deepen the understanding of the relations between the state and the individual, as well as to improve and perfect governance for the benefit of citizens. The study also contributes to a more comprehensive and in-depth understanding of the role of the state as a guarantor of freedom, order, and social well-being. In particular, the study focuses on the most essential aspects of philosophical concepts on the state in a democratic government and the freedom of the individual, as well as on the needs for their improvement in accordance with the requirements of the time.

Key words: *Governing system, state, democracy, political philosophy, power, citizenship, freedom.*

SHËRBIMET E MBËSHTETJES PËR VIKTIMAT E DHUNËS ME BAZË GJINORE NË ZONAT RURALE. SFIDA DHE MUNDËSI PËR PËRMIRËSIMIN E AKSESIT DHE CILËSISË

Marsela ALLMUÇA
Universiteti i Tiranës
Fakulteti i Shkencave Sociale
Departamenti i Punës Sociale dhe Politikës Sociale
Email: marsela.allmuca@unitir.edu.al
E-mail: allmucamarsela@gmail.com

PËRMBLEDHJE

Dhuna në familje dhe dhuna me bazë gjinore vijon të mbetet një problem serioz në shoqërinë Shqiptare. Sipas Anketës Kombëtare mbi Dhunën ndaj Grave në Shqipëri, të kryer në vitin 2018, një në çdo dy gra në Shqipëri ka përjetuar dhunë gjatë jetës së saj, ndërsa një në tre gra kishte përjetuar dhunë gjatë 12 muajve të fundit. Në këtë artikull trajtohet rëndësia e ofrimit të shërbimeve të integruara për të mbijetuarat/mbijetuarit e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore si edhe sfidat e ofrimit të këtyre shërbimeve në zonat rurale. Metodologjia e përdorur është cilësore e bazuar në të dhënat dytësore të disponueshme si studime, raporte, kuadri ligjorë dhe 11 intervista gjysmë të strukturuar me ofrues shërbimesh për rastet e dhunës në familje në nivel Njësie Administrative. Konkluzionet kryesore të studimit lidhen me mungesën e një pakete të plotë shërbimesh në nivel Njësie Administrative, mungesën e shërbimeve të specializuara për mbështetje emergjente dhe afatgjatë, infrastrukturën e pamjaftueshme dhe distancat e mëdha që kufizojnë aksesin në ndihmë, stigmatizimin social, i cili pengon raportimin dhe kërkimin e ndihmës, mungesën e trajnimit të specializuar për punonjësit që menaxhojnë rastet e dhunës, etj. Rezultatet e studimit theksojnë nevojën për ndërhyrje të integruara, duke përfshirë rritjen e financimeve, përmirësimin e infrastrukturës dhe zhvillimin e kapaciteteve të punonjësve të përfshirë në menaxhimin e rasteve me qëllim sigurimi e një qasjeje më të plotë dhe cilësore për viktimat e dhunës me bazë gjinore, veçanërisht në zonat rurale.

Fjalë kyçe: *Dhuna me bazë gjinore, shërbime sociale, zonat rurale, akses në mbështetje, stigma sociale.*

Marsela ALLMUÇA është Asistent Lektore me kohë të plotë në Departamentin e Punës dhe Politikës Sociale në Fakultetin e Shkencave Sociale, Universiteti i Tiranës si dhe kandidatë për gradën shkencore “Doktor” në shkenca sociale, me fokus në fushën e Punës Sociale. Me një eksperiencë të gjerë prej më shumë se dhjetë vitesh, ajo ka kontribuar në zhvillimin dhe zbatimin e një sërë programesh dhe ndërhyrjesh, të cilat kanë pasur si objektiv kryesor adresimin dhe parandalimin e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore.

Dhuna me bazë gjinore (DHBGJ) vazhdon të mbetet një fenomen shqetësues që prek shoqërinë shqiptare në nivele të ndryshme, duke u manifestuar në forma të ndryshme, përfshirë dhunën fizike, psikologjike, emocionale, seksuale dhe ekonomike. Sipas Anketës Kombëtare mbi Dhunën ndaj Grave në Shqipëri (INSTAT, 2018) një në çdo dy gra ka përjetuar dhunë gjatë jetës së saj, ndërsa një në tre gra ka përjetuar dhunë gjatë 12 muajve të fundit. Ky problem, që shpesh është i padukshëm për shoqërinë, ka pasojat e tij të thella, duke prekur jo vetëm individët, por edhe familjet dhe komunitetet në tërësi. Viktimat e dhunës me bazë gjinore përballen me vështirësi të shumta për të aksesuar shërbimet e nevojshme, sidomos ato që jetojnë në zonat rurale të Shqipërisë, ku infrastruktura është e munguar dhe shërbimet janë shpesh të pamjaftueshme.

Në këtë kontekst, ofrimi i shërbimeve të integruara për viktimat e DHBGJ është i domosdoshëm për të siguruar mbështetje emergjente, mbrojtje, rehabilitim dhe riintegrim afatgjatë. Sidoqoftë, në zonat rurale, ku infrastruktura është e pamjaftueshme dhe distancat e mëdha janë një pengesë për të aksesuar ndihmën, sfidat janë edhe më të mëdha. Mungesa e shërbimeve të specializuara, si dhe mungesa e burimeve dhe stafit të trajnuar, kufizojnë ndihmën për viktimat, duke përkeqësuar edhe më tej situatën. Për më tepër, siç tregon edhe studimi i fundit mbi popullatën, 50% e grave në Shqipëri besojnë se dhuna brenda martesës është një çështje private dhe 46.5% mendojnë se duhet të tolerohet një formë dhune për të ruajtur familjen (INSTAT, 2018). Ky mentalitet dhe stigma sociale shpesh pengojnë viktimat të raportojnë

dhunën dhe të kërkojnë ndihmë.

Ky artikull do të shqyrtojë rëndësinë e ofrimit të shërbimeve të integruara për viktimat e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore në Shqipëri, duke u fokusuar në sfidat specifike që përballen viktimat në zonat rurale. Do të analizohen të dhënat e fundit mbi përhapjen e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore, si dhe sfidat e veçanta që lidhen me ofrimin e shërbimeve në këto zona. Duke shqyrtuar përvojat e ofruesve të shërbimeve sociale dhe analizuar infrastrukturën e nevojshme, ky hulumtim synon të ofrojë rekomandime për përmirësimin e aksesit dhe cilësisë së shërbimeve, me qëllim sigurimin e mbështetjes së nevojshme për viktimat, pavarësisht vendndodhjes së tyre. Kjo do të kontribuojë në zhvillimin e politikave dhe praktikave më efektive për të garantuar një mbështetje më të plotë dhe më të aksesueshme për viktimat e dhunës me bazë gjinore në Shqipëri.

Rishikimi i literaturës

Dhuna me bazë gjinore përfaqëson një sfidë komplekse dhe shumëdimensionale që rrënjos të drejtat themelore njerëzore dhe pengon zhvillimin e barabartë shoqëror. Dhuna shfaqet si një fenomen global që tejkalon kufijtë kulturorë, socialë dhe ekonomikë, duke prekur miliona individë çdo vit, me pasoja afatgjata për viktimat, familjet dhe komunitetet. Ajo rrënjohet në pabarazitë gjinore dhe strukturat patriarkale që mbizotërojnë në shumë shoqëri (European Institute for Gender Equality, 2024). Në Bashkimin Evropian, 30.7% e grave kanë përjetuar dhunë fizike ose kërcënime gjatë jetës së tyre, ndërsa 17.2% kanë përjetuar

dhunë seksuale (Eurostat, 2024).

Në kontekstin shqiptar, sfidat për përmirësimin e aksesit dhe cilësisë së shërbimeve për viktimat e DBGJ mbeten të shumta. Edhe pse kuadri ligjor ka bërë përparime, si miratimi i Ligjit për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare (KSH, 2006) dhe Ligjit për Barazinë Gjinore (KSH, 2008), zbatimi i tyre është shpesh i kufizuar për shkak të mungesës së burimeve financiare dhe kapaciteteve institucionale (INSTAT, 2018). Sipas të dhënave të INSTAT, më shumë se gjysma (52.9%) e grave kanë përjetuar një formë dhune gjatë jetës së tyre. Dhuna në takime ishte e përhapur, duke prekur 65.8% të grave, 47% e grave kanë përjetuar dhunë në familje nga partneri intim, Një në pesë gra është përballur me dhunë fizike dhe/ose seksuale, 18.2% e grave kanë përjetuar dhunë nga persona të tjerë që nuk janë partnerë, 18.1% e grave kanë përjetuar ngacmim seksual. 12.6% e grave kanë qenë viktima të ndjekjes (stalking).

Nga ky studim rezultoi se qëndrimet kulturore ndaj dhunës janë shqetësuese ku 50% e grave besojnë se dhuna brenda martesës është një çështje private, 46.5% e grave mendojnë se një formë e dhunës duhet të tolerohet për të ruajtur familjen dhe 26.1% e grave ndihen të turpëruara për të raportuar përdhunimin (INSTAT, 2019). Gratë në zonat rurale janë më të prekura nga dhuna emocionale dhe fizike nga partnerët krahasuar me ato në zonat urbane (INSTAT, 2018; UN Women, 2020; Avokati i

Popullit, 2022). Megjithëse edhe burrat dhe fëmijët përjetojnë dhunë në familje, rastet e tyre raportohen më rrallë, ndoshta për shkak të normave dhe stereotipeve shoqërore (UN Women, 2020).

Ka një rritje të numrit të raportimeve të dhunës në familje në strukturat e policisë së shtetit nga 3,866 në vitin 2015 në 5,445 në vitin 2024, duke treguar se ka një ndërgjegjësim më të madh për të raportuar, ashtu edhe vazhdimësinë e problemit. Më konkretisht si në tabelën 1.

Gratë dhe vajzat që jetojnë në zona rurale janë veçanërisht të rrezikuara nga dhuna për shkak të mungesës së infrastrukturës, burimeve të kufizuara dhe stigmatizimit shoqëror (EIGE, 2024). Rekomandimi i Përgjithshëm Nr. 19 i Komitetit për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave thekson se gratë në zonat rurale përballen me rreziqe më të larta të dhunës për shkak të normave tradicionale që mbështesin role gjinore të pabarabarta (CEDAW, 1992). Përveç kësaj, vajzat nga komunitetet rurale janë veçanërisht të ekspozuara ndaj shfrytëzimit seksual kur largohen nga komuniteti për të kërkuar punë në qytete (UN Women, 2021).

Një faktor tjetër që ka përkeqësuar situatën e viktimave të DHBGJ është pandemia COVID-19. Kufizimet e lëvizjes dhe masat e izolimit çuan në një rritje të ndjeshme të dhunës në familje, ndërsa qendrat e mbështetjes u përballën me sfida të reja në ofrimin e ndihmës (UN Women, 2021).

Tabela 1: *Rastet e raportuara të dhunës në familje në Shqipëri (2019-2024)*

Viti	Totali i rasteve	Gra	Burra	% Gra	% Burra
2019	4,629	3,596	1,235	78%	27%
2020	4,701	3,497	1,370	74%	29%
2021	5,312	3,871	1,458	73%	27%
2022	5,214	3,772	1,466	72%	28%
2024	5,445	3,822	1,623	71%	29%

[Burimi: Ministria e Brendshme, Raporti vjetor 2024].

Sfidat e grave dhe vajzave në zonat rurale Metodologjia

Gratë dhe vajzat në zonat rurale duket se përballen me sfida të shumëfishta në kërkimin e ndihmës. Sipas UNFPA ndër barrierat kryesore për ofrimin e shërbimeve në zonat rurale lidhet me distancat e mëdha dhe mungesa e transportit – Shumë gra nuk mund të udhëtojnë për të kërkuar ndihmë për shkak të mungesës së infrastrukturës së transportit. (UNFPA, 2022). Nga ana tjetër normat sociale si stigmatizimi i viktimave dhe turpi i lidhur me dhunën shpesh i pengojnë gratë të raportojnë dhunën apo të kërkojnë ndihmë në institucionet përgjegjëse (EIGE, 2024). Gjithashtu është vënë re dhe ka të dhëna që në zonat rurale ka një mungesë të theksuar të profesionistëve të trajnuar kjo edhe për shkak të mundësive të kufizuara që ofrohen në këto zona edhe për profesionistët. Shërbimet mbështetëse në zonat rurale shpesh vuajnë nga mungesa e stafit të kualifikuar dhe trajnimeve të specializuara për menaxhimin e rasteve të dhunës (European Institute for Gender Equality, 2024).

Për të adresuar këto sfida, studimet sugjerojnë përdorimin e qasjes së decentralizuar, përfshirë qendrat e lëvizshme të shërbimeve sociale, platforma online për kërkimin e ndihmës apo raportimin por edhe për mbështetje psikologjike dhe ligjore, dhe rritjen e kapaciteteve të punonjësve socialë (UNFPA, 2022). Gjithashtu, fuqizimi ekonomik i grave në zonat rurale konsiderohet një strategji kyçe për të reduktuar varësinë ekonomike që shpesh i mban viktimat në marrëdhënie abuzive (Sida, 2015).

Bazuar në literaturën ekzistuese, është e qartë se përmirësimi i shërbimeve për viktimat e dhunës me bazë gjinore në zonat rurale kërkon investime të qëndrueshme në shërbimet sociale dhe ndryshimin e normave shoqërore që lidhen me dhunën dhe viktimat e saj.

Për realizimin e këtij punimi është përdorur një metodologji cilësore për të analizuar sfidat dhe mundësitë për përmirësimin e shërbimeve të mbështetjes për viktimat e dhunës me bazë gjinore në zonat rurale. Përdorimi i kësaj metodologjie është i rëndësishëm pasi lejon një kuptim të thelluar të përvojave dhe perspektivave të punonjësve të shërbimeve sociale që operojnë në këto zona dhe në sektorin e shërbimeve mbështetëse për viktimat e dhunës me bazë gjinore. Gjithashtu qasja cilësore mundëson hulumtimin e detajuar të praktikave, sfidave dhe mundësive për përmirësimin e shërbimeve në kontekstin specifik të komuniteteve rurale.

Në këtë studim, janë formuluar dy pyetje kërkimore të rëndësishme: E para synon të identifikojë sfidat kryesore me të cilat përballen punonjësit e shërbimeve sociale në ofrimin e mbështetjes për viktimat e dhunës me bazë gjinore në zonat rurale, ndërsa e dyta përqendrohet në mundësitë dhe mënyrat për të përmirësuar këto shërbime duke marrë parasysh karakteristikat dhe nevojat e komunitetit rural.

Kampioni përbëhet nga 11 punonjës të shërbimeve sociale që punojnë në shërbime sociale në Njësitë Administrative rurale të Bashkisë Tiranë. Pjesëmarrësit janë profesionistë me përvojë dhe njohuri mbi ofrimin e shërbimeve për viktimat e dhunës me bazë gjinore. Ky kampion është zgjedhur për të ofruar një pasqyrë të detajuar dhe të thelluar mbi praktikat ekzistuese, sfidat, dhe mundësitë për përmirësimin e shërbimeve të mbështetjes për viktimat e dhunës në këto zona. Përzgjedhja e punonjësve të shërbimeve sociale dhe menaxherëve të rasteve ka qënë e qëllimshme dhe është bërë me qëllim që të përfshihen profesionistë që njohin kontekstin e komuniteteve rurale dhe njohuri të mira mbi situatën e ofrimit të shërbimeve për viktimat e dhunës me bazë gjinore.

Kritere të caktuara të qëllimshme janë përdorur për përzgjedhjen e pjesëmarrësve, përfshirë përvojën profesionale, pozicionin e punës dhe vendndodhjen. Janë përfshirë ato profesionistë të cilët kanë patur të paktën dy vite eksperiencë të drejtpërdrejtë në ofrimin e shërbimeve për viktimat e dhunës me bazë gjinore në zonat rurale, punonjës socialë, menaxherë të rasteve, ose profesionistë të tjerë që kontribuojnë në mbështetje për viktimat e dhunës.

Instrumenti kryesor i përdorur për mbledhjen e të dhënave është intervistat gjysmë e strukturuar me qëllim për të siguruar hapësirë të nevojshme në mbledhjen e informacionit, duke lejuar që pjesëmarrësit të ndajnë përvojat dhe mendimet e tyre në mënyrë të hapur. Intervista e ndarë në disa seksione të fokusuara tek situatë e shërbimeve, praktikat ekzistuese, sfidat që hasin punonjësit e shërbimeve sociale dhe mundësitë për përmirësim të shërbimeve në komunitetet rurale. Gjithashtu, ky instrument është zgjedhur për të siguruar që të dhënat të mblidhen në mënyrë të tillë që të mund të pasqyrojnë në mënyrë të saktë kompleksitetin e situatës dhe të ofrojnë një kuptim të thellë të dinamikave të shërbimeve sociale në zonat rurale.

Për analizimin e të dhënave është përdorur qasja analitike tematike, e fokusuar në identifikimin dhe organizimin e temave kryesore nga intervistat. Fillimisht, u realizua një kodim fillestar për të evidentuar sfidat institucionale, sociale dhe individuale që ndikojnë në ofrimin e shërbimeve, si dhe mundësitë për përmirësim. Më pas, një kodim më i thelluar shqyrtoi ndërlidhjet mes temave, duke eksploruar faktorë si burimet e kufizuara, mungesa e trajnimit dhe ndikimi i normave sociale. Analiza krahasuese ndihmoi në identifikimin e përvojave të përbashkëta dhe konkluzioneve kryesore, duke siguruar një kuptim gjithëpërfshirës për sfidat dhe mundësitë në përmirësimin e shërbimeve për viktimat e dhunës me bazë gjinore në zonat rurale.

Gjetjet kryesore

Një nga pengesat kryesore që kanë theksuar punonjësit e shërbimeve sociale në zonat rurale është mungesa e burimeve dhe infrastrukturës. Shumë prej tyre kanë nënvizuar se mungesa e buxheteve të dedikuara për menaxhimin e rasteve të dhunës është një sfidë e madhe në ofrimin e mbështetjes efektive dhe cilësore. Kjo mungesë e financimeve ndikon drejtpërdrejt në sasinë dhe cilësinë e shërbimeve të ofruara, duke i lënë viktimat pa ndihmën e nevojshme si edhe në një funksionalitet të kufizuar të këtyre shërbimeve, duke ndikuar negativisht në rezultatet e ndihmës për viktimat e dhunës. Siç pohon një punonjëse e intervistuar e shërbimeve sociale,

mungesa e buxheteve të dedikuara dhe stafit të mjaftueshëm të specializuar e bën të vështirë për të ofruar shërbime të plota dhe për të mbështetur viktimat që janë në nevojë urgjente. Në Njësinë tonë jam vetëm unë që mbuloj të gjitha target grupet në nevojë përfshirë edhe pagesat kesh të ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar.

Një tjetër barrierë e rëndësishme është paraqitja e paragjyqimeve dhe stigmës sociale rreth dhunës me bazë gjinore, e cila mbetet një problem dhe pengesë kryesore në adresimin e dhunës në zonat rurale. Pjesëmarrëset theksuan se viktimat e dhunës shpesh ndihen të izoluar dhe të frikësuara nga gjykimi i shoqërisë dhe refuzimi nga komuniteti. Kjo është një nga arsyet kryesore pse shumë gra nuk kërkojnë ndihmë, pasi ato frikësohen se do të gjykohen për prishjen e martesës. Shtuar kësaj, normat tradicionale të komunitetit shpesh ndihmojnë në mbrojtjen e dhunës, duke e konsideruar atë si një çështje private dhe jo si një problem që kërkon ndërhyrjen e shërbimeve të jashtme. Ky kontekst bën që shumë viktimat të mbeten të heshtura dhe të mos kërkojnë ndihmë në kohë.

Një tjetër çështje thelbësore që është mungesa e mbështetjes psikologjike të specializuar për viktimat e dhunës. Në shumicën e rasteve, gra dhe vajza që përjetojnë dhunë shpesh janë të paafta të arrijnë tek shërbimet psikologjike që do t'i ndihmonin për të kaluar përmes procesit të rehabilitimit. Pa këtë mbështetje, ato janë më të ekspozuara ndaj pasojave të dhunës, duke përfshirë trauma të thella dhe një cikël të vazhdueshëm të dhunës, i cili është shumë i vështirë për t'u thyer. Pjesëmarrësit shpjeguan se mungesa e informacionit dhe mundësive për mbështetje psikologjike është një barrierë serioze për viktimat që kërkojnë të rindërtojnë jetën e tyre pas një periudhe të dhunës. Siç del nga intervistat, shumë gra nuk kanë mundësi të marrin ndihmën e duhur të specializuar psikologjike dhe, për rrjedhojë, ato e gjejnë të vështirë të kapërcejnë traumat dhe të ndihmohen për të krijuar një jetë të re.

Një tjetër sfidë që është ngritur është qasja e kufizuar në shërbime dhe transporti i sigurtë, sidomos në zonat më të izoluara rurale. Mungesa e infrastrukturës së transportit, distanca e madhe dhe kostot e udhëtimit janë barrierat kryesore që pengojnë viktimat të kërkojnë ndihmë. Shumë gra duhet të udhëtojnë me orë të tëra për të arritur në qendrat e shërbimeve, dhe për disa prej tyre, kjo është një pengesë e madhe. Kjo është një çështje shumë e rëndësishme pasi ndikon drejtpërdrejt në qasjen e viktimave në shërbime dhe, si pasojë, pengon procesin e rehabilitimit dhe mundësinë për të kërkuar ndihmë. Ekspertët e intervistuar pohojnë se,

viktimat shpeshherë duhet të udhëtojnë më shumë se dy orë për të arritur në qendrat e shërbimeve, dhe për disa prej tyre, kjo është një pengesë e madhe. Ne si njësi nuk kemi asnjë mundësi financiare për të mbuluar transportin e sigurtë të rasteve. Ndonjëherë e kemi ofruar me mjetet tona personale por kjo nuk është një zgjidhje afatgjatë dhe e

qëndrueshme (intervistë me një punonjëse të shërbimeve sociale).

Gjithashtu, gratë në zonat rurale shpesh janë të varfra dhe nuk kanë mundësi të mbështesin veten dhe fëmijët e tyre nëse largohen nga një marrëdhënie e dhunshme, kjo për shkak të mungesës së një pune të paguar. Kjo varfëri ekonomike i bën ato të varura nga partnerët dhunues dhe e bën të vështirë largimin nga një marrëdhënie e dhunshme. Një situatë e tillë i detyron ato të qëndrojnë në marrëdhënie abuzive për shkak të frikës nga pasiguria ekonomike dhe pasojat që mund të vijnë pas largimit.

Në përfundim, ky studim ka identifikuar disa barrierat të rëndësishme që pengojnë ofrimin efektiv të shërbimeve për viktimat e dhunës me bazë gjinore në zonat rurale. Mungesa e burimeve dhe infrastrukturës, stigmën sociale, vështirësitë në qasjen në shërbime, dhe sfidat ekonomike dhe kulturore janë disa nga faktorët që ndikojnë negativisht në mbështetje për viktimat. Sidoqoftë, studimi gjithashtu ka theksuar nevojën për më shumë mundësi trajnimi dhe mbështetje për punonjësit e shërbimeve sociale, përmirësimin e kushteve të punës dhe ofrimin e mundësive më të shumta për viktimat për të pasur akses në mbështetje dhe shërbime psikologjike. Për të përmirësuar mbështetje për viktimat dhe për të krijuar mundësi më të mira për ata që janë në vijën e parë të ndihmës, duhet të investohet më shumë në burime, infrastrukturë dhe shërbime të aksesueshme, veçanërisht në zonat rurale.

Rekomandime

Nga ky shqyrtim mund të rekomandojmë:

Rritja e burimeve: mungesa e burimeve dhe infrastrukturës është një nga pengesat kryesore për ofrimin e shërbimeve efektive. Për të siguruar që viktimat të kenë qasje të mjaftueshme dhe të qëndrueshme në mbështetje, është e nevojshme që qeveria

dhe organizatat ndërkombëtare të rrisin investimet në sektorin e shërbimeve sociale për zonat rurale. Ky financim duhet të fokusohet jo vetëm në zgjerimin e burimeve për trajtimin e viktimave, por edhe në trajnimin e specialistëve, që të jenë të aftë të ofrojnë mbështetje të specializuar dhe të mirëpërcaktuar. Po ashtu, duhet të krijohen mundësi për zhvillimin e infrastrukturës, duke siguruar akses më të lehtë dhe më të sigurt në shërbime, sidomos për zonat më të izoluar. Kjo përfshin ngritjen e qendrave të reja, si dhe forcimin e atyre ekzistuese për t'u përgjigjur nevojave të rasteve.

Ndërgjegjësim i vazhdueshëm: një nga sfidat më të mëdha që hasin viktimat e dhunës me bazë gjinore është stigma sociale që rrethon këtë fenomen, e cila është shumë më e theksuar në zonat rurale. Për të adresuar këtë sfidë, është e nevojshme të zbatohen fushata të vazhdueshme ndërgjegjëse që synojnë edukimin e komunitetit dhe reduktimin e turpit dhe frikës nga kërkimi i ndihmës.

Përmirësimi i aksesit në shërbimet e specializuara përfshirë ato psikologjike: një nga barrierat e rëndësishme që është vënë re është mungesa e shërbimeve psikologjike dhe mbështetje pastraumatike për viktimat e dhunës me bazë gjinore. Për të adresuar këtë problem, është e domosdoshme të zhvillohen shërbime të specializuara

psikologjike që ofrojnë mbështetje mbi traumat e përjetuara. Shërbimet duhet të përfshijnë seanca këshillimi dhe mundësi rehabilitimi për të ndihmuar viktimat të kapërcejnë pasojat psikologjike të dhunës dhe të ndihmohen për të krijuar një jetë të re pas traumave.

Akses i përmirësuar në shërbime: në shumë zonat rurale, viktimat e dhunës hasin vështirësi të mëdha për të arritur në shërbimet e nevojshme për shkak të mungesës së infrastrukturës së transportit. Për të mundësuar akses të lehtë dhe të sigurt në shërbime, është e nevojshme të përmirësohet infrastruktura e transportit dhe mund të krijohen mundësi për mbështetje të drejtpërdrejtë, si transport falas për viktimat që kanë nevojë të udhëtojnë për të marrë shërbime.

Rritja e bashkëpunimit ndërmjet aktorëve të mekanizmave të koordinuar të referimit: një tjetër aspekt i rëndësishëm për përmirësimin e shërbimeve është forcimi i bashkëpunimit ndërmjet institucioneve lokale, shërbimeve sociale dhe organizatave joqeveritare. Kjo mund të kontribuojë në krijimin e një rrjeti mbështetjeje që mund të ofrojë shërbime të plota për viktimat e dhunës me bazë gjinore. Po ashtu, ky bashkëpunim mund të përfshijë organizimin e aktiviteteve të përbashkëta, trajnimeve dhe përmirësimin e procedurave të ndihmës për viktimat.

REFERENCAT

- Avokati i Popullit. (2022). Raporti Vjetor për Dhunën me Bazë Gjinore në Shqipëri. <https://www.avokatipopullit.gov.al> (parë më 12.04.2025).
- CEDAW. (1992). General Recommendation No. 19 on Violence against Women. <https://www.ohchr.org/en/treaty-bodies/cedaw/general-recommendations> (parë më 03.04.2025).
- European Institute for Gender Equality (EIGE). (2024). Gender-based violence in rural areas of Europe. <https://eige.europa.eu> (parë më 12.04.2025).
- Eurostat. (2024). "Statistics on gender-based violence in the EU", <https://ec.europa.eu/eurostat> (parë më 02.04.2025).
- Instituti i Statistikave, INSTAT. (2018) "Dhuna ndaj grave dhe vajzave në Shqipëri", <https://www.instat.gov.al/al/rreth-nesh/aktivitetet/promovimi-i-aktiviteteve-statistikore/dhuna-ndaj-grave-dhe-vajzave-n%C3%AB-shqip%C3%ABri-2018/>, (parë më 3.05.2025).

- Kuvendi i Shqipërisë, KSH. (2006). “Ligj Nr.9669, datë 18.12.2006, ‘Për masa ndaj dhunës në mharredhëniet familjare’”, <https://www.osce.org/files/f/documents/3/3/30437.pdf> (parë më 3.05.2025)
- Kuvendi i Shqipërisë, KSH. (2008). “Ligj Nr. 9970, datë 24.7.2008 ‘Për barazinë gjinore në shoqëri’”, <https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2021/05/7.pdf> (parë më 3.05.2025).
- Ministria e Brendshme. (2024). “Raporti vjetor”, <https://mb.gov.al/wp-content/uploads/2025/02/Raporti-Vjetor-2024-MB.pdf> (parë më 12.04.2025).
- Swedish International Development Cooperation Agency, Sida. (2015). “Women’s Economic Empowerment in Rural Areas: Challenges and Opportunities”, <https://www.sida.se/en> (parë më 02.04.2025).
- UN Women (2021) “*Ndikimi i COVID-19 në shërbimet për dhunën me bazë gjinore*”, Link: https://albania.unwomen.org/sites/default/files/2022-04/VAW%20RGA_Albania.pdf (parë më 12.04.2025).
- United Nations Population Fund, UNFPA. (2022). Humanitarian Thematic Fund Annual Report 2022, <https://www.unfpa.org/sites/default/files/pub-pdf/2022%20Humanitarian%20Thematic%20Fund%20Report.pdf> (parë më 03.04.2025).

ABSTRACT

Domestic violence and gender-based violence remains a serious problem in Albanian society. According to the National Survey on Violence against Women in Albania, conducted in 2018 (INSTAT), 1 in 2 women in Albania has experienced violence in her lifetime, while 1 in 3 women had experienced violence in the last 12 months. This article addresses the importance of providing integrated services for survivors of domestic and gender-based violence, as well as the challenges of providing these services in rural areas. The methodology used is qualitative, based on available secondary data such as studies, reports, legal frameworks and 11 semi-structured interviews with service providers for domestic violence cases at the Administrative Unit level. The main conclusions of the study are related to the lack of a complete package of services at the Administrative Unit level, the lack of specialized services for emergency and long-term support, insufficient infrastructure and long distances that limit access to help, social stigmatization, which hinders reporting and seeking help, lack of specialized training for workers managing cases of violence, etc. The results of the study emphasize the need for integrated interventions, including increased funding, improved infrastructure and capacity development of professionals involved in case management in order to ensure a more comprehensive and qualitative approach to victims of gender-based violence, especially in rural areas.

Keywords: *Gender-based violence, social services, rural areas, access to support, social stigma.*

QYTETARI NË USHTRIMIN PUBLIK TË ARSYES NË PËRMASËN KOZMOPOLITIKE

Ledian RUSTA
Universiteti i Tiranës
Fakulteti i Shkencave Sociale
E-mail: ledianrusta@gmail.com

PËRMBLEDHJE

Kjo ese merr në analizë konceptin e qytetarit në mendimin e Kantit, parë në perspektivën kozmopolitike dhe në atë të përdorimit publik të arsyes. Interesi publik përbën një parim themelor, pasi i jep kuptim thelbit të njeriut si ushtrues i lirë i arsyes në përmasën e moralit universal. Në këtë optikë, individit si qytetar konceptohet në mënyrë të veçantë në përmasën kozmopolitike, si qytetar i botës që ndihet përgjegjës për veprimet e tij në mënyrë universale. Në këtë kontekst, në natyrën njerëzore përvijohet një qëllim teleologjik dhe një histori universale ku individët priren drejt progresit dhe së mirës. Për të mundur këtë të fundit, duhet të njohim si të domosdoshme një të drejtë të veçantë (e drejta kozmopolitike), një formë qeverisjeje (republika) dhe një organizim ndërshtetesh, me qëllim final paqen e përhershme. Pra, thelbi i vërtetë i qytetarit në përmasën e tij universale si qytetar i botës nuk mund të realizojë qëllimin e një paqeje të përhershme nëse nuk mbështetet në një moral universal dhe në një të drejtë kozmopolitike të pakushtëzuar si aleancë shtetesh të lira në shkallë botërore. **Fjalë kyçe:** përdorim publik i arsyes, interesi publik, moral, paqe, kozmopolitik, qytetari.

Dr. Ledian RUSTA është lektor në Departamentin e Filozofisë, në Fakulteti i Shkencave Sociale, Universiteti i Tiranës. Ai ka marrë pjesë në shumë konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare dhe ka botuar artikuj shkencorë në revista kombëtare dhe ndërkombëtare me faktor impakti. Fushat e tij të interesit janë filozofia, komunikimi, logjika. Është autor i monografisë “Kështu foli Nietzsche”.

Kuptimi i përdorimit publik të arsyes dhe interesi publik

Për Iluminizmin, aftësia e të arsyetuarit përbën një aftësi të përbashkët për të gjithë njerëzit ku normat e tij janë universale. Për

filozofët e Iluminizmit, ideja e arsyes është e lidhur pazgjidhshmërisht me publin, me interesin publik dhe argumentin publik. Si rrjedhim, arsyeja është në njëfarë kuptimi, domosdoshmërisht publike. Sipas Kantit, progresi i iluminizmit varet nga liria e

përdorimit publik të arsyes për të gjitha çështjet që shtrohen. Por në çfarë kuptimi, sipas Kantit, arsyeja është publike? “Me përdorim publik të arsyes kuptoj vetë përdorimin që dikush kryen, sikundër studiuesi përpara një publiku të tërë lexuesish” (Kant, 1987: 21). Sipas tij, arsyeja është publike në kuptimin se ajo nuk njihet autoritet tjetër më të mirë veçse argumentin e arsyeshëm dhe lirinë për tu ushtruar pa shtrëngesa. Kështu, sfera publike shihet si një sferë e diskursit kriti, ku pushteti dhe legjitimiteti i nënshtrohen gjyqit të arsyes. Për Kantin, në të vërtetë, arsyeja është publike për nga vetë thelbi pasi është universale dhe shprehet publikisht në mënyrë që të ajo të gjykohej. Në këtë aspekt, publiku nuk përbën vetëm një plate dëgjuesish por mundëson dialogun që nënkupton kritikën dhe shkëmbimin ashtu siç lipset edhe nga këndvështrimi iluminist. Pra ushtrimi publik i arsyes konceptohet si një veprimtari kolektive e bashkëndarë mes qytetarëve dhe si një terren i marrëveshjes mes tyre. Në sferën publike, ushtrimi i arsyes nuk është vetmitare dhe vetadresuese (në vetvete) por dialogjike, një diskutim mes qytetarëve. Megjithatë në mendimin kantian, publiku nuk nënkuptonte publikun e shoqërisë masive që do të shfaqej më vonë, në fund të modernitetit. Publiku, sipas tij, përbën një plate të kualifikuar e të ndriçuar lexuesish që jetojnë në një marrëdhënie reciproke sepse bashkëndajnë arsyen universale dhe fatin e përbashkët në progresin drejt së mirës. Në fakt, këtu qëndron edhe frymëzimi kozmopolitik i Kantit si një veprimtari e përbashkët dhe e bashkëndarë. Prandaj vepra e tij, *Kritika e gjykimit*, është e rëndësishme për të ndriçuar kuptimin e kësaj veprimtarie. Lidhur me konceptin e *sensus communis*, Kant shprehet se ai përfaqëson

idenë e një kuptimi që kemi si të përbashkët, pra e një aftësie për të gjykuar që në përsiatjen e saj mban parasysh a priori mënyrën e përfaqësimit të të gjithë të tjerëve, për të ruajtur në një mënyrë të caktuar vetë gjykimin

në kufijtë e arsyes njerëzore në tërësinë e saj (Kant, 1967: 150).

Mirëpo, përdorimi publik i arsyes nuk mund të kuptohet pa përfshirjen e parimit të interesit publik të qytetarit. Sipas Kantit, ky interes paraqitet si parimi i veprimit social dhe politik duke ngërthyer harmoninë mes moralitetit dhe politikës. Politika mund të shndërrohet në moralitet vetëm përmes një theksi të fortë të interesit publik. Në konceptimin e drejtësisë, lidhja mes arsyes dhe interesit publik përbën diçka thelbësore pasi interesi publik është prova që ligji duhet të kalojë për të qenë në përputhje me parimin e drejtësisë. Si rrjedhim, për Kantin, përdorimi publik i arsyes lidhet jo vetëm me pavarësinë individuale, por edhe me legjitimitetin politik. Për t'u legjitimuar, ligji duhet të kalojë provën e shqyrtimit publik duke garantuar kështu se shtrëngimet e tij janë të përligjura për të gjithë qytetarët. Për Kantin, ky parim i interesit publik përbën pikën nga ku duhet të kalojnë të gjitha teoritë e përligjjes publike të legjitimitetit politik, ku qytetarët diskutojnë lirisht duke vënë në praktikë edhe lirinë e shprehjes në publik. Pra, në thelb, arsyeja nënkupton “*të mendosh me të tjerët*”, të komunikosh duke lidhur arsyen kritike vetjake me të kuptuarit e botës dhe të realitetit, në një kolektivitet qytetarësh. Si rrjedhojë, interesi publik nuk përbën vetëm një kusht për maturinë e qytetarit, por edhe një kusht për zhvillimin e shoqërisë, të cilin Kanti e ndërlidh me kushtin për progresin njerëzor dhe të drejtat universal të qytetarëve.

Çfarë është njeriu si kusht kozmopolitik?

Përpara se të përcaktojmë kushtin e njeriut në përmasën kozmopolitike, në thelb mbetet një pyetje edhe më themelore: çfarë është njeriu? Po t'i drejtohem mendimit të Arendt do të pranim se në mendimin e Kantit mund të dallojmë tri llojeve të ndryshme të konceptimit të njeriut: “njeriun

si qëllim në vetvete, si racë njerëzore dhe si njerëz, në kuptimin shumë” (Arendt, 1990: 45). Megjithatë, është vetë termi “kozmopolitik” që i përmbledh të tre këto kuptime. Kështu, shtrimi i pyetjes rreth thelbit të njeriut në një perspektivë kozmopolitike përbën problemin e themelimit të një komuniteti politik tek një moral dhe e drejtë universale. Por kur Kanti flet për këto të fundit u drejtohet saktësisht atyre normave universale natyrore që përbëjnë një trashëgimi të domosdoshme dhe të patjetërsueshme të njerëzimit. Sipas tij, është e pamundur ta konceptosh politikën si një shkencë autonome nëse nuk shkon krah për krah me aspektin moral. Më konkretisht, për Kantin, e drejta e qytetarisë përvijohet përmes ligjit të një shteti që në mënyrë kontraktuale është zgjedhur nga njerëzit, e si pasojë nuk mund ta largojmë përmes forcës. Në të kundërt, individit do të humbiste kushtin e tij të qytetarisë dhe do të shndërrohej në një send (objekt që zotërohet).

Nga ana tjetër, për të qartësuar më mirë këtë situatë, Kanti bën dallimin mes qytetarit aktiv dhe atij pasiv. Sipas tij, qytetarit aktiv nuk i mjafton të qenit pjesë apo subjekt i një kontrate, pasi ai duhet të gëzojë edhe cilësitë që bëjnë të mundur lirinë dhe marrëdhëniet në të. Në kuptimin e të drejtës, kjo ndarje prodhon një dallim mes të drejtave të njeriut (liria natyrore dhe barazia) dhe të drejtave të qytetarit (konstitucioni ligjor).

Ndërkohë, një aspekt tjetër që shpaloset për të kuptuar këtë ndarje lidhet me dallimin që prodhon natyrshëm ideja rreth komunitetit politik. Sipas Kantit, ky i fundit brendashkruhet në atë të sistemit të shteteve dhe jo të shtetit. Kjo është arsyeja se përse qytetari nuk përbën thjesht një individ si subjekt i ligjit apo i së drejtës. Ai përbën kryesisht një individ që njihet dhe që duhet ta zhvillojë aktivitetin e tij në një pluralitet rendesh juridike dhe në një rend në shkallë botërore (rend kozmopolit).

Më tej, në një plan edhe më të përgjithshëm, Kanti kryen një dallim më

të hollësishëm për përcaktimin e kushtit kozmopolitik të qytetarit. Ai e përcakton “qytetarin e botës” jo si të njëlojtë me atë të “birit të tokës”. Pra,

në bazë të interesit që kihet për atë që është më e rëndësishme në botë mund të pranohen dy këndvështrime: këndvështrimi i birit të tokës dhe ai i qytetarit të botës. Të parit i interesojnë vetëm çështjet dhe ato që ndikojnë në mirëqenien tonë. Të dytit i intereson njerëzimi, e tërë bota, gjeneza e gjërave, vlera e tyre e brendshme, qëllimet finale... . Këndvështrimi i birit të tokës na drejton për nga detyrat tona më të përditshme... varet nga njerëzit dhe gjërat dhe është i burgosuri i tyre... . Qytetari i botës duhet ta konsiderojë veten kundrejt botës si banor të saj, e jo si i një huaj. Nuk duhet të jemi spektatorë, por qytetarë të botës (Kant, 1985: 13).

Pra, të qenit qytetar i botës nuk nënkupton apo varet nga një gatishmëri natyrore thjesht fizike që lëviz nëpër botë si shëtitës apo turist. Qytetari kozmopolitik e cilëson botën si një vend të tijin ndaj të cilit nuk është i huaj. Të qenit një qytetar i tillë do të thotë të shfaqësh interes për gjetjen e një kuptimi në histori që mund të udhëheq të tërë njerëzimin dhe kolektivitetin e qytetarëve në botë. Për këtë arsye, nuk mjafton thjesht të qenit pasiv apo spektator: këndvështrimi i qytetarit të botës nuk përbën thjesht një vëzhgim të botës nga jashtë, por rrënjëzohet në përmasën publike dhe ndërsujektive e cila është e nevojshme për të drejtuar, kuptuar dhe gjykuar të vepruarit njerëzor.

Nga ana tjetër, ky qëndrim i Kantit dallon prerazi nga mendimet e filozofëve të mëparshëm. Sipas tij,

filozofia e vjetër i caktoi njeriut një vend tërësisht të gabuar në botë, duke e konceptuar atë si makinë që, përsa i tillë, duhej thjesht të ishte tërësisht i varur nga bota apo nga gjërat e jashtme; ajo filozofi e bënte, pra, njeriun vetëm një pjesë pasive të botës... njeriu është

gjeneza e të gjitha paraqitjeve dhe koncepteve të tij e duhet të jetë autori i vetëm i të gjitha veprimeve të tij (Kant, 1989: 277).

Si rrjedhim, qytetari i botës nuk nënkupton njeriun racional në përgjithësi, por pikërisht njeriun racional si individ të lirë dhe si aktor veprues në botë. Si i tillë, ai zotëron një vullnet konkret që nënkupton një botë të kuptimtë. Me këtë, Kanti kërkon të tregojë se njeriu (jo natyra apo Zoti) është autori dhe përgjegjësi i historisë së tij, ku parimi dhe qëllimi i veprimit të tij në botë është liria. Për këtë arsye, duke theksuar veprimin njerëzor në thelb të tij, Kanti e përcakton antropologjinë si pragmatike. Në qendër të kësaj të fundit vendoset njeriu si qytetar i botës. Ajo e trajton njeriun si një entitet që në lirinë e tij mbart ligjin e një morali universal. Pra, të qenit qytetar i botës do të thotë, siç shprehet Foucault, “t’i përkasësh një hapësirë që është konkrete si tërësia e rregullave juridike dhe universale si ligj moral” (Foucault, 1996: 27-28).

Roli i qytetarit në historinë universale

Në veprën *Antropologjia pragmatike*, Kanti theksonte se “njeriu duhet kuptuar “kozmozologjikisht”, pra, në marrëdhënie me atë që gjendet dhe vendin që zë” (Kant, 1985:20), duke shtruar kështu marrëdhënien e njeriut me vetë historinë e tij. Ndërkohë, tek vepra *Ideja e një historie universale me një qëllim kozmopolitik*, ai shtron idenë “nëse ekziston” dhe “si mund të bëhet” e mundur një histori universale. Sipas tij, kjo histori universale dhe qytetari i botës bëhen të mundur nëse shihen jo nga këndvështrimi i subjektit, por duke iu drejtuar një perspektive të veçantë këndvështrimi: këndvështrimi universal që duhet të arrijë lloji njerëzor. Për këtë arsye, vetëm filozofia e historisë dhe jo thjesht historia mund të përshfaq qytetarin nga një këndvështrim kozmopolitik e universal. Për këtë qëllim, filozofia i drejtohet “parimit të finalitetit” që Kanti e analizon në mënyrë të

veçantë tek vepra e tij *Kritika e gjykimnit*. Për të, një sistem i historisë duhet të karakterizohet nga një unitet kolektiv në kuptimin cilësor. Pra, ajo që e përcakton një histori universale është thelbi i kolektivitetit si qytetar i lirë i një entiteti kolektiv cilësor dhe jo thjesht si numër. “Në çdo njohje të një objekti ekziston një unitet i konceptit, përse në të mendohet vetëm uniteti i të kuptuarit të të shumëllojshmes së njohjes” (Kant, 1989: 155). Me këtë nënkuptohet se shpalosja e idesë së të drejtës në historinë e veprimeve njerëzore si pjesë e një shoqërie kozmopolitike mund të kuptohet vetëm përmes një qëllimi final universal të historisë: përmbushjes së fatit të llojit njerëzor. Megjithatë, në këtë drejtim, individët nuk sillen si qytetarë racionalë të botës (sipas një plani të paracaktuar) por as në tërësinë e tyre, thjesht instinktivisht. Si rrjedhojë, Kanti pranon se nevojitet të hamendësojmë se “natyra nuk sillet pa një plan, pa një qëllim final edhe në lojën e lirisë njerëzore” (Kant, 1989: 29). Pra, duhet zbuluar se cili është ky qëllim final i natyrës edhe pse jemi në një horizont të veçantë e të papërcaktuar: atë të lirisë njerëzore. Lidhur me këtë të fundit, qëllimi final është ai i hamendësimit se historia njerëzore ecën përmes një progresi, drejt lirisë përherë e më të madhe të qytetarëve. Mirëpo si shkallë e vlerësimit të progresit nuk mund të shërbejë zhvillimi i shkencave apo i teknikës, pasi duhet gjetur një pikë që të jetë e vazhdueshme (jo rastësore) dhe që të mund t’u përkasë të gjithë qytetarëve. Por asnjë masë e jashtme nuk e plotëson këtë kërkesë ku për të përcaktuar progresin lipset të jetë si masë vetë njeriu. Në këtë aspekt, Kanti e përcakton historinë e njerëzimit si histori të procesit gradual të llojit njerëzor, në tërësi, drejt fatit të tij, duke theksuar si shumë të rëndësishme përmasën e të ardhmes. Kjo e fundit bën të mundur matjen e këtij progresi duke vështruar faktin se si duhet të realizohet dhe shpaloset njerëzimi. Është historia nga një këndvështrim kozmopolitik që përbën historinë në perspektivën e progresit të të

tërë llojit njerëzor drejt fatit të tij të cilën Kanti e cilëson si “*fati kozmopolitik apo moral*”. Megjithatë, përpara se të kuptohet ky këndvështrim, ai kërkon të kryejë një dallim qartësues mes llojit njerëzor të kuptuar

si një tërësi, pra, si një tërësi kolektive (universorum) dhe llojit njerëzor të konceptuar si shumësi, entitet i një bashkimi individësh (singulorum) ku këta të fundit nuk përbëjnë një sistem, por vetëm një grumbull individësh (Kant, 1985: 223).

Kështu, për Kantin, uniteti kolektiv i llojit njerëzor nuk ka të bëjë fare me një aspekt biologjik, empirik e as logjik. Ai gëzon një strukturë teleologjike që shpaloset përmes raportit të pjesëve dhe të së tërës, ku kjo e fundit shfaq një përparësi pasi përfaqëson edhe një parim. Pra, uniteti kolektiv përfaqëson një unitet qytetarësh në një përmasë kualitative.

Por pyetja që shtrohet në këtë mes është: në çfarë mënyre, shumësia e qytetarëve, mund të përbëjë një unitet? Në lidhje me individin është vetëm moraliteti, pra vetëdija e vetvetes e pavarur nga kushtëzimet e kohës dhe hapësirës. Pra, vetëm përmes moralitetit mund të flasim për një unitet qytetarësh apo individësh të lirë të llojit njerëzor. Kanti shkruan se lloji njerëzor përbën një shumësi personash që gjenden pranë njëri-tjetrit dhe që ndjejnë se janë

të destinuar të ndërtojnë, përmes bashkëveprimit reciprok nëpërmjet ligjeve të krijuara nga ata vetë, por në tërësi progresiv drejt një shoqërie kozmopolite (cosmopolitismus), e cila, si ide në vetvete e paarritshme, nuk përbën një parim ndërtues... por vetëm një parim rregullues të nevojës për të vijuar drejt saj, si destinim i species njerëzore, e përligjur nga një prirje natyrore në një kuptim të tillë (Kant, 1985: 226).

Kjo do të thotë se pranimi i lirë i një parimi final, ai që ndërton shoqërinë kozmopolitike, shndërron një shumësi individësh në një të tërë, pikërisht në atë të llojit njerëzor ku zhvillohen aftësitë e tij. Pra, një rend i përgjithshëm kozmopolitik “*si kusht i vetëm në të cilin natyra mund të zhvillojë tërësisht tek njerëzimi gatishmëritë e saj*” (Kant, 1995: 39), jo si një entitet i dhënë, por vetëm si një ide për t’u realizuar shkallë-shkallë.

Forma “*e dubur*” e regjimit dhe e drejta kozmopolitike

Në një nivel etik të së drejtës, Kanti shpalos idenë e një qytetari të botës drejt qëllimit të realizimit të së mirës, por në nivel ligjor lipset që kjo të realizohet apo strehohet në një formë të veçantë qeverisjeje. Mes shumë formave të ndryshme regjimesh, Kanti strehohet natyrshëm tek forma e republikanizmit. Kjo e fundit përbën premisat morale për qytetarin si një individ të lirë dhe të barabartë me të ngjashmit e tij. Këtë aspekt, Kanti e thekson në artikullin e parë të Paqes së përhershme, duke pohuar se: “konstitucioni civil i çdo shteti duhet të jetë republikan” (Kant, 1995: 169). Sipas tij, ky konstitucion themelohet mbi parimet e lirisë së qytetarëve, të varësisë së barabartë ndaj ligjit (shprehja e vullnetit publik) dhe të barazisë juridike, duke qenë “konstitucioni i vetëm që rrjedh nga ideja e kontratës fillestare, mbi të cilën duhet të themelohet çdo legjislacion juridikisht i vlefshëm i një populli” (Kant, 1995: 13). Kështu, forma e republikanizmit bëhet garancia praktike e realizimit të lirisë duke u parë më tej edhe si kusht i realizimit të një federate mes shteteve, për të mundësuar realizimin e aspektit kozmopolitik. Por në përpjekje për të realizuar këtë të fundit, në perspektivën e së drejtës, është i rëndësishëm përcaktimi i dallimit mes të drejtës kozmopolitike dhe konstitucionit kozmopolitik. Përmes të parës, Kanti tematizon, mes të tjerash, idenë e një “*opinionit publik*” në shkallë botërore roli i

të cilit shpaloset nga filozofi dhe jo nga një projekt institucional si garanci për drejtësinë në nivel ndërkombëtar. E dyta shihet si moment i së drejtës publike duke pranuar se çdo individ gëzon statusin juridik të qytetarit të botës në mënyrë të pavarur nga qytetaria, si anëtar i një shteti të caktuar. Pra, konstitucioni politik është, në fund të fundit, konstitucioni i një “*shteti*” universal njerëzish nga i cili duhet të frymëzohet politika ndërkombëtare e shteteve.

Nga ana tjetër, thelbi i lirive dhe i të drejtave të njeriut bëhet i mundur vetëm nëse individët trajtohen si të ishën qytetarë të botës dhe jo thjesht si qytetarë që i përkasin një shteti të caktuar. Në kuptimin e së drejtës ndërkombëtare, kozmopolitizmi mund të themelohet në një federatë shtetesh të lira edhe pse republikanizmi si formë qeverisjeje nuk mjafton. Ky i fundit përbën një kusht të domosdoshëm pasi aty shpaloset liria e qytetarëve si të barabartë, por nuk është i të mjaftueshëm për të vendosur një paqe të përhershme. Nevojitet, pra, që këto shtete republikane t’i japin jetë një federate ku mund të garantohet e drejta e çdo qytetari ku “kushti i fundit është, pra, paqja e përhershme, e siguruar nga një federatë botërore” (Kant, 1995: 26-27). Por edhe pse Kanti nuk ka shpalosur një skicim të saktë të natyrës së kësaj konfederate shtetesh, ai thekson se kjo e fundit duhet të dallohet nga trajtat e një mbi-shteti i cili nuk përfshin barazinë mes shteteve ku si parakusht dhe themel duhet të

gëzojë një parim të thellë antropologjik. “E drejta kozmopolitike duhet të kufizohet nga kushtet e një mikpritjeje universale” (Kant, 1995: 169) ku çdo qytetar i botës respekton çdo qytetar tjetër në këtë konfederatë politike. Në një shoqëri kozmopolitike, realizimi moral i njeriut ka për subjekt jo një individ të veçantë, por qytetarin e botës në kushtet e një mikpritjeje universale.

Përfundime

Njeriu i konceptuar si qytetar në përmasën kozmopolitike, por edhe si ushtrues i arsyes publike, përbën një entitet shumë të veçantë. Të dyja këto situata janë të ndërlidhura për të bërë të mundur realizimin e një finaliteti të së mirës njerëzore në botë: atë të paqes së përhershme. Në këtë mënyrë, ideja e qytetarit duhet menduar radikalisht në një përmasë universale që mbështetet nga disa parime e struktura të tilla. Të gjitha këto parime bëjnë të mundur përcaktimin e këtij kushti. Si rrjedhojë, për Kantin, një moral i mbështetur në parime universale dhe i shtrirë në të tërë kufijtë e botës (jo brenda një shteti), një histori universale me individin si qytetar të botës, një formë e caktuar qeverisëse (republika), një e drejtë në përmasa kozmopolitike, një organizim mes shteteve (federatë e shteteve) dhe një shoqëri civile e përsosur shihen si elementë të domosdoshëm për realizimin e qëllimit final të së mirës në botë: atë të paqes së përhershme.

REFERENCAT

- Foucault, Archivio. (1996). *Interventi, colloqui, interviste: Volume I. 1961-1970*, Milano: Feltrinelli.
- Arendt, H. (1990). *Teoria del giudizio politico*. Genova: Il Melangolo.
- Kant, I. (1967). *Critica del giudizio*. Roma-Bari: Laterza.
- Kant, I. (1985). *Antropologia pragmatica*. Roma-Bari: Laterza.
- Kant, I. (1985). *Antropologia pragmatica*. Roma-

- Bari: Laterza.
- Kant, I. (1987). *Che cos'è l'illuminismo?*. Roma: Editori Riuniti.
- Kant, I. (1989). *La critica della ragion pura*. Milano: Bompiani.
- Kant, I. (1989). *Scritti di filosofia della religione*. Milano: Mursia.
- Kant, I. (1995). *Scritti di storia, politica e diritto*. Roma-Bari: Laterza.

ABSTRACT

The paper analyzes the concept of citizen in Kant's thoughts in the perspective of the cosmopolitical and in the public use of reason. The public interest is a fundamental principle, since it gives meaning to the essence of the man as it exerts freely the reason in the dimension of a universal morality. In this optic, the individual as a citizen is especially designed in a cosmopolitical dimension, as a citizen of the world who feels responsible for his acts universally. In this context, a teleological purpose and a universal history are outlined in human nature where individuals tend towards progress and goodness. To make possible this last point, we must recognize as necessary a particular right (cosmopolitical right), a form of government (republic) and interstate organization, with the ultimate principle of perpetual peace. So the very essence of the citizen in its universal dimension as a citizen of the world cannot achieve the purpose of perpetual peace, until it rests on a universal morality and an unconditional cosmopolitical right as a Free State alliance in the worldwide scale.

Key words: *Public use of reason, public interest, morality, peace, cosmopolitical, citizen.*

MËNYRAT E REJA TË NJOHJES NËPËRMJET INTERNETIT DHE VLERAT HUMANE E DEMOKRATIKE SI FILTRA PEDAGOGJIKË

Adriana ANXHAKU
Universiteti i Tiranës
Fakulteti i Shkencave Sociale
Departamenti i Filozofisë
E-mail: adriana.anxh@gmail.com

Klara SULA
Universiteti i Tiranës
Fakulteti i Shkencave Sociale
Departamenti i Filozofisë
(Doktorante)
E-mail: klaraisallari@gmail.com

PËRMBLEDHJE

Teknologjia dhe sidomos interneti kanë krijuar një marrëdhënie të re me botën ku jetojmë duke bërë që autoritet e vjetra edukuese, përfshirë dhe prindërit, si dhe mënyrat e vjetra të mësimdhënies t'i nënshtrohen një rishikimi të thellë. Kjo ndodh sepse nxënësit dhe studentët janë përshtatur mirë me këto procese, aq sa një filozof si Michel Serres i quan "gishtëmollëza" (Thumbelina). Por nuk ka ndryshuar vetëm mënyra sesi i përdorin mollëzat e gishtave të rinjtë. Kanë ndryshuar mundësitë e tyre për të naviguar në rrjet, për të lidhur miqësi me njerëz shumë larg, kanë ndryshuar mënyrat se si komunikojnë, por edhe se si mendojnë. Përshtatja e të rriturve që i edukojnë ata dhe përpjekja për t'u përfshirë në botën e tyre nuk kërkon vetëm një nivel të caktuar njohurish teknologjike nga ana e edukuesve, por edhe një grup njohurish se si duhen orientuar këta të rinj në marrëdhënien e tyre me internetin, pra një lloj pedagogjie e re. Në këtë punim do të përmenden jo thjeshtë disa metoda pedagogjike, por disa mënyra filozofiko-pedagogjike për të mos humbur ndërveprimin edukues me botën. Procesi i edukimit i përshtatet mënyrave të reja të njohjes që të rinjtë kanë në dispozicion dhe mënyrave sesi ata mendojnë mbi botën. Kjo ka të bëjë

me një ndërveprim plot respekt për këto qenie të reja njerëzore që po rriten. Disa kategori mendimi që burojnë nga filozofia i ndihmojnë ata për të përzgjedhur në vartësi të jetës që bëjnë në shoqëri e shkollë, pa relativuar disa vlera humane e demokratike të përbashkëta, aq të rëndësishme për mirëqenien e tyre dhe të vetë shoqërisë.

Fjalë kyçe: *Teknologjia, internet, edukim, ndërveprim, vlera*

Prof. Dr. **Adriana ANXHAKU** ka kryer studimet në Fakultetin e shkencave Politiko Juridike, Dega Filozofi në Universitetin e Tiranës, në vitet 1984-1988. Në vitin 2007 ka fituar gradën shkencore “Doktor” në filozofi. Ndërsa në vitin 2015 ajo ka fituar titullin shkencor “Profesor i Asociuar” dhe në vitin 2022 titullin shkencor “Profesor”, gjithnjë nga Universiteti i Tiranës. Ka botuar mbi 30 artikuj shkencor në revista brenda e jashtë Shqipërisë, si dhe ka marrë pjesë në rreth 20 konferenca shkencore. Ajo është autore e monografive “E drejta dhe shoqëria” (2022) dhe “Arsyeja ndërmjet mitit dhe iluminizmit. Shkolla e Frankfurtit” (2015), sikurse autore e disa teksteve shkollore e universitare të fushës së filozofisë.

Klara SULA ka kryer studimet Bachelor dhe Master Shkencor në Departamentin e Filozofisë, në Fakultetin e Shkencave Sociale, Universiteti i Tiranës. Aktualisht ajo është në ciklin e tretë të studimeve të doktoratës në të njëjtin departament. Nga viti 2014 e në vijim, është angazhuar si asistente pedagoge (e jashtme) në Departamentin e Filozofisë.

Hyrije dhe metoda

Metoda kryesore është një analizë e fakteve dhe përvojës së përditshme me të rinjtë duke shpjeguar e kuptuar disa qëndrime të reja të njohjes. Postmodernizmi na tregon nëpërmjet Lyatrd se çfarë duhet të bëjë një edukues që natyrshëm nuk di gjithçka. Ai orienton, tregon rrugët te dijes duke treguar se ku dija është e sigurtë dhe ku ajo duhet përmirësuar. Kjo metodë analitike, ka brenda vetes dhe një interpretim të disa të dhënave empirike që lidhen me koncepte psiko-pedagogjike si vëmendje, e vërteta, imagjinata, mundësi të mira e të këqija. Vlera shërbejnë si një grup gjykimesh të përbashkëta që në epiqendër kanë: t’i shërbejnë njerëzve për të shkuar bashkë mirë. Mbi kite bazë ato ju përcillen të rinjve si kulturë, si traditë, si përvojë e mirë që parandalon fatkeqësi e konflikte. Dikush mendon se vlerat janë të ndryshme, filozofia në disa autorë shpreh se një grup vlerash që përvijojnë identitetin tonë janë të përbashkëta, ndonëse ne kemi dhe vlera të ndryshme. Pra në artikull do iu referohemi disa vlerave të përbashkëta pa humbur nga sytë mundësinë që çdo i ri ose e re mund te ketë një korpus vlerash të veçanta që

duhen respektuar. Nga ana tjetër na duhet të mbajmë parasysh sa e rëndësishme është mënyra jonë e njohjes për jetën. Për kite po bazohemi te një ide e Edgar Morin i cili shkruan se: “të gjitha gjurmët kulturore të lëna që prej lindjes, më pas në shkollë e në jetën sociale, përcaktojnë te individët, parimet e tyre të njohjes dhe vizionet e tyre për botën” (Morin, 2016: 197).

Vetë mediat përshkruajnë vlera të caktuara, të cilat mund të bien ndesh me sistemet tradicionale të vlerave dhe të besimit. “Pasqyrimet e mediave të tilla nuk janë asnjëherë, ato komunikojnë vlera dhe besime” (Christian, 2022: 156). Ndonjëherë këto vlera mund të jenë në fakt antivlera për një të ri që ka një besueshmëri të lartë ndaj tyre. Në artikull kemi ndjekur mënyrën e shtrimit të problemit dhe dhënies së një ose disa rrugëdaljeve prej tij në vartësi të disa situatave që sjellin mënyrat e reja të njohjes në internet.

Bota reale dhe bota virtuale kufij dhe shtrirje

Pyetjes se filozofiko antropologjike kush jemi ne si njerëz të rinjtë, por edhe të rriturit edukues në përshtatje me to nuk i

përgjigjen më me rrënjët e familjes, por me ato të një identiteti të ri, që përfshin edhe rrethin e shokëve dhe miqve në mediat sociale. Por në mediat sociale mund të ketë gjithmonë njerëz që na kritikojnë ose më keq akoma na bulëzojnë. Mësimi estetiko-filozofik është se: E bukura dhe e shëmtuara janë deri diku subjektive. Pra njerëz të ndryshëm mendojnë ndryshe për këtë gjë. Dukja e një njeriu nuk tregon me doemos thelbin (shpirtin) e tij dhe mendjen e bukur që mund të ketë. Dukja e diçkaje si e mirë ose e bukur (kategori mendimi filozofik estetik dhe moral) nuk e bën atë një vlerë të vërtetë pasi dukja mund të fshehë një cilësi ose karakter të rrejshëm dhe në thelb të ligë, të keqe. Shkrimtari dhe filozofi Umberto Eco e përshkruan kështu këtë proces:

Këta fëmijë që rriten jetojnë në një botë ku virtyti parësor (tashmë më i rëndësishëm se seksi e para) është dukja. Ku për t'u rënë në sy të tjerëve dhe për të mos vegjetuar në një anonimat të frikshëm e të padurueshëm, s'do të lejnë gur pa lëvizur për t'u dukur diku. Mediat sociale e përmbushin katërcipërisht këtë nevojë (Eco, 2017: 29).

Mundësi të shumta për të zgjedhur nuk do të thonë se dimë të përzgjedhim

Në fakt është çoroditëse mënyra sesi ofrohet informacioni në internet dhe nuk ka një sistematikë të njohjes, ose një organizim të saj, përveç koncepteve kyçe që kemi marrë.. Në mungesë të një udhëzimi nga edukatori, shpesh mundësitë që luhen ose përzgjidhen mund të jenë rastësore dhe të paverifikuara. Fakti që ne zgjedhim në jetë lidhet si me përvojat e njohjet tona të mëparshme ashtu dhe me botën e jetës ose kulturën ku jemi rritur. Aq më tepër që algoritmet e ndryshme fillojnë e përllogarisin dhe na ofrojnë zgjidhje të afërta ose përpiqen të na ofrojnë produkte të njëjta me ato që kemi zgjedhur më parë. Nuk përjashtohet edhe leximi i bindjeve politike sipas dëshmimeve që janë zbuluar më

vonë. Kjo gjë e kufizon mënyrën e zgjedhjes së të rinjve që kanë iluzionin që po zgjedhin vetë, por në fakt nuk është kështu. Pa folur për zgjedhjet e gabuara ose që çojnë në qorrsokak ekonomik, moral e ligjor. Edukatori, mësuesi mund të ndjekin disa zgjedhje mundësish që bëjnë të rinjtë dhe t'i informojnë për këto rrezeqe. Domosdoshmëria e përdorimit të internetit duhet të shoqërohet me treguesit e vlerave të së vërtetës, të së mirës morale në marrëdhënie me njeriun dhe paralajmërimin se jo çdo mundësi që paraqitet aty është ashtu siç duket.

Çasti i jetës dhe pafundësia

Informacioni i shumtë i hedhur në web kërkon shumë jetë për t'u njohur dhe është i pafund. Por jeta e njeriut është e kufizuar në hapësirë dhe kohë. përvoja e seleksionimit të përdorimit të internetit si mjet dhe jo si një botë jete duhet të ndajë se çfarë po bën i riu ose e reja me jetën e tij. Edukatorët por edhe shteti marrin shpesh rolin e ndërgjegjësimit për kohën që po kalohet në web ndonjëherë thjeshtë si vartësi ose ritual thashethemesh pa marrë parasysh pjesët e tjera të jetës si marrëdhëniet reale me njerëzit, përgjegjësitë, apo oraret e zakonshme të ritmeve të jetës ku përfshihen edhe pushimet e çlodhja. Për shembull, mundet që Ministria e Arsimit dhe e Sporteve të bëjë një mesazh ndërgjegjësimi për kohën që të rinjtë kalojnë në internet, me anën e mediave të ndryshme si televizionet kombëtare etj.

Vlerat morale të respektit për njerëzit e tjerë dhe për qeniet e tjera të gjalla e tokën me burimet e saj

Mund të përcillen nga edukatorët dhe mund të futen filtra etikë për moshën e përdorimit të disa faqeve por edhe të disa lloje mesazhesh të rrezikshme. Kjo mund të bëhet edhe me ligj edhe teknikisht është e mundur, por edhe nga edukatorët. Të shikosh mizori në internet, duhet të ketë

filtra si në mediat e tjera, ose edukatori mund të nxisë e mbështesë vlerat të tilla në shkollë ose në familje.

E bukura dhe e shëmtuara janë perceptime mjaft subjektive

Mospërputhja e mendimeve për çfarë konsiderohet e bukur ose e shëmtuar estetikisht lë hapësirë për të nxitur tolerimin e të menduarit ndryshe, por edhe për të pranuar se njerëzit mund të jenë të ndryshëm dhe nuk ka arsye për t'u imponuar njëri-tjetrit as për shijet as për idetë. Habermasi thotë se “forcën” në këto diskurse e merr argumenti më i mirë dhe bindja e jo dhuna verbale ose më keq fizike” Asnjëri nuk ka një vështrim më superior se të tjerët për jetën. Milli thotë se dikujt i pëlqejnë barcaletat, dikujt i pëlqejnë poezitë. Secilit i lejohej të ketë mënyrën e vet të vlerësimit se çfarë quan të mirë në jetën e tij. Natyrisht që kënaqësitë konsumiste kur tejkalojnë çdo masë krijojnë vartësi që nuk jep as kënaqësi as lumturi. Njeriu ka nevojë për të përdorur mendjen e trupin e tij. Pra edhe paratë e shumta nuk sjellin lumturi, përkundrazi mund të kthehen në dëshpërim.

Gishtmollëzat nuk dinë të abstragojnë siç duhet

Serres ankohet se Gishtmollëzat nuk dinë të abstragojnë siç duhet, sepse ata janë në gjendje të të japin shembuj por jo konceptin e përgjithshëm. Përcaktimi i koncepteve është një pikë e dobët e tyre. Ja si e përshkruan kite përvojë Serres:

E çfarë të thuash kur është puna që të përcaktojnë një koncept? Më thuaj, i them, se çfarë është bukuria? Gishtmollëza më thotë : Në grua e bukur, një kërcim i bukur, një perëndim i bukur i Diellit... Ndal! Pse kur të pyes për një koncept më jep një milion shembuj?” (Serres, 2015: 42).

Por, çfarë mund të kujtojë një Teodor Adorno lidhur me rrethana të ngjashme?

Arsimimi duhej t'i përshtatej individit të lirë shpirtërisht, me ndërgjegje të plotë dhe veprues në shoqëri. Arsimimi ka vlejtur në heshtje si premisa e një shoqërie autonome: sa më i kthjellët individi, aq më e kthjellët shoqëria” (Adorno, 2010: 21).

Mirëkuptimi i tjetrit ose pse ne mund të mos mendojmë njësoj për të njëjtën gjë

Baza e këtij koncepti filozofik lidhet ngushtë me ekzistencën njerëzore si të papërsëritshme në botë, përveç kësaj ne vijmë nga familje të ndryshme, kultura të ndryshme dhe shoqëria është e mbushur me individë që duan të shpalosin unin e tyre të veçantë në botë. Mësimi i mirëkuptimit të të qenit të tjetrit ndryshër dhe mënyra e zgjidhjes së konflikteve kërkojnë ndërhyrjen e shkollës dhe edukatorit nuk janë cilësi të lindura por duhen zgjuar e mbështetur si vlera që i shërbejnë edhe demokracisë. Fukuyama shkruan kështu për këtë proces që e quan “pluralizëm identitetesh”:

Në shoqëritë bashkëkohore ndryshimet sociale u thelluan nga teknologjia moderne e komunikimit dhe mediat sociale, e cila njerëzve me ide të ngjashme, por të ndarë gjeografikisht, iu mundëson komunikimin me njëri-tjetrin. Në një botë të tillë, eksperiencat e jetës, pra dhe identitetet që ne njohim shumohen në mënyrë eksponenciale, ashtu si dhe yjet në YouTube dhe Facebook” (Fukuyama, 2024: 119).

Relativimi i të vërtetave dhe ishujt e sigurisë

Ndarja e informacioneve të rreme nga ato të vërteta [kriteret për t'i dalluar ato janë një punë e hershme e filozofëve. Por ajo sot lidhet edhe me një farë sigurie në dije. Në rast se ne relativojmë çdo dije, krijohet një konfuzion në mendjet e të rinjve me më pak përvojë. Studiuesja Christian shkruan kështu për kite problem:

Kur emisionet televizive, faqet e lajmeve të internetit dhe mediat e tjera portretizojnë një

version të botës që nuk bazohet në realitet, nuk është çudi që ne, veçanërisht nëse ndjekim shumë media, të besojmë në portretizime të gabuara (Christian, 2022: 155).

Atëherë edukatorët e shkolla duhet të rrisin vëmendjen ndaj pasigurive dhe të ofrojnë krahas dijeve të diskutueshme edhe dije të sigurta që përmbajnë shkencat. Për shembull askush nuk duhet të dyshojë se disa ilaçe ose vaksina të provuara shkencërisht e praktikisht mund të shërojnë sëmundje të caktuara. Por skepticizmi vlen si dhe përralla e “Kësulkuqes dhe ujku”. Nuk dihet se cilën fytyrë mund të ketë marrë “ujku” në internet.

Mungesa e vëmendjes dhe kthimi te celulari

Një tjetër moment që karakterizon këtë formë të njohjes së botës të të rinjtë, është mungesa e vëmendjes që shfaqet shumë shpejt duke i kthyer te celulari. Po të dëgjuan për pak kohë mërzhiten shpejt dhe humbasin interesin për at çfarë ju thua. Disa prej tyre e konsiderojnë më shumë se një qenie e gjallë celularin e tyre dhe kur ju prishet ose dëmtohet shfaqen të hutuar e të paorientuar. Çfarë mund të bëjnë edukatorët për të ritërhequr vëmendjen.

- Të tregojnë një shembuj nga jeta e përditshme dhe pastaj të japin teorinë (moralin) e tij.
- Të godasin menjëherë me idenë kryesore. Gishtëmollëzave nuk iu intereson shumë mënyra se si arrihet të dija por, thjeshtë dija.
- Madje edhe dija në gjykimin e tyre nuk shërben për ndonjë përfitim të madh pasi, sipas tyre nuk ka lidhje me realitetin e shumta shërben si stoli për mendjen. Atëherë duhet theksuar ana funksionale e dijes që po japim si edukatorë.

“Tuitoj prandaj ekzistoj”¹

Po reflektimi si proces i domosdoshëm i mendjes si përfshihet?

Gishtëmollëzave nuk iu intereson shumë historia se ju duket e vjetër dhe pa lidhje, ju intereson e tashmja. Atëherë duhet filluar me dobinë e asaj ideje historike për të tashmen, për shembull, nuk kanë interes për krimet e Luftës së Dytë Botërore, por mjafton t’u nxjerrësh ca pamje nga qeniet njerëzore në kampet e përqendrimit mënyrën se si janë katandisur ata njerëz në imazhe dhe kanë kuptuar diçka për rrezikun e fashizmit. Por kjo kujtesë është afatshkurtër sepse lidhet pak me botën e tyre të sotme.

Si ja kalove sot internet?

Edukatori duhet të shtojë krahas interesimit se si i riu ose e reja ia ka kaluar në shkollë ose në veprimtari të tjera, edhe pyetjen se si mund të ketë kaluar në internet ai (ajo). Komunikimi i sigurtë ndihmon që kjo gjë të mos shihet si një mënyrë kontrolli por si një dëshirë për të diskutuar për ditën. Kështu ai mund të mësojë se çfarë ka ndodhur në atë botën paralele të fëmijës ose të riut ku nuk hyn dot, por për këtë duhet të jetë i sigurtë dhe i besueshëm, vlera që duan kohë të zhvillohen në mënyrë që të kuptojmë se çfarë ndodh në jetën e tyre virtuale, a ka probleme dhe të ndihmohen për t’u zgjidhur ato.

Përfundime

Këto vlera nuk duhen imponuar, por bindur se janë të mira për të shkuar mirë me të tjerët edhe në internet edhe në jetë. Dewey udhëzon:

Një mësues i mirë ka më shumë të ngjarë të dijë më shumë se fëmija, se cilat janë prirjet

¹ Fjala “tuitoj” - domethene komunikoj me Twitter - përdoret nga Umberto Eco në librin e tij “Pape Satan Aleppe...” ku analizon problemet e edukimit me internetin të të rinjtë.

e fëmijës dhe ç'duan të thonë ato. Mësuesi duhet të shërbejë vetëm si nxitës për të kuptuar e motivuar disa vlera të ajo çfarë po përpiqet të bëjë në mënyrë të verbër fëmija (Dewey, 2004: 133).

Gjithashtu, ka nevojë për edukimin e rëndësishë së privatësisë tek të rinjtë si dhe pengimi i krijimit të mbikëqyrjes së tyre si qytetarë, siguri nuk do të thotë futje hundësh në jetën private qoftë nga shteti qoftë nga institucione e njerëz të caktuar.

- Cornelius-White, J. 2007. *Learner-centered teacher-student relationships are effective: A meta-analysis*. Review of educational research, 77(1), 113-143.
- Dhuey, E., & Smith, J. 2014. *How important are school principals in producing student achievement?* Canadian Journal of Economics/Revue Canadienne d'économique, 47(2), 634-663.
- Lendrum, A., & Humphrey, N. 2012. *The importance of studying the implementation of interventions in school settings*. Oxford Review of Education, 38(5), 635-652.
- Luppici, R. 2005. *A systems definition of educational technology in society*. Journal of

- Educational Technology & Society, 8(3), 103-109.
- Qendra e Shëbimeve Arsimore [Educational Services Center]. 2021. "Matura Shtetërore 2021: Raport publik mbi arritjet e nxënësve" [State Matura 2021: Public report on Atudent Achievements], MSH 2021. http://qsha.gov.al/infos/matura_2021/raport_public_msh2021.pdf (parë, më 10 gusht 2024)
- Qendra e Shëbimeve Arsimore [Educational Services Center]. 2019. *Matura Shtetërore 2019: Raport Publik mbi Arritjet e Nxënësve* [State Matura 2021: Public report on Atudent Achievements], MSH 2019. http://qsha.gov.al/infos/matura_2021/raport_public_msh2021.pdf (parë, më 10 gusht 2024)
- Steinmayr, R., & Spinath, B. 2009. *The importance of motivation as a predictor of school achievement*. Learning and individual differences, 19(1), 80-90.
- Taşkm, N., & Kandemir, B. 2010. *The effect of computer-supported simulation applications on the academic achievements and attainments of the seventh-grade students on science teaching*. Procedia-Social and Behavioral Sciences, 9, 1379-1384.
- Toropova, A., Myrberg, E., & Johansson, S. 2021. *Teacher job satisfaction: the importance of schoolwork conditions and teacher characteristics*. Educational Review, 73(1), 71-97.
- Young, M. 2012. *What are schools for? In Knowledge, values and educational policy* (pp. 10-18). Routledge.

MARTESA NË MOSHË TË HERSHME SI FORMË E DHUNËS FAMILJARE NDAJ VAJZAVE DHE GRAVE

Blerina HAMZALLARI
Univeristeti i Tiranës
Fakulteti i Shkencave Sociale
Departamenti i Sociologjisë
E-mail: blerina.hamzallari@unitir.edu.al

PËRMBLEDHJE

Prirjet e zhvillimit të shoqërisë shqiptare në dekadat e zhvillimeve pluraliste kanë ndikuar në ndryshime të rëndësishme edhe në strukturën e familjes dhe të marrëdhënieve familjare. E megjithatë, pavarësisht zhvillimeve të përgjithshme reformuese dhe emancipuese, institucioni i familjes në shoqërinë shqiptare vazhdimisht reflekton qëndrime konservative që mbajnë gjallë dukuri tradicionale, sikurse është edhe martesë e hershme e vajzave. Ky artikull ka për qëllim të argumentojë se martesat e vajzave në moshë të re janë një formë e shprehjes së dhunës familjare ndaj tyre. Për grumbullimin e të dhënave të këtij studimi është përdorur metoda cilësore, me instrument intervistën gjysëm të strukturuar. Për analizën e gjetjeve u përdor analiza tematike, e cila u mundësua nëpërmjet organizimit të të dhënave në bazë të etiketimit dhe kodimit. Studimi nxori në pah se disa mendësi dhe norma sociokulturore të mjedisit familjar dhe shoqëror nxisin martesën e hershme të vajzave. Gjetjet e këtij studimi tregojnë gjithashtu se modelet e sjelljes prindërore, autoriteti patriarkal dhe tipologjia familjare e të rejave ndikojnë në martesën në moshë të hershme të vajzave. Martesa në moshë të hershme e vajzave është rrjedhojë e vendimeve arbitrare e të dhunshme në familjen e origjinës dhe nga ana tjetër, është faktor për të ekspozuar vajzat e reja ndaj dhunës në familjet e reja pas martesës. Martesa e vajzave në moshë të re është sfidë për funksionimin normal të familjeve të tyre pas martese, duke e shndërruar dukurinë e martesave të vajzave me moshë të re në një problem jo vetëm personal dhe familjar, por me ndikime afatgjata edhe në shoqëri.

Fjalë kyçe: *martesa e hershme, martesë e adoleshenteve, bashkëjetesa, familja, të drejtat e njeriut, të drejtat e fëmijëve, mendësi patriarkale, norma kulturore, etj.*

Prof. Asoc. Dr. **Blerina HAMZALLARI** është personel akademik me kohë të plotë pranë Departamentit të Sociologjisë, Universiteti i Tiranës. Ajo ka përfunduar studimet e ciklit të parë dhe të ciklit të dytë në Sociologji në Universitetin e Tiranës. Në korrik të vitit 2017 u diplomua “Doktor” në shkencën e Sociologjisë dhe në dhjetor të vitit 2023 fitoi titullin akademik “Profesor i asociuar”. Interesat kryesore të kërkimit janë: Familja, martesë, të rinjtë, gjinia, konflikti dhe ndërmjetësimi, drejtësia restauruese, komuniteti dhe familjet, farefisnia, komunikimi ndërkulturor, grupet vulnerabel, etj.

Përligja e studimit

Përpos të gjitha ngjyimeve të zhvillimit të shoqërisë shqiptare dhe ndryshimeve që përfaqësojnë tashmë një realitet të riformatuar, ka fakte sociale kokëforta, të cilat pavarësisht ulje ngritjeve në kurbën e tyre, mbeten dëshmi e përhershme. Referencat zyrtare statistikore japin shifra të konsiderueshme të dukurisë së martesave nën moshën 19 vjeç edhe në vitet e tranzicionit në Republikën e Shqipërisë. Në dëshmitë e heshtura të të gjithëve ne, ku një i/e njohur, i/e afërm/e, një shok ose shoqe e jona bëhen pjesë e “zgjidhjes” dhe “zgjedhjes” për të hyrë në lidhje martesore qysh në adoleshencën e tyre dhe në faktimin e totalitetit të ktyre rasteve prej Institutit të Statistikave të Republikës së Shqipërisë, është me shumë interes analiza e kësaj dukurie dhe veçanërisht ndikimi i kontekstit në familjen e origjinës.

Edhe në dhjetëvjeçarët e parë të Shekullit të XXI dukuria e martesave në moshë të hershme vazhdon të jetë shqetësuese në shoqërinë shqiptare. Sikundër lexohet nga të dhënat e tabelës 1. në totalin e martesave të kryera në çdo vit një numër të konsiderueshëm të tyre e zënë martesat nën moshë 19 vjeç. Kjo dukuri vazhdon të ruajë profilin e saj gjinor, duke qenë më e pranishme tek vajzat dhe më pak tek djemtë.

Vitet 2002 dhe 2003 kanë qenë vitet me numrin më të madh të martesave ndër vajzat me moshë nën 19 vjeç, përkatësisht, 28.6 për qind e vajzave të martuara në këto vite kanë lidhur martesë me moshë nën 19 vjeç. Ndër vitet më kulminantë të martesave nën 19 vjeç të djemve mund të përmendim

vitin 1993 me një peshë specifike prej 2.4 për qind e djemve të martuar në atë vit dhe vitin 1994 me një peshë specifike prej 2.0 për qind të djemve të martuar në atë vit. Përgjatë gjithë viteve pasues pavarësisht luhatjeve të treguesve numerikë martesat e djemve janë pakësuar dukshëm. Ndërkohë shifrat e vajzave të martuara nën 19 vjeç vazhdojnë të mbeten shqetësuese.

Sipas të dhënave të referuara problematikat e parashtruara janë:

- Pavarësisht ndryshimeve strukturo-funksionaliste në shoqërinë shqiptare, të cilat kanë ndikuar në ndryshimet e strukturës familjare, ende në shoqërinë bashkëkohore shqiptare ka fakte në traditën e familjeve për konservim modelesh familjare.
- Me kë martohen vajzat e reja? Kush është partneri i tyre? Si ndikon familja e origjinës në favorizimin e martesës së hershme të vajzës?

Faktet statistikore tregojnë se vajzat mbizotërojnë në përpjesëtime problematike përkundrejt bashkëmoshatërëve djem të së njëjtës grup-moshë që martohen nën 19 vjeç. Në vitin e fundit (2022) të sjellë në mbyllje të të dhënave vajzat e martuara nën 19 vjeç janë në peshë specifike 10.7 për qind e martesave të realizuara në atë vit krahasuar me djemtë, që janë në një peshë specifike vetëm prej 0.6 për qind. Janë rreth 17.8 herë më shumë vajza se djem që janë martuar nën 19 vjeç. Rrjedhimisht vetëkuptohet se partnerët e vajzave të martuara në adoleshencën e tyre janë më të mëdhenj në moshë se ato vetë. Nga kjo praktikë rezulton që vajzat janë të prekura në mënyrë disproporcionale në krahasim me djemtë.

Tabela 1: *Martestat e vajzave dhe djemve nën 19 vjeç në vitet 1990-2022 (në përqindje)*

Vitet	1990	1991	1992	1993	1994	1995		
Gjithsej martesa	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0		
Vajza nën 19 vjeç	30.0	24.0	24.3	27.3	27.9	22.6		
Djem nën 19 vjeç	1.3	1.5	1.9	2.4	2.0	1.0		
Vitet	1996	1997	1998	1999	2000	2001		
Gjithsej martesa	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0		
Vajza nën 19 vjeç	21.0	21.2	21.1	21.3	26.9	17.7		
Djem nën 19 vjeç	1.0	0.9	0.7	0.7	1.1	0.5		
Vitet	2002	2003	2004	2005	2006	2007		
Gjithsej martesa	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0		
Vajza nën 19 vjeç	28.6	28.6	22.4	26.2	25.0	28.5		
Djem nën 19 vjeç	1.4	1.3	0.9	1.0	1.1	1.2		
Vitet	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	
Gjithsej martesa	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	
Vajza nën 19 vjeç	27.9	26.8	24.9	22.3	25.0	23.6	22.4	
Djem nën 19 vjeç	1.1	0.5	0.6	0.6	0.8	0.6	0.6	
Vitet	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022
Gjithsej martesa	100	100	100	100	100	100	100	100
Vajza nën 19 vjeç	21.3	14.8	16.9	15.8	15.1	13.2	11.9	10.7
Djem nën 19 vjeç	0.6	0.3	0.5	0.7	0.6	0.7	0.5	0.6

[Burimi: INSTAT, 2000: 37; INSTAT, 2009: 22; INSTAT, 2015: 30-31; INSTAT, 2021: 33, INSTAT, 2023; përlllogaritjet në përqindje janë të autores]

Qëllimi dhe objektivat e studimit

Dhuna dhe abuzimi në familje kanë një histori të gjatë. Miller & Knudsen (1999: 706) janë përpjekur të përcaktojnë kategoritë e mundshme të viktimave të dhunës dhe abuzimeve familjare në të cilin përfshijnë

“... të gjithë anëtarët e mundshëm të familjes si në familjet tradicionale dhe jo tradicionale, të rriturit dhe fëmijët, duke përfshirë kujdestarë dhe fëmijë të

birësuar, partnerët në marrëdhënie martesore, partnerët bashkëjetues ose jobashkëjetues si dhe partnerët romantikë ose seksualë”.

Qëllimi i këtij studimi është të eksplorojë modelet e përgjithshme të dhunës familjare dhe frustrimit brenda familjes, por në veçanti tek dhuna familjare që pësojnë adoleshentet dhe disa nga trajtat e kësaj dhune në:

- Familjet e tyre të origjinës dhe ndikimin e mjedisit familjar në sjelljen e të rinjve dhe të rejave në adresimin e tyre ndaj martesës.

- Familjet e reja pas martesës, duke u përpjekur të identifikohen llojet e dhunës midis partnerëve intimë dhe prirjes për t'i duruar abuzimet ose për t'i denoncuar ato. Me rëndësi të identifikohet në këtë pikë është lidhja e mundshme midis modeleve në familjen e origjinës, modelit që gjejnë ose që ndërtojnë në familjen e re dhe prirjes për të mos e shndërruar në problem dhunën dhe abuzimet.

Është e rëndësishme që familja e origjinës dhe shëndeti i marrëdhënieve brenda saj të merren në konsideratë, pasi ashtu sikundër sugjerohet edhe në formulimet e teorisë së sistemeve familjare, pjesëtarët e një familjeje janë së bashku të vendosur në një marrëdhënie të ndërlikuar me njëri-tjetrin, dhe çdo veprim i rëndësishëm që kryen një nga anëtarët e saj prek automatikisht edhe anëtarët e tjerë të familjes (Olson & DeFrain, 1994: 484). Në këtë kuptim një familje me një anëtar me probleme apo prirje të dhunshme dhe abuzive është një familje, e cila nuk mund të përmbushë siç duhet funksionet e saj.

Objektivat kryesorë të studimit janë:

- Të eksplorohet natyra e ndikimit të familjes së origjinës në martesën e vajzës në moshë të hershme.
- Të analizohet struktura e familjeve në të cilat integrohen vajzat e martuara hershëm (me kë jetojnë pas martesës).
- Të konsiderohet ekspozimi i vajzave adoleshente ndaj sjelljeve abuzive prej bashkëshortit dhe të tjerëve, si pasojë e martesës nën moshën 19 vjeç.

Aspekte metodologjike

Në termat e epistemologjisë njohja dhe dija ndërtohen përmes interpretimeve që i bëjmë aksionit tonë (Silverman, 2000: 89). Duke përdorur teknikat e kërkimit cilësor dhe analizës së përvojave të grave të martuara nën 19 vjeç, përmbajtja e këtij studimi do

të orientohet drejt konstruktivizmit social dhe rëndësisë së nivelit të mikromjediseve shoqërore në funksionimin e dukurive, të cilat jo me doemos përputhen me teknikitetin e elementëve makrostrukturorë. Ky studim është edhe përshkrues, i bazuar në studimin e rasteve. Është zgjedhur kjo tipologji kërkimi, sepse në studimet deskriptive studiuesi mund të kuptojë më mirë jetën e subjekteve të studimit nëpërmjet përshkrimit që ata vetë i bëjnë jetës së tyre (Rossman & Rallis, 2012: 16). Kampioni i këtij studimi janë 30 gra, të zgjedhura në mënyrë të qëllimshme nëpërmjet teknikës së topit të borës. Gjithmonë në adresimin ndaj pjesëmarrësve potencialë të propozuar sipas teknikës së topit të borës duhen mbajtur parasysh qëllimet e studimit dhe kriteret e përcaktimit të kampionit (Tracy, 2013: 135-138).

Gjetje dhe diskutime

Ndikimi i normave sociokulturore në martesat me moshë nën 19 vjeç.

Mjedisi sociokulturor shqiptar karakterizohet nga një sërë norma, vlera dhe besime, të cilat integrojnë edhe në shoqërinë bashkëkohore forma problematike të veprimit tradicional. Studiuesja suedeze Pernilla Ouis e sheh martesën e hershme si një përgjigje të shoqërive të ndryshme ndaj respektit për traditën si dhe ndaj asaj që ajo do e quante “Ideologjia e nderit”. Ouis (2009: 453) nënvizon se:

Ideologjia e nderit është pjesë e trajtimeve fundamentaliste kulturore, të cilat përcaktojnë rolet gjinore në vende të ndryshme të botës... Nderi është një status, i cili mund të humbet dhe humbja e tij shkakton turp. Nderi shpesh herë është i lidhur me burrat dhe ato që mund të shkaktojnë turpin janë gratë... Sugjerohet se në shoqëritë fisnore është reflektim i aftësisë së individëve për të jetuar brenda standarteve kulturalisht të ndërtuara të të qenit burrë dhe të qenit grua.

Nga të dhënat e studimit nxirret në pah se konteksti familjar edhe mjedisi sociokulturor i komuniteteve në të cilat kanë jetuar vajzat e martuara në moshë të re të intervistuar kanë patur në themel të ndërveprimit dhe edukimit “ideologjinë e nderit” karakterizuar dhe favorizuar nga elementët e poshtëshënuar:

Tipare të edukimit në familje:

- Edukimi me frikën rreth marrëdhënieve seksuale paramartësore dhe “vlerën” e «pastërtisë» së vajzës
- Tradita e rezervimit të marrëdhënieve seksuale për në martesë
- Nderi i vajzës është nderi i familjes

Tipare të ndërveprimit në mjedisin sociokulturor të komunitetit:

- Tradita e martesave me shkesi
- Tradita e ndërprerjes së shkollës pas arsimit të detyrueshëm
- Stigmatizimi në rast të maarrëdhënieve dashurore dhe akoma më shumë marrëdhënieve intime paramartësore

Traditën e të vepruarit bazuar mbi tregues që normojnë “ideologjinë e nderit” vajzat e intervistuar e konsiderojnë ndikuese në lidhjen e martesave në moshë të re. Ndaj vajzave të reja në familje ushtrohet në mënyrë eksplicite kërkesa për “kujdes”, e cila është një thirrje e vazhdueshme e prindërve për rezervim të marrëdhënieve seksuale për në martesë si dhe pritshmërinë për të martuar vajzën me djalin me të cilin ajo ka kryer marrëdhënie seksuale para martesë. Pavarësisht traditës për martesën e vajzave në moshë të adoleshencës nëpërmjet shkesisë, nga të dhënat rezulton se martesat në moshë të hershme realizohen edhe si pasojë e procesit të rënies në dashuri në moshë të hershme të vajzave (21 nga 30 raste martesë si pasojë e rënies në dashuri). Një rezultat i tillë shpreh veprimin arbitrar të prindërve për të martuar vajzën në përputhje me kodet e nderit, me partnerin e saj të parë.

Disa nga pjesëmarrëset në studim pohojnë se martesë e tyre është zhvilluar në një kohë të ndërmjetme midis ngjizjes së fëmijës dhe lindjes së tij. Në këtë kuptim martesat e adoleshenteve nuk janë të planifikuara, por ato janë rrjedhojë e shtatëzanive të paplanifikuara dhe si pasojë martesë e tyre realizohet për të mos lindur fëmijë para martesë. Pas këtyre të dhënave në rastet e referuara kemi ballafaqimin me martesat që studiuesja amerikane Naomi Seiler (2002: 5) në studimin e martesave të adoleshenteve në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, i quan “Shotgun marriage”. Mund të themi se mjedisi sociokulturor i pjesëmarrësve në studim shfaq: a) intolerancë në lindjen e fëmijëve para dhe jashtë martesë si dhe b) obligimin për t’u martuar në rast të një shtatëzanie të mundshme. Ja disa pohime:

Drilona (martuar 18 vjeçe):

Mendoj se babai kishte shumë frikë se mos ne bënim ndonjë gabim (donim ndonjë dhe bënim ndonjë gabim) dhe donte të na rregullonte njëherë dhe pastaj të bënim çfarë të donim... ai këmbngulte se mund të më ndodhte gjë dhe madje mamit i thoshte: “Po ndodhi gjë me gocat ti do dalësh e para nga shtëpia.”

Morena (martuar 16 vjeçe)

Ne më shumë ishim shokë, se mendo as një puthje si kemi patur dhënë njëri-tjetrit... Në fillim të vitit të dytë babi im e morri vesh sikur unë isha e lidhur me atë djalë dhe sikur pale çfarë kishim bërë. Pasi më hoqi nga shkolla babai e kishte ndarë mendjen të më hiqte nga shtëpia, duke më fejuar e duke më martuar. Këtë rrugë babi im e shikonte si të duhurën për të më shpëtuar nga gabimet, më hoqi nga shkolla se mos i sillja turpin në derë.

Normat sociokulturore luajnë rol të rëndësishëm në zhvillimin e çdo shoqërie. Ndikimi i tyre në çdo lëm të jetës private dhe publike është i një rrjedhe të natyrshme.

Midis vajzave të intervistuar disa herë dialogu është orientuar rreth rëndësisë parësore dhe të patjetërsueshme të nderit të vajzës deri në gjetjen e partnerit të saj të jetës. Hera-herës këto pretendime janë ngritur haptazi nga prindërit e vajzave, më saktë babait të tyre, dhe hera-herës janë nënkuptuar në shprehje kuptimplota që të çojnë rreth një emëruesi të përbashkët, siç është konservimi i marrëdhënieve seksuale për partnerin e ardhshëm. Gratë e intervistuar, disa herë e kanë servirur traditën e të qenit e paprekur si parashkruesen e fatit të tyre për t'u martuar që në adoleshencë, madje edhe atëherë kur ato vetë asnjëherë nuk e kishin paramenduar që e ardhmja e tyre do t'i çonte kaq shpejt drejt jetës familjare, duke i shkëputur për rrjedhojë nga gjithë ëndrrat dhe shkuajdesjet e moshës së tyre të re.

Edhe në tregimet e grave të intervistuar rënia në dashuri dhe zbulimi nga prindërit i marrëdhënieve romantike rezulton si një faktor shtytës dhe përshpejtues i martesave në moshë të re. Paraprakisht kjo është një prirje e identifikuar edhe nga sociologu bashkëkohor Zyhdi Dervishi (2005: 75-90), i cili nënvizon se përgjithësisht prindërit tregohen të vëmendshëm dhe vigjilentë në sjelljet e vajzave të tyre dhe në prirjet ndryshe të sjelljeve të tyre... Ndër prindërit shqiptarë mbetet një etiketë e papëlqyeshme përlyerja e vajzave të tyre me thashethemet e opinionit shoqëror, ndaj të cilave ata priren tju bëhen mburojë vajzave të tyre. Hija e përhapur nga mjegulla e thashethemeve për vajzat, i shoqëron për shumë e shumë vite, ndoshta gjatë gjithë jetës.

Shtatë nga tridhjetë gratë e intervistuar kanë pohuar se zbulimi i lidhjeve të tyre të dashurisë nga prindërit dhe kundërshtimi i tyre i ka çuar ato drejt martesës në moshë të vogël: 4 prej këtyre 7 vajzave janë martuar “me rrëmbim” me personat që donin, 2 prej tyre pas zbulimit të lidhjeve të tyre janë martuar nga prindërit (babai) me njerëz, të cilët nuk i kanë patur njohur më parë dhe vetëm njëra prej tyre ka arritur të

bindë prindërit dhe është martuar me atë që donte. Nga katër gratë e martuara “me rrëmbim” ose të larguara nga shtëpia si pasojë e kundërshtimeve të vazhdueshme të prindërve të lidhjes së tyre romantike dhe pamundësisë për t'i bindur ata mund të themi se nga zbulimi i lidhjes deri në largimin e vajzës nga shtëpia kanë kaluar disa stadi në marrëdhëniet midis prindërve dhe vajzave të tyre:

- Mbajtja e fshehtë e lidhjes prej vajzës ndaj prindërve për aq kohë sa ka qenë e mundur.
- Zbulimi i lidhjes nga prindërit, kryesisht nëpërmjet personave të tjerë, të cilët mund të jenë të afërm ose njerëz të komunitetit të tyre.
- Presioni me argument ose presioni në trajtë imponuese i prindërve për të përfunduar raportin e tyre dashuror dhe hera-herës edhe përpjekje të tyre për t'ju prishur mendjen me dikë tjetër.
- “Bindja” në heshtje e vajzave për të fituar kohë.
- Përpjekja e vajzave për të fituar betejën me prindërit.
- Vendimi për largim nga shtëpia për të jetuar me partnerin e zgjedhur prej vetë vajzave.

Modelet e sjelljes prindërore dhe tipologjia familjare e të rejave

Qysh nga viti 1940, studime të shumta në shoqëri të ndryshme, kanë identifikuar dy përmasa të përgjithshme të sjelljes prindërore që kanë të bëjnë me mbështetjen dhe kontrollin. Janë këto dy përmasa të ndikimit prindëror sipas të cilave parashikohen edhe hapësirat e fëmijës për të shfaqur tërësinë e mundësive dhe pamundësive (Peterson & Hann, 1999: 333). Rastet e grave të martuara me mblesëri me moshë nën 19 vjeç pjesë e këtij studimi, shoqërizohen kryesisht nga prindër kontrollues. Gjithë procesi deri në martesën e vajzës së re tregon ashpërsinë e kontrollin prindëror ndaj jetës së saj. Pavarësisht arsyeve (frikës për çnderim,

normave socio-kulturore të komunitetit apo familjes, frikës për të ardhmen, etj...) me të cilat ky kontroll prindëror justifikohet, sërish ai përcakton në mënyrë arbitrarë jetën e vajzës së re duke i ndërprerë arsimimin, kufizuar lirinë, kushtëzuar mirëqenien dhe duke e bërë atë të varur nga partneri i saj i ardhshëm.

Rastet kur vajzat janë larguar nga shtëpia si pasojë e presionit prindëror për të mos u martuar me atë që donin, do t'i kategorizonim si marrëdhënie në një teren të rrëshqitshëm dhe të pavendosur ku prevalon më së fundmi vetëkontrolli në një trajtë rebele dhe kundërshtuese. Do t'i konsideronim si të tilla pasi janë të vetmet marrëdhënie në të cilat është rrëfyer debati familjar midis vajzave dhe prindërve, ku diskutimet zhvillohen në kushtet e përpjekjes për injorim të prindërve ndaj vajzës dhe përfundojnë në "fitoren" e vullnetit të vajzave nëpërmjet vendimmarrjes antikonformiste ndaj kontrollit prindëror. Në analizën e rasteve dhe rrjedhës së ngjarjeve kur martesë në moshë të re vjen si pasojë e "renies në dashuri" hershëm, në modelet e marrëdhënieve midis prindërve dhe vajzave të tyre mbizotërojnë kryesisht raporte të drejtpeshuara në nivelet e kontrollit dhe sjelljeve kontrolluese ose mbështetëse. Sipas këtyre të dhënave, pjesëmarrëset në studim në një peshë specifike të diferencuar ndjeshëm sipas përshkrimeve të mësipërme dëshmojnë se më së shumti sjellja e prindërve të tyre është sa kontrolluese aq edhe mbështetëse.

Gjatë intervistave vazhdimisht gratë e reja sjellin në vëmendje rolin e prindërve në vendimmarrjen për martesë.

Matilda 23 vjeçare është e rritur në një mjedis ku nëna nuk kishte tagër vendimmarrjeje dhe motrat e saj rrinin të frikësuara dhe të dobëta para fjalës, vendimeve dhe dhunës së atit të tyre:

Babai vazhdimisht ushtronte dhunë mbi mua dhe motrën, por edhe nënën... Kur ishte shumë i pirë na gjuante dhe mami nuk kishte asnjë mundësi të na mbronte nga dhuna e tij. Edhe fejesën time e ka bërë babai... Kur

njerëzit të vinin bashkë me djalin të mitë do pranonin dhe unë nuk do kundërshtoja. Mami asnjëherë nuk ka patur mundësi t'i kundërvihet babait dhe kur ata erdhën asnjëra nga në nuk foli, pasi në shtëpi i kishte pranuar babai dhe kështu unë u fejova.

Xheni 27 vjeçare tregon se si në familjen e saj ajo ka bërë çdo gjë për të realizuar dashurinë e saj, por babai dhe vëllezërit e saj kanë rezistuar si një barrierë e pakapërcyeshme:

Prindërit dhe vëllezërit e mi nuk e pranonin kursesi që ai të ishte bashkëshorti im, nuk e konsideronin të duhurin për mua, sepse thoshin se ai nuk do të mundtë më siguron të mua një të ardhme të qetë. Vëllezërit e mi kur e zbuluan që ne ishim të lidhur kanë shkuar e kanë takuar atë djalin dhe e kanë rrahur shumë keq sa që ju desh të shkonte në spital. Unë nuk e durova dot dhe fillova t'i thosha mamit dhe babit që unë e doja atë djalë. Por ata nuk e pranonin, çdo diskutim përfundonte në dhunë, nga njëra anë, rrihnin djalin që unë doja dhe, nga ana tjetër, vëllezërit dhe babai më rrihnin mua. Mami përpiquej të më mbushte mendjen veçmas të hiqja dorë, se po rrihesha çdo ditë dhe i dhimbshesha se ajo nuk bënte dot gjë.

Në lexim dhe interpretim të këtyre rasteve ajo që është thelbësore në tërësinë e marrëdhënieve të anëtarëve të familjes me njëri-tjetrin dhe si pasojë edhe e adresimit të këtyre marrëdhënieve përtej familjes ka të bëjë me një model kryesisht patriarkal tradicional. Janë burrat e shtëpisë si babai, vëllezërit ose edhe më gjerë xhaxhallarët dhe të mëdhenjtë e një trugu familjar, të cilët ndikojnë në orientimin e jetës së një vajze që në moshë të re drejt martesës. Në rastet e referuara vajzat e martuara me mblesëri dhe rrëmbim (13 raste), pohohet se në marrëdhëniet familjare të grave të martuara herët më ndikues ka qenë babai. Nëna në jetën e këtyre vajzave është më së shumti

mbështetëse ose këshilluese për të zbutur përplasjet mes palëve, ose pranon pafuqinë e saj dhe e konsideron si të padiskutueshëm vendimin e burrit për jetën e bijës së tyre. Përvojat personale dhe rrugëtimi i vajzave të intervistuar drejt martesës dëshmojnë ndër të tjera edhe histori të formave të larmishme të dhunës familjare ndaj vajzave dhe që shpesh nuk ka munguar as dhuna fizike.

Martesa e vajzave në moshë të re është sfidë shumëpërmasore për funksionimin normal të familjeve të tyre të reja.

Studiuesit e jetës familjare Olson & De Frain (1994: 41) krijojnë një skemë për kategorizimin e normës shoqërore të vendosjes së çiftit të ri pas martesës (*norm of residence*) bazuar në elementët gjinorë. Shoqëritë në të cilat çifti i ri vendoset pranë të afërmeve të bashkëshortes, veçanërisht pranë familjarëve të nënës së vajzës quhen shoqëri matrilokale. Në Shoqëritë ku çifti i sapo martuar vendoset pranë njerëzve të bashkëshortit, veçanërisht grupit familjar të babait të tij quhen shoqëri patrilokale. Norma e një vendbanimi të ri dhe të pavarur nga origjinat përkatëse të të dy të rinjve të lidhur në martesë është një alternativë për shoqëritë që karakterizohen nga neolokaliteti pas martese.

Sipas skemës së Olson dhe De Frain kur gratë martohen në adoleshencën e tyre shkëputja nga trangu i familjes së origjinës nëpërmjet normës së të vendosurit në familjen e bashkëshortit i orienton ato drejt një marrëdhënieje patrilokale. Familja e origjinës së bashkëshortit për shumicën e grave të intervistuar ka qënë mjedisi ku ato kanë ndërtuar familjen e re. Shpesh herë në këto familje grua e re gjen, përveç prindërve të bashkëshortit, edhe motra ose vëllezër të tjerë të tij si dhe në disa raste edhe anëtarë të tjerë familjeje si gjyshin ose gjyshen e tij. Në këtë kuptim mjedisi familjar ku përgatitet ngritja e një familjeje të re mbart karakteristikat e një familjeje relativisht të zgjeruar me disa breza dhe

kurorë. Në një mjedis kompleks ku ndeshen breza dhe mëndësi të ndryshme është e pritshme që edhe marrëdhëniet mes palëve të jenë më të ndërlikuara dhe të larmishme. Në gjithë përvojat e grave pjesë e studimit dallohen dy kategori anëtarësh të familjes së bashkëshortit, të cilët janë me ndikim në jetën e tyre familjare:

Së pari, ndikimi i prindërve të bashkëshortit në jetën e tyre martesore dhe familjare, specifikisht ndikimi i nënës së tij. Marrëdhëniet ndërmjet grave dhe vjehrrave të tyre përgjithësisht normalizoheshin më me vështirësi. Tonalitetet dhe çështjet e konfliktit janë pothuaj gjithmonë të ndërruarura nga niveli shoqëror, kulturor dhe ekonomik i të dyja palëve, por ajo që është e rëndësishme është se këto marrëdhënie pothuajse gjithmonë bëhen shkaqe të mjaftueshme për (pa)qëndrueshmërinë e ekuilibrave në martesat dhe familjet e grave.

Në marrëdhënien e gruas me prindërit e bashkëshortit të saj dhe veçanërisht me nënën e tij kontradiktat janë të shumëllojshme. Më të përhapura janë:

Kontradiktat si pasojë e diferencave moshore që shfaqen si konflikte ndërbrezore.

Konfliktet ndërbrezore janë nga tipologjitë e pashmangshme të konflikteve familjare edhe në familjen e origjinës së vajzave dhe po njëlloj tereni i familjes së bashkëshortit është një mjedis mbartës i konflikteve të tilla.

Kontradiktat si pasojë e ndërhyrjes në marrëdhëniet dhe vendimmarrjen në çift.

Kur gratë e reja shkojnë në familjet e bashkëshortit për të nisur jetën martesore ato bëhen pjesë e një sistemi familjar me marrëdhënie të konsoliduara mes palëve si dhe role të përcaktuara me kohë. Gratë gjatë intervistave tregojnë se në mjedisin e zgjeruar familjar me vetëdije duhet të respektojnë rregullat e tyre, por prirjen të revoltohen kur nuk mundin të krijojnë në çift një nivel konfidencialiteti dhe pandikueshmërie nga

të tjerët. Ndërhyrjet dhe kushtëzimet e prindërve të bashkëshortit ndaj mundësie për liri dhe pavarësi familjare nën banesën e përbashkët janë një burim i vazhdueshëm konflikti në familjet e tyre dhe me anëtarët e familjes së zgjeruar.

Kontradikta si pasojë e ndërvlerësimit ekonomik të çiftit të ri nga prindërit e bashkëshortit.

Në shumicën e familjeve të grave të intervistuar varësia ekonomike e tyre është një nënkuptim i pranuar duke qënë se ato në shumicën e rasteve janë të papunësuar. Këto gra nën efektin e varësisë ekonomike pranojnë lehtësisht interferencat edhe në aspekte të tjera të jetës së tyre familjare prej bashkëshortit dhe prindërve të tij, pa kundërshtuar edhe atëherë kur nuk i pëlqejnë. Problemi i ndërvlerësimit ekonomik fillon të agravohet dhe të shndërohet në një shkak të mjaftueshëm e të vazhdueshëm për kundërshti dhe debate kur edhe vetë gratë punojnë. Punësimi ose mungesa e punësimit të gruas shpesh lidhet edhe me faktorë të tjerë strukturorë dhe funksionalë të familjes së origjinës së bashkëshortit dhe së bashku krijojnë një rreth kompleks marrëdhëniesh në të cilat gratë mbeten pa zgjidhje për familjet e tyre.

Familja e origjinës së bashkëshortit në rastet nën analizë ka qënë mjedisi i parë i vendosjes së familjes së re. Për disa nga gratë (7 prej tyre) vendosja në familjen e bashkëshortit ka qënë pjesë e një periudhe tranzitore drejt të vendosurit në një mjedis të pavarur nga familjet e origjinave përkatëse, ndërsa shumica e tyre vazhdonin të jetonin ende me familjarët e bashkëshortit (disa herë edhe pa bashkëshortin, pasi punonte në emigrim) dhe, për më tepër, nuk mendonin se në periudha afatshkurtra do të mund të ndryshonin stilin e të jetuarit. Ndër gratë ka nga ato të cilat pohojnë se:

Ne kemi provuar vetëm njëherë në 14 vite martesë të jemi vetëm si familje në shtëpi dhe pa asnjë njeri tjetër, pasi ishin jashtë shtetit

të gjithë me rastin e një dasme... Do të doja të ishte gjithmonë ashtu, ajo është të jetosh në familjen tënde dhe me familjen tënde pa u ndikuar nga të tjerë (Drilona).

Në qoftë se nuk do të ishin larguar drejt emigracionit me siguri që familja ime do të ishte shkatërruar... ne filluam të jetojmë jetë familjare kur ikëm nga nëna dhe motra e tij (Tina).

Për të gjitha gratë bashkëjetesa e disa kurorëve dhe disa brezave në të njëjtën banesë krijon më shumë mundësi për konflikte. Të gjitha gratë në qoftë se do të mundeshin ekonomikisht do të zgjidhnin të jetonin vetëm me familjen e tyre.

Marrëdhënia midis bashkëshortëve

Zakonet martesore, madje edhe kuptimi i martesës është i ndryshëm në kultura të ndryshme. Andrew Cherlin (1997: 194) në një nga botimet e tij mbi rëndësinë e publikes dhe private në jetën e familjes amerikane, sjell në vëmendje rëndësinë e cilësimit të marrëdhënieve midis bashkëshortëve sipas formës dhe përmbajtjes që këto marrëdhënie kanë. Ai thekson se në vendet e botës së zhvilluar perëndimore qysh në gjysmën e parë të shekullit të XX janë bërë përpjekje për transformimin e marrëdhënieve martesore nga një institucion në marrëdhënie partneriteti (companionship).

Përvojat e përcjella nga gratë në lidhje me jetën e tyre familjare dhe rolet martesore na referojnë modelin institucional të martesës sipas përkufizimit të Andrew Cherlin., sipas të cilit martesa si institucion "qeveriset" nga autoriteti formal i bashkëshortit, i cili mbështetet nga komuniteti, ka një dallim të dukshëm ndërmjet roleve të burrit si sigurues ushqimi (breadwinner) dhe të gruas si përkujdesëse e çështjeve familjare dhe shtëpiake (housemaker). Disa prej grave janë përpjekur të transformojnë këto marrëdhënie brenda martesave të tyre, në përpjekje për t'a konsideruar martesën si marrëdhënie partneriteti, ku minimalisht si bashkëshorti

edhe bashkëshortja të kenë përgjegjësi për mirëmbajtjen e familjes, jetën emocionale familjare, mbështetjen ndaj njëri-tjetrit dhe fëmijëve. Edhe në disa raste kur ato kanë mundësi të punësohen strukturat familjare nuk i lejojnë të punësohen, si pasojë, rolet familjare dhe rolet martesore mbeten të kyçura brenda kornizave të martesës institucionale.

Gratë gjatë intervistave tregojnë se si në raste të ndryshme përgjatë jetës bashkëshortore ato kanë qënë nën presionin e vazhdueshëm të akteve të ndryshme abuzive. Mjaft fakte tregojnë se mungesa e kulturës martesore i bën gratë e martuara në moshë të re që për menaxhimin e marrëdhënieve pas martese t'ju referohen modeleve të të afërmeve, sidomos prindërve të tyre. Shumë prej grave pranojnë se edhe në familjen e tyre të origjinës midis anëtarëve të martuar ka patur sjellje abuzive, nga shfaqjet më të lehta të agresivitetit verbal e deri tek ato më të rëndat të ushtrimit të dhunës fizike me pasojë të rënda. Nisur prej këtyre modeleve shumica e grave të intervistuar pranojnë se “edhe martesat e tyre janë si gjithë të tjerat që ato kishin parë e dëgjuar”, larg asaj që ato kishin ëndërruar për martesat e tyre.

Duke iu referuar të dhënave teorike dhe atyre të këtij studimi qëndrimet e grave të intervistuar ndaj sjelljeve abuzive të bashkëshortëve janë të skajshme.

Së pari, gratë priren t'i tolerojnë dhe t'i justifikojnë si pjesë e natyrshme e marrëdhënieve martesore. Ato përgjithësisht besojnë se fati i martesës varet nga sjellja dhe durimi i tyre. Ky qëndrim reflekton vlerat e transmetuara nga nënat e tyre para martesës, por edhe në asistimin e tyre gjatë martesës kur si këshilla më e shpeshtë e dhënë për vajzat e tyre është “duhet të bëhesh e duruar, fjalëpakë dhe e matur për të mos e prishur martesën dhe familjen”.

Së dyti, gratë fillojnë të vetëdijësohen për ndikimet e sjelljeve abuzive në martesë vetëm atëherë kur rrjedhjat janë në limitet e skajshme të dëmtimeve dhe kërcënimeve

reale edhe ndaj jetës së tyre ose fëmijëve të tyre. Kur marrëdhënia midis bashkëshortëve precipiton në këto stade të rrezikshme atëherë gruaja fillon të ketë vëmendjen e familjarëve dhe komunitetit dhe këtu fillojnë gjenezat e mbështetjes së saj në rast të daljes nga lidhja martesore.

Ndër trajtat me të shpeshta të dhunës së ushtruar në familje nga bashkëshorti përkundrejt grave të tyre përmenden abuzimet verbale dhe abuzimet emocionale, të cilat janë shumë të vështira për t'u dokumentuar. Disa prej grave flasin gjithashtu për raste të përshkallëzimit të mëtejshëm të abuzimit emocional dhe verbal në një abuzim fizik, i cili mund të derivojë edhe në një abuzim seksual. Vështirësia e konsiderimit të veçuar të tipologjive të abuzimit të grave të martuara me moshë të re nga bashkëshortët e tyre më bën të veçoj disa nga rastet më të rënda që çenojnë edhe integritetin fizik të grave siç janë, dhuna fizike dhe dhuna seksuale.

Sugjerime

Në eksplorimin e rrjedhjavë të dukurisë në studim u vu re se ato kategorizohen sipas ndikimeve që shkaktonin në dy kategori kryesore si a) *ndikimet në jetën e gruas së re*, duke i kushtuar vëmendje mundësive për zhvillim dhe përparim personal të vetë gruas; b) *ndikimet në jetën e familjeve të reja* të krijuara nga martesa e vajzave me moshë nën 19 vjeçe, duke sjellë në fokus marrëdhëniet që ndikojnë në stabilitetin e këtyre martesave dhe marrëdhëniet e deformuara dhe problematike me ndikim çekuilibruar në jetën familjare.

Në këtë çështje vëmendja do të adresohet ndaj aktorëve dhe subjekteve të identifikuar me ndikime përcaktuese në realizimin e martesave në moshë të re.

Së pari, meqënëse ky studim ka nisur si një diskutim i të lejueshmes dhe të palejueshmes, para martesës së vajzës dhe gjatë martesës së saj, sipas normave kulturore

dhe normave ligjore ndër dhjetëvjeçarë dhe sisteme të ndryshme qeverisjeje, mendoj se është e një rëndësie të veçantë vëmendja e ligjvënësve dhe ligjzbatuesve ndaj dukurisë së martesave me moshë nën 19 vjeçe, sepse:

Është e rëndësishme të kuptohet se martesat e vajzës në moshën e adoleshencës nuk është vetëm një e dhënë e fondit statistikor, por është një hap jo i sigurt dhe shpesh problematik për zhvillimin e kapitalit social femëror si dhe krijimit të njësisë të reja familjare me probabilitet të lartë për të qënë pjesë e kulturës së varfërisë dhe sjelljeve abuzive në familje.

Është e rëndësishme të theksohet se martesat e vajzave me moshë të re janë bashkime, të cilat shkelin hapur përcaktimet ligjore mbi lidhjen e martesës. Padija dhe mungesa e informacionit i bën këto vajza të jetojnë në bashkime martesore fakti pa mbrojtjen ligjore, madje të sjellin në jetë edhe fëmijë nën moshën 18 vjeç dhe jashtë kursorës martesore.

Për minimizimin e kësaj dukurie mund të merren edhe disa masa ligjore si gjobë ose vite pune në shërbim të komunitetit, mbase edhe dënim me heqje lirie për periudha të caktuara kohore, sipas rëndësisë së rolit në realizimin e martesave me moshë të re. Kategoritë ndaj të cilave mund të adresohen këto masa mund të jenë:

- Prindërit e palëve, të cilët përgjatë këtij studimi rezultuan të ishin edhe iniciatorë të martesave në moshë të re, sidomos në lidhjet e realizuara me shkesi.
- Djali, i cili në të gjitha rastet ishte disa vite më i madh në martesë se gruaja e tij dhe që pranonte të krijonte marrëdhënie me një vajzë të mitur.
- Nëpunësit e gjendjes civile, të cilët janë një kategori e rëndësishme për të informuar vajzat rreth mundësive për lidhjen ligjore të martesës duke paraqitur kërkesë pranë gjykatave përkatëse. Edhe pse mund të jetë vonë, sërishmi në momentin e regjistrimit të fëmijëve të sapolindur, nëpunësit lipset

të nxisin formalizimin e martesave si mundësi për të siguruar mbrojtjen e gruas së re në të ardhmen.

- Mjekët mund të përfshihen në mbrojtjen e grave të martuara me moshë të re si dhe familjeve të tyre. Ata janë dëshmitarët e parë të lindjes së fëmijëve në bashkime martesore dhe shpesh herë dëshmitarët e vetëm të akteve të dhunës në familje.
- Duke patur parasysh ndikimin e opinionit shoqëror dhe shpejtësinë e përhapjes së informacionit në komunitetet e shoqërisë shqiptare, mendoj se mund të krijohet aktori shoqëror i “oficerit të familjes” ose “kujdestarit të familjes” në nivelet e pushtetit lokal si mundësi për të identifikuar rastet e martesave në moshë të re dhe marrjen e masave ligjore ndaj tyre. Roli i tij mendoj se duhet të jetë, ndër të tjera, trajtimi si rast studimi sociologjik i çdo të dhëne si mundësi për të ndërhyrë në themelet e problemit, të cilat kryesisht janë familjare e shoqërore.

Së dyti, shkollat mbeten një aktor i rëndësishëm në formimin e vetëdijes shoqërore ndër vajzat e reja, por edhe për edukimin e rëndësisë së vlerave të shoqërisë bashkëkohore.

Është e domosdoshme që në shkolla të kultivohet respekti për veten dhe të tjerët si dhe domosdoshmëria e zotërimit të njohurive për të qënë konkures në tregun e mundësive.

Ripërcaktimi i roleve dhe aftësimi për jetën lipset të krijojnë baza të shëndetshme në mjediset shkollore, duke marrë parasysh edhe paaftësisinë e shumë familjeve për t'a realizuar këtë rol.

Në veprimtaritë që synojnë kufizimin dhe tejkalimin e martesave në moshë të re të vajzave mund të angazhohen edhe bordet e shkollave. Lipset të theksohet se të parët që përgjithësisht mësojnë për arsyet e vërteta

të shkëputjes nga shkolla të një vajze të re janë bashkëmoshatarët e saj dhe mësuesit. Sot në shkollat e Republikës së Shqipërisë funksionon bordi i shkollës, me përfaqësues nga komuniteti, qeveria e nxënësve, pushteti vendor dhe mësuesit. Këto borde mund të hulumtojnë edhe largimet e vajzave të reja nga shkolla dhe arsyet e largimeve të tilla. Në varësi të të dhënave të grumbulluara, kur faktet diktojnë martesën në moshë të re të vajzës, mund të hartojnë një plan veprimi edhe në bashkëpunim me institucione të tjera për parandalimin e saj.

Në rast të pamundësisë për parandalim bordi i shkollës mund të adresojë problemin tek institucionet përgjegjëse si shkelje e

të drejtave të fëmijës, ose mosrespektim i akteve ligjorë dhe nënligjorë për moshën dysHEME të martesës.

Së treti, prindërit janë një faktor shumë i rëndësishëm për realizimin e shëndetshëm të ciklit të jetës së vajzave. U vu re se lipset një punë e vazhdueshme, sidomos me prindërit e vajzave, sepse ata janë aktorët kryesorë në edukimin dhe transmetimin e modeleve vlerore dhe të sjelljes. Mund të planifikohen trajnime dhe bashkëbisedime kualifikuese periodike nga specialistë të fushave të shkencave sociale, kryesisht sociologë dhe psikologë, me prindërit e vajzave adoleshente.

REFERENCAT

- Cherlin, J., Andrew. 1997. *Public and private families (a reader)*, US: McGraw-Hill Education.
- Dervishi, Zyhdi. 2005. *Bashkëjetesë me demonët e konflikteve*, Tiranë: Jerusalem.
- Instituti i Statistikave, INSTAT. 2000. “Vjetari demografik 1990-1999”, Tiranë: Botimet INSTAT.
- Instituti i Statistikave, INSTAT. 2009. *Femra dhe meshkuj në Shqipëri*, Tiranë: Botimet INSTAT.
- Instituti i Statistikave, INSTAT. 2015. *Femra dhe meshkuj në Shqipëri*, Tiranë: Botimet INSTAT.
- Instituti i Statistikave, INSTAT. 2021. *Femra dhe meshkuj në Shqipëri*, Tiranë: Botimet INSTAT.
- Instituti i Statistikave, INSTAT. 2023. “Gratë dhe burrat në Shqipëri”; <https://www.instat.gov.al/media/12598/burra-dhe-gra-2023.pdf>
- Miller, JoAnn Langley & Knudsen, Dean D. 1999. “Family Abuse and Violence”, *Handbook of marriage and the family. Second edition, Volume I*, edited by Susman, Marvin B.; Steinmetz, Suzanne K.; Peterson, Gary W., New York: Plenum Press.
- Olson, David H. & DeFrain, John. 1994. *Marriage and the family, diversity and the strengths*, USA: Mayfield publishing Company.
- Ouis, Pernilla. 2009. “Honourable Traditions? Honour Violence, Early Marriage and Sexual Abuse of Teenage Girls in Lebanon, the Occupied Palestinian Territories and Yemen”, *International Journal of Children's Rights* Vol. 17: 445–474.
- Peterson, Gary W. & Hann, Della. 1999. “Socializing Children and Parents in Families”, *Handbook of marriage and the family. Second edition, Volume I*, edited by Susman, Marvin B.; Steinmetz, Suzanne K.; Peterson, Gary W., New York: Plenum Press.
- Rossman, Gretchen B. & Rallis, Sharon F. 2012. *Learning in the field: An introduction to qualitative research* (third edition), USA: SAGE publication.
- Seiler, Naomi. 2002. *Is teen marriage a solution?*, Washington: Center for Law and Social Policy.
- Silverman, David. 2020. *Doing Qualitative Research: A practical handbook*, London: Sage Publication.
- Tracy, Sarah J. 2013. *Qualitative research methods: Collecting evidence, crafting analysis, communicating impact*, UK: Wiley-Blackwell Publishing.

ABSTRACT

The trends of the development of the Albanian society in the decades of pluralistic developments have influenced important changes in the structure of the family and family relations. And yet, despite the general reforming and emancipatory developments, the institution of the family in Albanian society constantly reflects conservative attitudes that keep traditional phenomena alive, such as the early marriage of girls. This article aims to argue that the marriage of girls at a young age is a form of expression of family violence against them. For the data collection of this study was used the qualitative method, with the semi-structured interview as an instrument. The analysis of findings was made through thematic categorization, after organizing the data based on labeling and coding. The study highlighted that some sociocultural mindsets and norms of the family and social environment encourage early marriage of girls. The findings of this study also show that parental behavior patterns, patriarchal authority and young women's family typology influence girls' early marriage. Early marriage of girls is a consequence of arbitrary and violent decisions in the family of origin and, on the other hand, is a factor in exposing young girls to violence in new families after marriage. The marriage of girls at a young age is a challenge for the normal functioning of their families after marriage, transforming the phenomenon of marriages of girls at a young age into a problem with long-term impacts on society.

Keywords: *Early marriage, teenage marriage, cohabitation, family, human rights, children's rights, patriarchal mindset, cultural norms, etc.*

ANALIZË E REGRESIONIT MBI NDIKIMIN E MBËSHTETJES SOCIALE DHE KARAKTERISTIKAVE INDIVIDUALE NË KËNAQËSINË DHE STRESIN NË PUNË

Juna MUÇA

Universiteti i Tiranës

Fakulteti i Shkencave Sociale

Departamenti i Punës dhe Politikave Sociale

(Doktorante)

E-mail: juna.muca@unitir.edu.al

Entela KOSTRISTA

Kolegji Universitar Logos, Tiranë

Fakulteti i Shkencave të Aplikuara

E-mail: entela.kostrista@kulogos.edu.al

Edo SHERIFI

Kolegji Universitar Logos, Tiranë

Fakulteti i Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjithësesor

E-mail: edo.sherifi@kulogos.edu.al

Edvaldo BEGOTARAJ

Sapienza University of Rome

E-mail: edvaldo.begotaraj@uniroma1.it

PËRMBLEDHJE

Ky studim synon të analizojë ndikimin e disa faktorëve psikologjikë dhe organizativë në kënaqësinë dhe stresin në punë tek nëpunësit civilë në Shqipëri. Fokus kryesor i kërkimit është roli që luajnë mbështetja nga eprorët dhe kolegët, nervozizmi si tipar personaliteti, si dhe perceptimi për kulturën organizative në përvojën subjektive të kënaqësisë dhe stresit në vendin e punës. Të dhënat u mblodhën përmes një ankete të strukturuar, të shpërndarë në mënyrë

rastësore tek 36% e nëpunësve civilë, duke siguruar një përfaqësim të kënaqshëm të kampionit në nivel kombëtar. Analiza e të dhënave u realizua përmes metodës së regresionit linear, me qëllim identifikimin e lidhjeve statistikore midis variablave të pavarur (mbështetja sociale, nervozizmi, kultura organizative) dhe variablave të varur (kënaqësia në punë dhe stresi në punë). Rezultatet treguan se mbështetja nga eprorët dhe kolegët ka një ndikim domethënës pozitiv në kënaqësinë në punë, ndërsa nervozizmi lidhet në mënyrë të konsiderueshme me rritjen e nivelit të stresit dhe reduktimin e kënaqësisë. Gjithashtu, perceptimi pozitiv për kulturën organizative u shfaq si një faktor mbrojtës ndaj stresit dhe promovues i mirëqenies profesionale. Ky studim kontribuon në literaturën ekzistuese mbi mirëqenien në vendin e punës dhe nënvizon rëndësinë e ndërhyrjeve organizative që forcojnë mbështetjen sociale dhe përmirësojnë kulturën institucionale për të promovuar një ambient pune më të shëndetshëm dhe produktiv.

Fjalët kyçe: *Kënaqësia në punë, Stresi në punë, Mbështetja sociale, Kultura organizative, Nervozizëm.*

Juna MUÇA është studente e ciklit të tretë të studimeve (doktoraturë) në Punë dhe Politikë Sociale pranë Universitetit të Tiranës, si dhe lektore në Kolegjin Universitar Logos. Me përvojë në administratë publike dhe akademi, ajo fokusohet në analiza krahasuese të politikave sociale, menaxhim konflikti, migracion dhe zhvillim institucional në fushën e punës sociale.

Entela KOSTRISTA është studente e ciklit të tretë të studimeve (doktoraturë) dhe asistent lektore në Matematikë dhe Statistikë në Kolegjin Universitar Logos. Ajo ka përvojë kërkimore në statistika të aplikuar, analiza të të dhënave, projekte Erasmus dhe bashkëpunime ndërdisiplinore në mjekësi, shkenca sociale dhe programe të trajnimit statistik.

Prof. Asoc. **Edo SHERIFI** është lektore në Kolegjin Universitar Logos. Në vitin 1979 ajo përfundoi studimet në Fakultetin e Shkencave Politiko-Juridike, Universiteti i Tiranës. Ka kryer specializim dhe master në psikologji-pedagogji dhe është doktoruar në Universitetin e Tiranës. Ka pasur role akademike dhe drejtuese në fakultete të ndryshme, duke përfshirë edhe pozitën e dekane në KU "Wisdom.

Dr. **Edvaldo BEGOTARAJ** është PhD në Psikologji Klinike dhe Dynamike nga Universiteti "Sapienza" në Romë. Ajo është drejtuese e Departamentit të Pedagogji-Psikologjisë në Kolegjin Universitar Logos. Ekspertiza e tij përfshin shëndetin mendor, trajtimet ndaj traumës dhe kërkimin klinik, me mbi 30 botime dhe përfshirje në studime ndërkombëtare.

Kuptimi i dinamikës së kënaqësisë në punë dhe stresit është ndihmuar nga disa korniza teorike me ndikim. Modeli Kërkesa për Punë-Burime (JD-R) është një model teorik i shquar që shpjegon mirëqenien në vendin e punës përmes një ekuilibri të presioneve dhe mbështetjeve në punë. Në kornizën JD-R, çdo punë karakterizohet nga: (a) kërkesat e punës - aspekte të punës që kërkojnë përpjekje të vazhdueshme ose kanë kosto fizike/psikologjike (p.sh., ngarkesa e punës, presioni i kohës, konflikti i roleve), dhe (b) burimet e punës - aspekte të punës që ndihmojnë në arritjen e qëllimeve të punës, zvogëlojnë kërkesat ose stimulojnë rritjen personale, p.sh., autonomia, reagimet,

mbështetja sociale, mjetet e përshtatshme (Bakker & Demerouti, 2014).

